

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË

Studime Juridike



Tiranë, Dhjetor 2016

REDAKSIA

Prof. Dr. Paskal Haxhi, Kryetar
Prof. Dr. Kudret Çela, Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Anëtare
Prof. Dr. Skënder Kacupi, Anëtare
Prof. Dr. Vasilika Hysi, Anëtare
Prof. Dr. Argita Berisha, Anëtare
Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldashi Anëtare

Sekretare shkencore:

Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldashi

Adresa e redaksisë:

FAKULTETI I DREJTËSISË
TIRANË, ALBANIA
Tel/Fax: + (355) (4) 22 25 37

© Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Revista botohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe me fondet e Fakultetit të Drejtësisë

Kopertina: Ilmi Shahu

Përgatiti për botim:

Shtëpia Botuese "FLESH" shpk
Rruga "S. Pitarka" Tiranë
Cel. +355 (0) 692033302
E-mail: botimflesh@gmail.com

ISSN - 2220-3990

Përmbajtja

Prof.Asoc.Dr. Maks QOKU	DISA TRAJTIME JURIDIKE MBI DOKTRINËN E NDASHMËRISË DHE ATË TË KOMPETENCES MBI KOMPETENCËN NË ARBITRAZHIN NDERKOMBETAR5
Dr. Erind MERKURI & Doc. Klesta HYSI	AKTET NORMATIVE NËNLIGJORE MIDIS JURIDIKSIONIT KUSHTETUES DHE ATIJ GJYQËSOR ADMINISTRATIV19
Dr. Armela KROMIÇI	LEGJSLACIONI SHQIPTAR MBI TRANSFERIMIN E ÇMIMEVE45
Msc. Ardit MUSTAJ	MBI FENOMENIN KRIMINAL TË PASTRIMIT TË PARAVE63
Dr. Alkelina GAZIDEDE	EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NGA SHTETET ANËTARE83
Dr. Ermal NAZIFI & Dr. Petrina BROKA	KONTROLLI I PËRQENDRIMEVE: NJË NGA SHTYLLAT E SË DREJTËS SHQIPTARE TË KONKURRENCËS97
Msc. Sali SHEHU	KORRUPSIONI DHE EFEKTET NEGATIVE TË TIJ NË SHQIPËRI 111
Msc. Marilda MENKSHI	MBROJTJA E FËMIJËVE NGA KEQTRAJTIMI NË PARASHIKIMET E KODIT PENAL SHQIPTAR 125
Msc. Oljana PAPA	PËRDORIMI I GJUHËS SHQIPE NË TEKNIKËN LEGJSLATIVE 135
Etilda GJONAJ (SALIU)	MEKANIZMAT E BRENDSHËM NË PARANDALIMIN E TORTURËS DHE TRAJTIMIT Ç'NJERËZOR DHE DEGRADUES NË SHQIPËRI 153

Abstract

Prof.Asoc.Dr. Maks QOKU	DISA TRAJTIME JURIDIKE MBI DOKTRINËN E NDASHMËRISË DHE ATË TË KOMPETENCES MBI KOMPETENCËN NË ARBITRAZHIN NDERKOMBETAR182
Dr. Erind MERKURI & Doc. Klesta HYSI	AKTET NORMATIVE NËNLIGJORE MIDIS JURIDIKSIONIT KUSHTETUES DHE ATIJ GJYQËSOR ADMINISTRATIV 183
Dr. Armela KROMIÇI	LEGJSLACIONI SHQIPTAR MBI TRANSFERIMIN E ÇMIMEVE184
Msc. Ardit MUSTAJ	MBI FENOMENIN KRIMINAL TË PASTRIMIT TË PARAVE 185
Dr. Alkelina GAZIDEDE	EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NGA SHTETET ANËTARE186
Dr. Ermal NAZIFI & Dr. Petrina BROKA	KONTROLLI I PËRQENDRIMEVE: NJË NGA SHTYLLAT E SË DREJTËS SHQIPTARE TË KONKURENCËS..... 187
Msc. Sali SHEHU	KORRUPSIONI DHE EFEKTET NEGATIVE TË TIJ NË SHQIPËRI188
Msc. Marilda MENKSHI	MBROJTJA E FËMIJËVE NGA KEQTRAJTIMI NË PARASHIKIMET E KODIT PENAL SHQIPTAR189
Msc. Oljana PAPA	PËRDORIMI I GJUHËS SHQIPE NË TEKNIKËN LEGJSLATIVE190
Etilda GJONAJ (SALIU)	MEKANIZMAT E BRENDSHËM NË PARANDALIMIN E TORTURËS DHE TRAJTIMIT Ç'NJERËZOR DHE DEGRADUES NË SHQIPËRI192

DISA TRAJTIME JURIDIKE MBI DOKTRINËN E NDASHMËRISË DHE ATË TË KOMPETENCES MBI KOMPETENCËN NË ARBITRAZHIN NDERKOMBETAR

Prof.Asoc.Dr. Maks QOKU

Hyrje

Referuar doktrinës juridike të përgjithshme, hasim padyshim, një lloj kompromisi që është arritur nga autorët e shumtë në këtë fushë, në lidhje me përkufizimin e “arbitrazhit”, i cili do të ishte:

“Arbitrazhi konsiderohet si një mënyrë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, e cila konsiston në një teknikë ligjore, e krijuar me qëllim që t’i japë zgjidhje një çështjeje, e cila ka të bëjë me marrëdhëniet midis dy apo më shumë personave, nga gjykimi i një ose më shumë personave të tjerë; arbitri ose arbitrat (gjykata e arbitrazhit), të cilët ushtrojnë pushtetin e tyre në bazë të një marrëveshjeje private midis palëve dhe vendosin në bazë të kësaj marrëveshjeje, duke mos qenë të caktuar nga shteti për realizimin e një misioni të tillë.”¹

E thënë ndryshe, “Arbitrazhi përbën një proces vullnetar dhe privat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, i cili u atribuon subjekteve të caktuar, autoritetin për të zgjidhur një mosmarrëveshje dhe në të njëjtën kohë i “zhvesh” gjykatat nga një autoritet i tillë.”²

Në këtë këndvështrim, arbitrazhi ndërkombëtar paraqet një mik elementesh, me specifikat dhe profilin e tij, gjithmonë e më të qartë dhe të mirëpërcaktuar nëpërmjet praktikës. Për më tepër, për të evidentuar

1 Rene David, L’arbitrage dans le commerce international, Economica, 1982

2 Jean Robert & Thomas E. Carbonneau, The French Law of Arbitration pt. I, ch 1 at 1. Një marrëveshje arbitrazhi është në fakt një klauzolë e zgjedhjes së juridiksionit. Forumi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është mandatar sipas marrëveshjes së arbitrazhit, në të cilën palët i kanë dhënë në mënyrë eksplicite juridiksion gjykatës së arbitrazhit.

kompleksitetin e arbitrazhit ndërkombëtar, na vjen në ndihmë shprehja e një arbitri ndërkombëtar:

*“Arbitrazhi ndërkombëtar është njëkohësisht, një punë shumë e madhe dhe një kënaqësi shumë e madhe, por nuk është i lehtë për këdo. Ju duhet t’i strukturoni argumentat tuaja sipas një ligji substancial që nuk e keni njohur kurrë më parë, i cili aplikohet gjatë seancave dëgjimore në një vend të ndryshëm nga vendi yt, përpara arbitrave të edukuar në tre sisteme të ndryshme ligjore, të cilët zbatojnë disa rregulla të veçanta procedurale gjatë zhvillimit të procesit të arbitrazhit. Nëse jeni me të vërtetë me fat, çështja juaj do të varet nga aftësitë tuaja në ballafaqimin me një spekulant brilant, i cili pretendon se mund të shprehet vetëm në greqisht, danisht ose tajlandisht dhe u përgjigjet në mënyrë të zgjatur pyetjeve që ai mendon se ju duhej të kishit pyetur, përmes një interpretimi çoroditës, ku gjatë gjithë kohës është e dukshme, që vëmendja e kryetarit është përqendruar në mënyrë ekskluzive tek ora e tij. Shumë palë ndërgjyqëse, të cilat performojnë në mënyrë madhështore në gjykatat e vendit të tyre, nuk janë të zotë të veprojnë në këtë lloj ambienti”.*³

Aspektet juridike të marrëveshjes së arbitrazhit, si dhe tiparet thelbësore të saj.

Marrëveshja e arbitrazhit, është një kontratë nëpërmjet së cilës dy ose më shumë persona bien dakord, që mosmarrëveshjet e tyre të mos i zgjidhin para juridiksionit të zakonshëm shtetëror, por përpara një apo më shumë arbitrave të zgjedhur prej tyre. Elementë si vullneti, shkaku dhe zotësia, nuk paraqesin specifika të veçanta për marrëveshjen e arbitrazhit, por mund të themi se ato janë të njëjtët sikurse për një kontratë të zakonshme. Përsa i përket objektit të saj, ai duhet të jetë i tillë, që për nga natyra të mund t’i nënshtrohet procedurës së arbitrazhit. Natyrisht që në këtë kuptim, do të përjashtohen të gjitha çështjet, që zgjidhen nën juridiksionin ekskluziv të sistemit gjyqësor. Legjislacione të ndryshme, parashikojnë objekte të ndryshme të marrëveshjes së arbitrazhit. Kështu për shembull,

3 Christian Buhning-Uhle *“Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi në tregtinë Ndërkombëtare”*, 1996

legjislacioni danez⁴ parashikon një objekt të pakufizuar, në lidhje me llojshmërinë e mosmarrëveshjeve, që mund t'i nënshtrohen arbitrazhit. Ndërkohë që Ligji Model i UNCITRAL-it, si rregull kërkon që objekti i mosmarrëveshjes të jetë tregtar. Ligji francez⁵ parashikon, që çështjet që nuk i nënshtrohen arbitrazhit, do të jenë çështje që nuk kanë të bëjnë me interesa ekonomike, të tilla si divorci, kujdestaria etj, çështje që lidhen me të drejta të patjetërsueshme, si edhe çështje të ndjeshme nga pikëpamja e rendit publik. Legjislacioni shqiptar, si rregull e kufizon objektin e marrëveshjes së arbitrazhit, duke përcaktuar si kriter të përgjithshëm, "kriterin pasuror". Ndër të tjera sipas dispozitës ligjore përkatëse thuhet; "*Çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore, mund të jetë objekt i një gjykimi arbitrazhi*"⁶. Kjo dispozitë e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, është e ngjashme dhe në përputhje me Nenin 1(3) të Konventës së New York-ut, sipas së cilës: "*...Mund të deklarohet gjithashtu, se do të zbatohet Konventa, vetëm për mosmarrëveshjet e lindura nga marrëdhëniet juridike, kontraktore ose jokontraktore, të cilat konsiderohen si marrëdhënie tregtare nga legjislacioni nacional i shtetit që bën këtë deklaratë*"

Në parim arbitrazhi është një proces konsensual, dmth asnjëra nga palët nuk mund të detyrohet, që t'ia nënshtrojë mosmarrëveshjen e saj procedurës së arbitrazhit. Ndërkohë duhet pasur parasysh që, në praktikë ekzistojnë mjaft raste, kryesisht midis marrëdhëniesve të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, ku ajo që u ofrohet punëmarrësve për nënshkrim është një kontratë tip, e cila përmban një klauzolë arbitrazhi të panegociueshme. Këto lloj marrëveshjesh ndahen në dy grupime të mëdha:

a. Marrëveshje të cilat parashikojnë që, në rast se midis palëve do të lindin mosmarrëveshje, ato do të zgjidhen nëpërmjet arbitrazhit. Në këtë rast marrëveshja është përgjithësisht një kontratë, e cila përmban edhe klauzolën e arbitrazhit (*marrëveshje referuese*)

b. Marrëveshje të cilat nënshkruhen në një moment të dytë, pasi

4 Kap II, seksioni 7, Pikat 1 (a) të Ligjit danez nr.553 mbi Arbitrazhin (24.06.2005)

5 Neni 2059 dhe 2060 i Kodit Civil Francez

6 Neni 401, paragrafi i parë, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë (1996)

mosmarrëveshja ka lindur dhe që përcaktojnë se kjo mosmarrëveshje do të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit. (*marrëveshje nënshtrimi*)⁷

Praktika e gjykatave të arbitrazhit në vende të ndryshme, ka pranuar si klauzola të vlefshme arbitrazhi edhe klauzolat të cilat kanë parashikuar, se zgjidhja e mosmarrëveshjes nuk do të bëhet mbi bazën e një sistemi ligjor të caktuar, por mbi bazën e parimeve apo praktikave të tjera të zgjedhura nga palët. Të tilla janë rastet psh:

a- Kur arbitrat nuk janë të detyruar, që ta zgjidhin çështjen duke zbatuar domosdoshmërisht një ligj të caktuar material, por përkundrazi të bazohen në parimet e përgjithshme të biznesit, si dhe në zakonet tregtare.⁸

b- Kur arbitrat mund të bazohen në “parimet ndërkombëtare të së drejtës mbi marrëdhëniet kontraktore”, apo të bazohen në parimin *ex aequo et bono*⁹

Pra në këto raste, koncepti i ligjit substancial të zbatueshëm, paraqitet relativ dhe arbitrat duhet t’u përmbahen rigorozisht vetëm përcaktimeve të palëve, për aq kohë sa ato nuk vijnë në kundërshtim me normat e së drejtës ndërkombëtare private. Në praktikë ndodh më shpesh, që palët i kushtojnë më tepër rëndësi përcaktimit të ligjit material, sesa përcaktimit të ligjit procedural, pasi me të drejtë supozohet që është ligji substancial ai që zgjidh edhe thelbin e çështjes. Megjithatë duhet marrë në konsideratë rëndësia e ligjit procedural, i cili eventualisht në raste të caktuara, mund ta orientojë çështjen në një drejtim tjetër, në rast se zgjidhet ai dhe jo një grup tjetër rregullash, të këtij lloji. Pra, përveç ligjit material, numrit të arbitrave dhe vendit ku do të zhvillohet arbitrazhi, palët, ose nëse ata nuk e bëjnë, arbitrat, kanë detyrimin që të përcaktojnë edhe mënyrën e marrjes dhe administrimit të provave, kohën dhe vendin e çdo seance, përkthimin, mënyrën e thirrjes dhe pyetjes së dëshmitarëve, mënyrën e caktimit të ekspertëve dhe të gjithë ndihmësve të procesit.

Marrëveshja për arbitrazh duhet të evidentojë, objektin e konfliktit të

7 Shprehje e përdorur nga Gjykata e Lartë Amerikanë në çështjen Wilko vs Swan US 427 (1953)

8 Çështja Norske Atlas Insurance Co v London General Insurance Co (1927) 28 Lloyds List Rep.104

9 Çështja Deutsche Schachtbau v R’As al-Khaimah National Oil Co (1990) 1 AC 295

mundshëm, ose që efektivisht ka lindur, emrat e arbitrit ose të arbitrave, ose të paktën mënyrat e përzgjedhjes së tyre. Ligji shqiptar pranon faktin që, mungesa e njërit prej kushteve të mësipërme, e bën marrëveshjen e arbitrit të pavlefshme.¹⁰ Ekzistenca e këtyre kushteve shpjegohet me faktin që, palët e angazhuara në një marrëveshje arbitrazhi të saktësojnë kërkesat e tyre, me qëllim që të dinë se cilit arbitër duhet t'i drejtohen dhe se çfarë të kërkojnë nga arbitrat përkatës. E thënë ndryshe, kjo do të thotë që vetëm konfliktet e parashikuara shprehimisht në marrëveshjen e arbitrazhit, mund që të zgjidhen me arbitrazh. Në rast se palët do të kenë mosmarrëveshje të tjera, të cilat dëshirojnë që t'i zgjidhin me arbitrazh, do të duhet të lidhin një marrëveshje tjetër arbitrazhi, pasi në të kundërt do të duhet t'i referohen sistemit gjyqësor shtetëror. Natyra kontraktuale¹¹ e kësaj marrëveshjeje, bën që autonomia e palëve të përfshira në këtë proces të jetë e madhe. Synimi i palëve është një nga elementët më thelbësorë të arbitrazhit. Materializimi i qëllimeve të tyre, në një klauzolë arbitrazhi, është thelbësor për procedimin e arbitrazhit dhe është një burim i ligjit material dhe procedural të zbatueshëm. Shprehja e këtyre qëllimeve, e bën procesin e arbitrazhit të adaptueshëm ndaj rrethanave të ndryshme. Palët mund të vendosin, psh një klauzolë arbitrazhi të ngushtuar apo të zgjeruar, duke përcaktuar efektivisht se cilat çështje do të jenë të arbitrueshme.¹² Kjo do të thotë që, nëse palët dëshirojnë që t'ia nënshtrojnë të gjitha mosmarrëveshjet e tyre arbitrazhit, atëherë do të aplikohet një klauzolë arbitrazhi e “zgjeruar”. Në të kundërt, nëse palët i atribuojnë arbitrazhit, vetëm disa aspekte të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tyre, atëherë do të aplikohet një klauzolë e “ngushtuar”.

Palët mund t'i drejtohen arbitrazhit, për të përfutur një proces të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në mënyrë sa më të shpejtë, sa më pak të kushtueshëm dhe sa më pak formal dhe mbi të gjitha të drejtuar nga persona me njohuri të vecanta teknike. Gjithashtu, palët mund të zgjedhin

10 Neni 404 paragr 2: *“Marrëveshja e palëve, sipas paragrafit të parë është e pavlefshme, në rast se në atë nuk parashikohet mënyra e caktimit të arbitrave, si dhe objekti i mosmarrëveshjes kur ajo efektivisht ka lindur”*.

11 Jean Robert & Thomas E. Carbonneau, *The French Law of Arbitration* pt. I, ch 1 at 2 .

12 Jennifer Bagwell, *Forcimi i Marrëveshjeve të Arbitrazhit* (1992)

arbitrazhin edhe për arse të tjera; për të aplikuar një grup tjetër rregullash për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre; për të siguruar vazhdimësinë e marrëdhënieve të mira midis palëve; apo për të zgjidhur një çështje që është unike dhe praktikisht e pamundur për t'u zgjidhur nga një gjykatë e zakonshme.

Ekonomia botërore në zhvillim te pandalshëm, ka bërë të mundur edhe rritjen e rëndësisë së arbitrazhit në këndvështrimin ndërkombëtar tregtar.¹³ Klauzolat e arbitrazhit, janë duke u përdorur masivisht në kontratat ndërkombëtare tregtare. Një palë e kësaj kontrate, mundet që pavarësisht nga kjo, të përpiqet që të shmangë arbitrazhin.¹⁴ Kjo palë, mund të fillojë procedimet gjyqësore në një gjykatë të zakonshme, pavarësisht marrëveshjes ekzistente të arbitrazhit, apo të vërë në lëvizje gjykatën për ta shpallur marrëveshjen të pavlefshme, ose të verë në pikëpyetje juridiksionin e arbitrit.

Përgjithësisht dy doktrina e kanë ndihmuar arbitrazhin dhe statusin e tij, përballë të tilla sfidave, siç janë : *“Teoria e Ndashmërisë”* dhe *“Teoria e Kompetencës mbi Kompetencën”* dhe të cilat do ti trajtojmë më specifikisht.

Koncepti juridik i doktrinës së ndashmërisë dhe i kompetencës mbi kompetencën, si dhe lidhja ndërmjet tyre.

Nëse doktrina e ndashmërisë parashikon, autonominë e klauzolës së arbitrazhit, kompetenca e kompetencës parashikon që, arbitri ka kompetencën për të gjykuar vetë mbi juridiksionin e tij. Doktrina e ndashmërisë krijoi nevojën për arbitrat, për të përcaktuar vlefshmërinë e kontratës kryesore, si dhe të marrëveshjes së arbitrazhit. Në këtë këndvështrim teoria e kompetencës mbi kompetencën, shihet si derivat i teorisë së ndashmërisë.

A) Doktrina e ndashmërisë

Doktrina e ndashmërisë, ose ajo e autonomisë së klauzolës së arbitrazhit, parashikon rastin kur një klauzolë arbitrazhi në një kontratë,

13 Bagwell, shih më lart

14 Dr. Julian D.M Lew, *“Probleme bashkëkohore të Arbitrazhit Ndërkombëtar”* 74 (1986)

është e ndarë nga kontrata kryesore.¹⁵ Klauzola e arbitrazhit dhe kontrata kryesore, përfshijnë dy entitete të vecanta të marrëdhënieve kontraktore.

Këtu nuk është një, por përfshihen dy grupe të marrëdhënieve kontraktuale, të cilat qeverisin arbitrimin e mosmarrëveshjeve, sipas një kontrate materiale: në rradhë të parë; janë kontratat, të cilat ia nënshtrojnë mosmarrëveshjet e ardhshme arbitrazhit. Në pamje të parë, kjo do të vazhdojë për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës materiale dhe do të mbijetojë për aq kohë, sa këto mosmarrëveshje kanë mbetur të pazgjdhura.

Në grupin e dytë; ka një apo më shumë grupe ose ndarje të detyrimeve bilaterale kontraktuale, të cilat dalin në pah në momentin kur njëra nga palët i kundërvë palës tjetër një pretendim, i cili bie brenda parashikimit të marrëveshjes fillestare të arbitrazhit, e cila nuk është mundësuar që të përfundohet.¹⁶

Nëse nga njëra anë, ka një mosmarrëveshje lidhur me vlefshmërinë apo vazhdimësinë e ekzistencës së kontratës kryesore, nga ana tjetër klauzola e arbitrazhit duke qenë e pavarur, vazhdon të mbetet e vlefshme dhe e detyrueshme për palët.

B) Doktrina e kompetencës mbi kompetencën

Doktrina e kompetencës mbi kompetencën parashikon, që gjykata e arbitrazhit ka kompetencën që të gjykojë vetë mbi juridiksionin e saj.¹⁷ Sipas kësaj teorie, arbitri apo arbitrat mund të përcaktojnë ekzistencën e klauzolës së arbitrazhit, vlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit, ose

15 Bagwell, “*vështirësia logjike e doktrinës së ndashmërisë përmbledhet në shprehjen: Ex nihilo nil fit (nga asgjëja rrjedh asgjëja).*” Sipas Stephen Schwebel (Zv-president dhe Gjyqtar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë) “me logjikë, argumenti sipas të cilit një arbitër nuk mund të nxjerrë të drejta në bazë të një klauzole arbitrazhi që përfshihet në një kontratë të pavlefshme, qëndron. Por në të drejtën kjo është tejkaluar nga praktika. Është tejkaluar nga nevoja.

16 Black Clawson Int’l Ltd. v. Papierwerke Waldhof-Aschaffenburg AG, [1981] 2 Lloyd’s Rep. 446, 455 (Q.B.).

17 Stephen M. Schwebel, “*Arbitrazhi ndërkombëtar; 3 probleme të spikatura*” (1987) fq 17, parag 2.

qëllimin e klauzolës së arbitrazhit dhe palët nuk mund t'i drejtohen tashmë, një gjykatë të zakonshme për të përcaktuar këto çështje.

Sipas doktrinës së ndashmërisë, klauzola e arbitrazhit është e ndarë, në mënyrë që çështja e vlefshmërisë së kontratës kryesore apo ekzistencës së saj, të mund të gjykohet nga arbitrazhi. Doktrina e kompetencës mbi kompetencën, nga ana tjetër, merret me aftësinë e arbitrit për të përcaktuar juridiksionin e vet, mbi një mosmarrëveshje të caktuar. Teoria e dytë konsiderohet, si një derivat i teorisë së parë. Teoria e ndashmërisë, e cila përqafon autonominë e marrëveshjes së arbitrazhit, bën të lindë nevoja që gjykata e arbitrazhit të ketë kompetencë të vendosë, jo vetëm për vlefshmërinë e kontratës kryesore, por edhe të marrëveshjes së arbitrazhit.

Si njëra ashtu edhe tjetra teori, janë të përcaktuara nën kornizën e së drejtës ndërkombëtare të arbitrazhit dhe nën rregullat procedurale të dy organizatave ndërkombëtare të arbitrazhit; UNCITRAL dhe ICC. Në kontratat ndërkombëtare tregtare, qëllimi i palëve i trupëzuar në klauzolën e arbitrazhit, zakonisht përcakton rregullat procedurale që duhen aplikuar. Palët mund të zgjedhin rregullat procedurale nacionale, ose të adoptojnë ato të institucioneve ndërkombëtare, që janë jo-nacionale për nga natyra; si psh rregullat e ICC për Ndërmjetësimin dhe Arbitrazhin (“Rregullat e ICC”), ose rregullat e arbitrazhit të UNCITRAL (“Rregullat e UNCITRAL”)

Ligji model i UNCITRAL-it. Rregullorja e UNCITRAL dhe e ICC, si dhe ndikimi i tyre në rregullat e arbitrazhit ndërkombëtar.

Është pranuar gjerësisht, që pushteti i gjykatës së arbitrazhit për të gjykuar mbi juridiksionin e tij, është një atribut i pandashëm nga ekzistenca e kësaj gjykate.¹⁸ Kjo kompetencë e gjykatës është e parashikuar shprehimisht, në rregullat procedurale të arbitrazhit, njëkohësisht të UNCITRAL¹⁹ dhe ICC. Të dyja po ashtu, adoptojnë shprehimisht

18 Alan Redfern, *The Jurisdiction of an International Commercial Arbitrator*, 3J. INT’L ARB. 19, 30 (Mar. 1986).

19 HOWARD M. HOLTZMANN & JOSEPH E. NEUHAUS, *A GUIDE TO THE UNCITRAL MODEL LAW ON INTERNATIONAL COMMERCIAL ARBITRATION: LEGISLATIVE HISTORY AND COMMENTARY* 4 (1989) (discussing UNCITRAL arbitration)

edhe teorinë e ndashmërisë. Rregullat e UNCITRAL janë të pranuar ndërkombëtarisht dhe të përdorura edhe nga mbi tridhjetë institucione të tjera të arbitrazhit.²⁰ Një rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, i përkufizoi rregullat e UNCITRAL-it si të pranueshme për kombe me përjasje të ndryshme të institucioneve ligjore, ekonomike dhe sociale. Rregullat e UNCITRAL-it u përgatitën në konsultim me qendrat e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar dhe me institucionet e arbitrazhit.²¹ Rregullat e ICC janë po aq masivisht të përdorura, si dhe sikurse ato të UNCITRAL-it, janë ndërkombëtare dhe neutrale për nga natyra²². Kjo formë i drejtohet atyre palëve, që nuk ia besojnë apo nuk preferojnë që çështjet apo pretendimet e tyre, të gjykohen prej gjykatave nacionale apo dhe shoqatave të tjera të arbitrazhit .

Rregullat e UNCITRAL dhe ICC kanë përqafuar një sistem arbitrazhi të denacionalizuar, i cili është vetëreferues dhe nuk varet nga ligjet e shteteve përkatëse.²³ Gjithsesi, pavarësisht kësaj, natyra e denacionalizuar e rregullave të UNCITRAL dhe ICC, si dhe efektiviteti i tyre në çështjet praktike, mund të limitohet nga ligji nacional i vendit ku bëhet arbitrazhi. Palët janë zakonisht të mirinformuara nga këto institucione, për zgjedhjen e vendit ku do të zhvillohet arbitrazhi.

Rregullorja e Arbitrazhit të UNCITRAL ka përpunuar si doktrinën e ndashmërisë, ashtu edhe atë të kompetencës mbi kompetencën. Në nenin 21, në lidhje me rregullat e UNCITRAL, inkorporojnë çështjet e diskutuara më sipër mbi kompetencën, duke parashikuar që gjykata e arbitrazhit mund të vendosë, lidhur me juridiksionin e kësaj gjykate apo mungesën e tij, ekzistencën apo vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit apo të klauzolës së arbitrazhit. Doktrina e ndashmërisë është e parashikuar më tej në nenin 21, nga ku dalin çështjet e vlefshmërisë së kontratës kryesore,

20 IDEM

21 Schwebel, shiko me lart

22 W. LAURENCE CRAIG ET AL., INTERNATIONAL CHAMBER OF COMMERCE ARBITRATION¹⁶ (1990) (discussing wide appeal of ICC arbitration).

23 ROBERT & CARBONNEAU,, pt. II, ch. 4 at 5.

faktit që ajo e perfshin klauzolën e arbitrazhit dhe faktit që pavarësisht se kontrata kryesore mund të deklarohet e pavlefshme apo nul, kjo gjë nuk e bën automatikisht të pavlefshme edhe klauzolën e arbitrazhit.

Nëse Rregullat e UNCITRAL-it u bënë për t'u përdorur në procedimet ndërkombëtare tregtare të arbitrazhit, ligji model i UNCITRAL-it u zhvillua në mungesë të harmonizimit ndërmjet arbitrazhit të vendeve të ndryshme dhe kishte si qëllim që të shërbente si model për përhapjen e një sistemi të vetëm dhe të harmonizuar të arbitrazhit. Ai mbulon të gjitha fazat e procesit të arbitrazhit, duke filluar prej marrëveshjes së arbitrazhit dhe deri në njohjen dhe zbatimin e vendimeve përfundimtare të arbitrazhit. Ai përfaqëson një konsensus mbarëbotëror, përsa i takon parimeve dhe mënyrës së të proceduarit, në lidhje me çështjet më të rëndësishme që i takojnë arbitrazhit ndërkombëtar.

Si i tillë, është i pranueshëm për rajonet e ndryshme dhe shtetet e tyre përkatëse, si dhe për sistemet e ndryshme ligjore të botës. Që prej miratimit të tij, ai përfaqëson standartin ligjor të pranuar ndërkombëtarisht, përsa i takon arbitrazhit modern. Falë shkallës së lartë të harmonizimit që bashkon sistemet e ndryshme në një model të vetëm, ai karakterizohet edhe nga një nivel i lartë fleksibiliteti në aplikimin e tij. Ky fleksibilitet ndihmon në hartimin e normave dhe rregullave të reja të arbitrazhit, përshtatur me specifikat e çështjeve të ndryshme. Një numër i konsiderueshëm institucionesh, e kanë hartuar legjislacionin e arbitrazhit, duke u bazuar pikërisht në Ligjin Model. Rishikimi i ligjit në vitin 2006, kishte për qëllim të thjeshtojë interpretimin e tij dhe promovimin e të kuptuarit të tij, në mënyrë të njëjtë. Efekti i këtij rishikimi ka çuar në forcimin e besimit të palëve të huaja, si përdoruesit kryesorë të arbitrazhit ndërkombëtar dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të tij, në shtetet që e kanë miratuar atë.

Përsa i përket çështjes, që është në fokusin e këtij punimi, atë të doktrinës së ndashmërisë dhe kompetencës së gjykatës së arbitrazhit, në lidhje me kompetencën e vet, na shërben aplikimi i Nenit 16 të Ligjit Model, i cili i mbështet doktrinat e trajtuara sa më sipër. Në lidhje me pjesën e juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit ai shprehet kështu:

“Gjykata e Arbitrazhit ka kompetencë të vendosë lidhur me juridiksionin e vet, përfshirë çdo padi që ka të bëjë me ekzistencën, ose

vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit”.

Ndërsa në lidhje me konceptimin e klauzolës së arbitrazhit, si të ndarë nga ajo e kontratës kryesore, Neni 16 vazhdon të shprehet në mënyrë eksplicite, duke mos lënë vend për dyshime: “... Për këtë qëllim, klauzola e arbitrazhit, e cila bën pjesë në kontratë, do të trajtohet si një marrëveshje pavarur nga parashikimet e tjera të kontratës. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit për pavlefshmërinë e kontratës, nuk passjell ipso jure pavlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit”.²⁴

Rregullorja e ICC, në vazhdim të logjikës së mësipërme, autorizon nëpërmjet neneve të saj gjithashtu, përdorimin e dy koncepteve doktrimore: atë të ndashmërisë dhe të kompetencës së kompetencës. Ajo parashikon një proces me dy shkallë, në lidhje me çështjet e juridiksionit²⁵: Kur njëra nga palët ka ngritur një sfidë ndaj juridiksionit të të gjykatës së arbitrazhit, gjykata e ICC duhet fillimisht të përcaktojë *prima facie*, ekzistencën e marrëveshjes së arbitrazhit. Nëse plotësohet ky kusht, ICC mundet pastaj, që të vendosë vazhdimin e procedurës së arbitrazhit dhe në këtë moment i atribuohet kompetenca arbitrit, për të gjykuar mbi juridiksionin e vet. Më tej rregullat e ICC parashikojnë, që juridiksioni i arbitrit do të vazhdojë edhe atëherë kur ka një deklaratë, që kontrata është nul apo e pavlefshme dhe arbitri mund të gjykojë, në respekt të palëve dhe të çështjes në diskutim.

Rregullorja e ICC, ashtu si edhe ajo e UNCITRAL-it, përqafojnë dhe shpalosin të dyja parimet e ndashmërisë dhe kompetencës mbi kompetencën. Ligji për të drejtën ndërkombëtare private, i një shteti të caktuar, mundet që të reflektojë një pozicionim të ndryshëm nga UNCITRAL dhe ICC, ndaj këtyre doktrinave.²⁶

24 Ligji Model I UNCITRAL, Neni 16

25 INTERNATIONAL CHAMBER OF COMMERCE, PUB. No. 447-3, ICC Rules OF CONCILIATION AND ARBITRATION, at 23 (as amended Jan. 1, 1988)

26 Shiko çështjen Harbour Assurance Co. v. Kansa Gen. Int'l Ins. Co., [1992], 1 Lloyd's Rep. 81, 83 (Q.B.), (mbron teorinë se vetëm gjykata mund të shprehet përfundimisht në lidhje me juridiksionin)

Konkluzione

Në një botë që po zhvillohet me ritmeve kaq të shpejta, ku arbitrazhi ndërkombëtar tregtar po monopolizon tregun e mënyrave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të këtij lloji, del në plan të parë rritja e efikasitetit, shpejtësisë dhe integritetit të këtij procesi. Doktrina e ndashmërisë, apo e thënë ndryshe, e veçimit të konceptit të kontratës kryesore nga klauzola e arbitrazhit që përfshihet në të, i jep kësaj të fundit një status të veçantë, në raport edhe me mënyrën se si do të trajtohet kjo klauzolë.

Nga kjo rrjedh edhe kompetenca e arbitrit për të gjykuar mbi kontratën, klauzolën e arbitrazhit, marrëveshjen e arbitrazhit dhe juridiksionin e tij. Këto dy doktrina të materializuara edhe në rregulloret e institucioneve kryesore të arbitrazhit në botë, i kanë dhënë mundësinë procesit të arbitrazhit, që të shkëputet totalisht nga sistemi i zakonshëm gjyqësor (nëse gjykata e zakonshme do të vendoste për çështjet e juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit, kjo e dyta do të mbetej gjithmonë e ndërvarur nga e para). Kjo bën që procesi, të mund të kontrollohet totalisht nga gjykata e arbitrazhit, duke respektuar vullnetin e palëve dhe që e bën të distancohet nga hallka të shumta ndërgjyqësore, të cilat do të kompromentonin faktorin kohë, që është edhe një nga elementët kryesorët në të cilët mbështetet arbitrazhi. Gjithashtu, kjo gjë e bën atë edhe më fleksibël, për të zgjidhur mosmarrëveshjet në të ardhmen. Këto procese, mund të konsiderohen totalisht të justifikueshme, në aspektin e përkufizimit të konceptit të arbitrazhit, të qëllimit të tij, si dhe të mbrojtjes së interesave të palëve, të cilat i kanë besuar këtij sistemi.

Bibliografia

- 1- Alan Redfern, The Jurisdiction of an International Commercial Arbitrator (Mar. 1986).
- 2- Peter Stone, EU Private International Law, Harmonization of Laws (Elgar European law 2006)
- 3- Dr. Julian D.M Lew, CONTEMPORARY PROBLEMS IN INTERNATIONAL ARBITRATION (1986)
- 4- HOWARD M. HOLTZMANN & JOSEPH E. NEUHAUS, A GUIDE TO THE UNCITRAL MODEL LAW ON

- INTERNATIONAL COMMERCIAL ARBITRATION:
LEGISLATIVE HISTORY AND COMMENTARY 4 (1989)
(discussing UNCITRAL arbitration)
- 5- INTERNATIONAL CHAMBER OF COMMERCE, PUB. No. 447-3, ICC (as amended Jan. 1, 1988)
 - 6- Jean Robert & Thomas E. Carbonneau, *The French Law of Arbitration* (1983)
 - 7- Jennifer Bagwell, *Enforcement of Arbitration Agreements: The Severability Doctrine in the International Arena-Republic of Nicaragua v. Standard Fruit Co* (1992)
 - 8- Rene David, *L'arbitrage dans le commerce international*, Economica, 1982
 - 9- Stephen M. Schweber, *INTERNATIONAL ARBITRATION: THREE SALIENT PROBLEMS* (1987)
 - 10- W. LAURENCE CRAIG ET AL., *INTERNATIONAL CHAMBER OF COMMERCE ARBITRATION* (1990)
 - 11- <http://uk.practica law. com>
 - 12- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë (1996)
 - 13- Ligj nr.8688, datë 09.11.2000, “Për aderimin e RSh në Konventën “Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”.
 - 14- Konventa e Brukselit e dt 27 shtator 1968 “Mbi juridiksionin dhe ekzekutimin vendimeve ne ceshtjet civile dhe tregtare”

AKTET NORMATIVE NËNLIGJORE MIDIS JURIDIKSIONIT KUSHTETUES DHE ATIJ GJYQËSOR ADMINISTRATIV

**Dr. Erind MERKURI¹
Doc. Klesta HYSI²**

Hyrje

Si rregull, në bazë të sistemit kushtetues, aktiviteti i krijimit të normave është përqendruar në organin legjislativ, Kuvendin. Është ky i fundit i cili ka të drejtë të miratojë norma me fuqi juridike të përgjithshme, me qëllim rregullimin e marrdhënieve të ndryshme shoqërore si edhe organizimin dhe funksionimin e institucioneve të ndryshme, që në tërësinë e tyre përbëjnë administratën publike, organet e prokurorisë, gjykatat etj. Por aktiviteti normativ i një shteti, përveç Kuvendit ku miratohen normat juridike me karakter ligjor, është i përqendruar edhe në organet ekzekutive. Kështu Kushtetuta jonë parashikon se Këshilli i Ministrave nxjerr vendime dhe udhëzime,³ ndërsa ministrat nxjerrin urdhëra dhe udhëzime.⁴ Po kështu, Kushtetuta jonë njeh edhe një sërë organesh të tjera qendore, si Banka e Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor etj., të cilët mbi bazën e autorizimeve ligjore kanë të drejtë që të nxjerrin akte nënligjore me karakter normativ.

Kohët e fundit është vënë re një rritje e rolit prodhues të normave nënligjore në raport me atë ligjvënës të Kuvendit. Madje në doktrinë,

-
- 1 Lektor i së Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës.
 - 2 Lektore e së Drejtës Administrative në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës.
 - 3 Kushtetuta, neni 100, pika 5.
 - 4 Kushtetuta, neni 102, pika 4.

theksohet se në këtë rast mund të flasim për pushtet “legjislativ të administratës”.⁵ Arsyeet e një zhvillimi të tillë mund të gjenden në disa argumenta, si koha e kufizuar që ka në dispozicion Kuvendi për realizimin e funksionit legjislativ, bllokimi i këtij mekanizmi, karakteri teknik i çështjeve etj.⁶ I gjithë ky aktivitet legjislativ megjithëse me karakter nënligjor mund të jetë shkak për cënimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parimeve kushtetuese, mënyrës së organizimit të organeve kushtetuese dhe institucioneve të parashikuara prej saj, apo sferen e kompetencave të tyre. Për këtë arsye ligjvënësi ka parashikuar edhe kontrollin e këtyre akteve. Ky kontroll ushtrohet në disa forma dhe mënyra si edhe nga organe të ndryshme. Në këtë drejtim mund të flasim për kontrollin politik mbi administratën i cili ushtrohet nga Kuvendi, nëpërmjet komisioneve të tij të përhershme dhe hetimore,⁷ për kontrollin e brendshëm administrativ,⁸ për kontrollin gjyqësor mbi administratën publike⁹ si edhe për kontrollin kushtetues/konvencional që ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese.¹⁰

Format më të zakonshme të kontrollit dhe që shërbejnë për të kontrolluar pushtetin “legjislativ” të administratës, që janë të aksesueshme nga individët dhe që garantojnë më shumë sukses janë ato të cilat ushtrohen nga gjykatat si edhe nga Gjykatat Kushtetuese. Por bazuar në reformat më të fundit legjislativë në këto fusha, rezulton se ndodhemi përballë një juridiksioni konkurrues midis Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Administrative të Apelit (si edhe eventualisht të Kolegjit

5 Sadushi, Sokol, “*Pushteti legjislativ i administratës*”, botuar në Revistën “*Avokatia*”, Nr.6, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shtypshkronja “*Dea Print*”, Tiranë, Prill 2013, fq.53-76.

6 Po aty, fq.55-76.

7 Kushtetuta, neni 77.

8 K.Pr.A., nenet 131 e vijues.

9 Ligji nr.49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar.

10 Kushtetuta, neni 131, gërma “c”: Gjykata Kushtetuese vendos për: ... c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;

Administrativ apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë). Ky konkurim ndodh pasi Kushtetuta nga njëra anë dhe Ligji nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,¹¹ nga ana tjetër, u japin kompetencë lëndore për të gjykuar dhe vendosur në lidhje me vlefshmërinë e akteve normative nënligjore.

Për këtë arsye në këtë artikull do të ndalemi në analizën e juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor administrativ me qëllim eksplorimin e pikave të takimit midis tyre dhe për të përcaktuar kufijtë respektivë për secilin juridiksion.

1. Juridiksioni kushtetues

E drejta e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar edhe aktet normative nënligjore ka qenë parashikuar që në Kushtetutën e Austrisë të vitit 1920. Pra, që në fillimit e saj, drejtësia kushtetuese e tipit kelzenian e kishte të parashikuar një kompetencë të tillë. Kelzeni e justifikonte këtë zgjidhje kushtetuese për t’i dhënë juridiksionit kushtetues edhe kontrollin mbi rregulloret¹² në interes të unitetit dhe qartësisë substanciale të së drejtës për shkak të rëndësisë dhe dimensioneve që ka marrë aktiviteti rregullues nënligjor bazuar kjo edhe në sistemin e burimeve normative.¹³ Një kontroll i tillë njihet në shumicën e vendeve që zbatojnë sistemin kushtetues të centralizuar veçanërisht ato të vendeve lindore që dolën nga sistemi komunist ku në këtë rast mund të përmendim Kroacinë,

11 Referuar në vijim si LGJA.

12 Me rregullore sipas Kushtetutës Austriake kuptohen përveç rregulloreve në kuptim të ngushtë edhe dekretet, urdhëresat, si edhe akte të tjera nënligjore të parashikuara nga Kushtetuta. D’Orlando, Elena, “*La giustizia costituzionale in Austria*”, botuar në “*Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009, fq.123.

13 D’Orlando, Elena, “*La giustizia costituzionale in Austria*” botuar në “*Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009, fq.122.

Slloveninë, Hungarinë,¹⁴ Rusinë¹⁵ etj.

Kushtetuta jonë në nenin 131, gërma “c” të saj parashikon se Gjykata Kushtetuese kontrollon kushtetutshmërinë dhe pajtueshmërinë me marrëveshjet ndërkombëtare të *akteve normative të organeve qendrore*. Pra, në këtë rast duhet që të plotësohen dy kushte ku **së pari** akti duhet të ketë natyrë normative dhe **së dyti** duhet të jetë miratuar nga organe qendrore. Le ti analizojmë me rradhë.

Kuptimin e aktit normativ, deri vonë e ka dhënë doktrina,¹⁶ dhe më vonë u dha nga legjislacioni ynë. Kështu LGJA, në nenin 2 pika 3 të tij e përkufizon aktin normativ si çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij. Edhe Kodi i ri i Procedurave Administrative me shumë pak ndryshime nga LGJA ruan të njëjtin koncept dhe përkufizon qartë për herë të parë aktet administrative individuale, aktet administrative kolektive dhe aktin normativ nënligjor.¹⁷ Në kushtet kur K.Pr.A i vitit 1999¹⁸ përkufizonte vetëm aktin administrativ individual dhe përmendte aktet kolektive dhe normative pa bërë dallimin mes tyre, jurisprudenca kushtetuese ka ndihmuar në sqarimin e disa koncepteve doktrinare, duke mbajtur qëndrimin se:

Në vlerësimin e Gjykatës, tri kritere përcaktojnë ndarjen e aktit

14 Pistan, Carna, “*La giustizia costituzionale nell’Europa Centro-Orientale: Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria*”, botuar në “*Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009, fq.419-420.

15 Di Gregorio, Angela, “*La Corte Costituzionale della Russia*”, botuar në “*Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009, fq.457.

16 Sadushi, Sokol, “*E Drejta Administrative 2, Teoria e aktit administrativ*”, Shtëpia Botuese “ORA”, Tiranë 2005.

17 Ligji nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, neni 3 pika 2.

18 Ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

nënligjor në individual ose normativ: (i) **Subjektet të cilave akti u drejtohet** - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktueshëm në bazë të karakteristikave të përgjithshme, ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; (ii) **Objekti** - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete të së drejtës administrative, ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes, me karakter abstrakt; (iii) **Karakterit shterues/jo shterues** - efektet shtrihen tek subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njëhershme, ose tek subjekte të papërcaktuara të së drejtës, në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme.¹⁹

Në këtë drejtim mund të themi se në kuptim të nenit 131, pika 1, gërma “c” të Kushtetutës rezulton se karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, që ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor.²⁰ Përjashtimisht nga ky rregull, GjK mund të investohet për aktet individuale në rastet e parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta si psh. në rastin e shkarkimit/shpërndarjen të organeve të njëjësive të qeverisjes vendore (neni 115), të vërtetojë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të deputetëve pas vendimit të Kuvendit (neni 70, pika 4) të deklarojë shkarkimin e Presidentit pas vendimit të Kuvendit (neni 90, pika 3) etj.

Përsa i përket kriterit të dytë, atë të organit miratues, rezulton se Kushtetuta përdor vetëm termin *organ qendror*, pa e shtjelluar atë, nëse duhet të kuptohen vetëm organet qendore me natyrë kushtetuese apo edhe organet e tjera që krijohen në bazë të ligjeve të veçanta. Për këtë aspekt në doktrinë është mbajtur qendrimi se në nocionin “*organe qendrore*” përfshihen jo vetëm Këshilli i Ministrave por edhe institucionet e tjera qendrore që, sipas ligjit, identifikohen si të tillë. Këtë kuptim të organeve qendrore e jep edhe neni 117, pika 1, i Kushtetutës që parashikon botimin në Fletoren Zyrtare, si një kusht për marrjen e fuqisë juridike krahas ligjeve

19 Vendimi nr.14, datë 21.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese, parag.22.

20 Vendimi nr.14, datë 21.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

dhe akteve normative të Këshillit të Ministrave e të ministrave, edhe aktet e institucioneve të tjera qendrore. Norma kushtetuese e sipërcituar, duke mos përfshirë institucionet e tjera qendrore nga nocioni “organ qendror”, në të njëjtën mënyrë ka pranuar juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese edhe në drejtim të kontrollit të kushtetueshmërisë së akteve normative që ato nxjerrin.²¹ Po kështu edhe një tjetër grup autorësh ka mbajtur qëndrimin se janë edhe një kategori aktesh që dalin nga organe administrative të pavarura, si ILDKPKI, RTSH, KKRTSH, Autoriteti i Konkurrencës, etj, që nëse janë normative dhe për sa kohë kanë çënuar interesat e subjekteve kushtetues të legjitimuar për t’i kundërshtuar, mendojnë se mund të bëhen objekt të një gjykimi kushtetues.²²

Qëndrimi i mësipërm doktrinor duket se nuk është pranuar nga Gjykata Kushtetuese. Kështu në një rast kur kërkesa ishte paraqitur kundër rregullores se Shkollës së Lartë të Magjistraturës, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

*Kolegji, bazuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 131 të Kushtetutës, vëren se, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për të vendosur për kushtetutshmërinë e akteve normative që paraqiten në formën e ligjit, të marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore. Kolegji, referuar objektit të kësaj kërkesë, i cili përcakton edhe lëndën e shqyrtimit kushtetues, çmon se akti që kërkohet të bëhet objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese, edhe pse është një akt normativ, nuk përfshihet në llojet e akteve të mësipërme normative për të cilat ka juridiksion kjo gjykatë. Si rrjedhim, Kolegji vlerëson se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për shqyrtimin e kësaj kërkesë.*²³

Në këtë vendim, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka bërë një dallim midis akteve normative, duke pranuar se ka edhe akte normative për të cilat Gjykata nuk ka juridiksion. Në këtë drejtim rezulton se objekt gjykimi mund të jenë vetëm aktet normative të cilat miratohen nga

21 Sadushi, Sokol, “Drejtesia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.213.

22 Dobjani, Ermir; Toska, Elsa; Puto, Erlir; Dobjani, Erajd; “E drejta administrative – Kontrolli mbi Administratën Publike”, Shtëpia Botuese “EMAL”, Tiranë 2013, fq.286.

23 Vendimi nr.30, datë 2.3.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

organet kushtetuese por jo ato që miratohen nga organe të tjera qendrore. Vetiu këto akte janë objekt gjykimi pranë gjykatave administrative.

Nga sa më sipër rezulton se objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese mund të jenë vetëm aktet normative të organeve kushtetuese apo institucioneve të parashikuara prej saj. Pra, objekt janë aktet e Këshillit të Ministrave, ministrave, Bankës së Shqipërisë, Këshillit të Lartë të Gjyqësor etj. Ajo që duhet theksuar në këtë rast është se nuk është objekt i kontrollit kushtetues në këtë lloj gjykimi ometimi i organeve qendrore për të miratuar akte normative nënligjore megjithëse janë të autorizuar nga ligji për ta bërë diçka të tillë. Ky lloj qëndrimi mbahet nga të gjitha sistemet e kontrollit kushtetues, përfshirë edhe ato që parashikojnë një kontroll mbi ometimin legjislativ.²⁴

Një tjetër akt që përfshihet si juridiksion i Gjykatës Kushtetuese në këtë rast është edhe rregullorja e Kuvendit. Por në këtë rast rregullorja e Kuvendit paraqet një veçanti. Kështu sipas jurisprudencës kushtetuese rezulton se:

*Nisur nga karakteri normativ i saj dhe referuar nenit 131, gërma "c" të Kushtetutës, Rregullorja, mund të jetë vetëm objekt i kontrollit kushtetues në rastet kur dispozita të nivelit kushtetues, të përfshira në të, janë të papajtueshme me Kushtetutën.*²⁵

Nga pasazhi i mësipërm rezulton se rregullorja e Kuvendit mundet që të bëhet objekt i kontrollit kushtetues vetëm pjesërisht dhe konkretisht vetëm normat juridike të rregullores të cilat detajojnë parashikimet kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit. Rëndësia e këtij kontrolli qëndron në faktin për të evituar që Kuvendi të mundet, nëpërmjet ndryshimeve të rregullores, të tejkalojë kufijtë që Kushtetuta i ka vendosur pushtetit legjislativ.²⁶

Një tjetër moment i rëndësishëm për t'u analizuar është mundësia

24 Belletti, Michele, "Il sistema costituzionale portoghese", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.283.

25 Vendimi nr.29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

26 Spechia, Marina Calamo, "La giustizia costituzionale in Francia", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.209.

e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar urdhërat e organeve të administratës publike. Karakteristikat e urdhërit mund të përmbliidhen në i) janë të brendshme, ii) janë të detyrueshme për njësitë administrative që varen prej organeve që i nxjerrin ato; iii) nuk i drejtohen individëve, iv) dalin për zbatim të akteve me fuqi të përgjithshme.²⁷ Në këtë aspekt, si një akt me natyrë individuale, urdhëri, është jashtë juridiksionit kushtetues.

Kushtetuta në nenin 131, gërma “c” të saj parashikon gjithashtu edhe kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar kushtetushmërinë e akteve normative të organeve vendore. Sipas ligjit themelor rezulton se Këshilli i Qarkut ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi detyruese të përgjithshme për qarkun. Organet e njërive të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhëra. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe. Karakteri normativ i këtyre akteve del edhe nga fakti se edhe pse me shtrirje territoriale të kufizuar, nëse grupi i subjekteve është i papërcaktuar si edhe nëse ato janë jo shteruese, pra bëhen burim për nxjerrjen e akteve të karakterit individual, aktet e pushtetit vendor do të konsiderohen normative. Gjithsesi *expressis verbis* Kushtetuta e përcakton karakterin e tyre normativ në nenin 131, gërma “c” të saj. Në këtë kontekst akte të tilla janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim.²⁸

Në përgjithësi për këtë lloj gjykimi vlen i njëjti trajtim që kemi bërë përsa i përket kontrollit të akteve normative të organeve qendrore. Bazuar në këtë trajtim rezulton se objekt gjykimi mund të jenë vetëm aktet e organeve vendore që parashikohen nga Kushtetuta, bashkitë, dhe qarqet. Aktet normative të organeve të tjera vendore që mund të krijohen me ligj,²⁹ nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese.

27 Dobjani, Ermir; Toska, Elsa; Puto, Erlir; Dobjani, Erajd; “*E drejta administrative – Kontrolli mbi Administratën Publike*”, Shtëpia Botuese “EMAL”, Tiranë 2013, fq.302.

28 Dobjani, Ermir; Toska, Elsa; Puto, Erlir; Dobjani, Erajd; “*E drejta administrative – Kontrolli mbi Administratën Publike*”, Shtëpia Botuese “EMAL”, Tiranë 2013, fq.303.

29 Kushtetuta, neni 108, pika 1: Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.

2. Juridiksioni gjyqësor administrativ

Sic e përmendem më sipër ligjëvënësi ka parashikuar edhe kontrollin e veprimtarisë administrative nëpërmjet gjykatave administrative.³⁰ Përpara hyrjes në fuqi të LGJA, situata rregullohej nga Kodi i Procedurës Civile i cili në nenin 326 të tij kishte një formulim disi konfuz.³¹

Në rastin e gërmës “a” dispozita paraqiste një kontradiktë me vetveten pasi në dukje përjashtonte nga kontrolli gjyqësor aktet normative kurse nga ana tjetër vendoste si përjashtim faktin nëse këto akte cënonin të drejtat dhe liritë themelore. Siç me të drejtë ka theksuar doktrina në këtë rast përjashtimi kthehej në rregull pasi nuk mund të mendoj që do të kishte një akt normativ nënligjor i cili nuk do të prekte një të drejtë apo liri themelore.³² Këtë kontradiktë praktika gjyqësore u mundua që ta zgjidhte në këtë mënyrë:

14.1. Nga përmbajtja e nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile del se mund të kundërshtohen në gjykatat e zakonshme vetëm aktet administrative individuale (duke përjashtuar ato të parashikuara në pikat “b” dhe “c”). Pjesa e parë e pikës “a”, pikat “b” dhe “c” të nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile kanë karakter ndalues, ndërsa pjesa e dytë e pikës “a” të këtij neni ka karakter lejues.

14.1.a) Duke e parë në tërësinë e saj dispozitën, rezulton se gjykatat e zakonshme nuk mund të gjykojnë padi të cilat kanë për objekt kundërshtimin e akteve normative. Ato nuk mund të gjykojnë në mënyrë abstrakte normën juridike. Veprimtaria e gjykatës në procesin e shqyrtimit të konflikteve administrative është drejtpërdrejt e lidhur me mbrojtjen e

30 LGJA, nenet 7, 10, 18, 37 dhe 38.

31 K.Pr.C., neni 326 (i shfuqizuar): Nuk mund të ngrihen padi në gjykatë për: a) aktet administrative të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës publike të nivelit qendror ose vendor që kanë karakter normativ, përveç kur ato cenojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe interesa të tjerë të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë; b) aktet administrative që kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë; c) aktet administrative të cilat sipas Kushtetutës janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese.

32 Sadushi, Sokol, “E Drejta Administrative 2, Teoria e aktit administrativ”, Shtëpia Botuese “ORA”, Tiranë 2005.

të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjekteve (personave fizikë e juridikë). Megjithatë, gjykata e zakonshme kur gjatë shqyrtimit të një padie me objekt mbrojtjen e një të drejte konkrete, konstaton se një akt nënligjor me karakter normativ vjen në kundërshtim me ligjin, ka për detyrë të zbatojë ligjin drejtpërdrejt edhe sikur kjo të lerë pa fuqi aktin nënligjor. Bëhet fjalë në këtë rast për shqyrtim incidental të aktit normativ nga gjykata e zakonshme.

Kjo është mënyra se si duhet kuptuar gërma “a” e nenit 326 të Kodit të Proedurës Civile.³³

Nga arsyetimi i mësipërm rezulton se gjykatat e zakonshme nuk kishin të drejtë që të shqyrtonin në mënyrë abstrakte ligjshmërinë e një akti normativ nënligjor, po kishin të drejtë që në rast se e konstatonin atë si të kundërligjshëm, ta shmangnin zbatimin e tij duke i'u referuar drejtpërsëdrejti ligjit.

Me hyrjen në fuqi të LGJA-së, situata ndryshoi. Ky ligj aktualisht njeh dy forma kontrolli mbi aktet normative nënligjore. Sipas formës së parë ruhet kontrolli incidental i gjykatave administrative mbi aktet normative nënligjore.³⁴ Nga ky parashikim rezulton se gjykatat administrative kanë të drejtë që të shmangin zbatimin e një akti normativ të paligjshëm duke zbatuar drejtpërdrejtë ligjin. Në rastin e dytë LGJA u jep mundësinë subjekteve të ndryshme që të kundërshtojnë drejtpërsëdrejti në Gjykatën Administrative të Apelit një akt normativ nënligjor e cila në këtë rast e shqyrton si gjykatë e shkallës së parë çështjen në trup gjykues me pesë gjyqtarë.

33 Vendimi nr.00-2010-1158 (360), datë 30.9.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

34 LGJA, neni 38: Gjykata administrative, gjatë shqyrtimit gjyqësor të një veprimi administrativ, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos të mos zbatojë një akt nënligjor normativ, në bazë të të cilit është kryer veprimi administrativ që shqyrtohet, kur çmon se akti nënligjor është i paligjshëm. Gjykata vendos në këtë mënyrë edhe nëse gjykimi parësor i aktit normativ nuk është në kompetencën e saj. Ky vendim përmban në mënyrë të hollësishme shkaqet e paligjshmërisë, të konstatuara nga gjykata.

3. Pikëtakimet midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor administrative.

Duke analizuar LGJA rezulton se gjykata administrative ndër të tjera janë kompetente për mosmarrëveshjet që lindin nga aktet normative nënligjore³⁵ por me kusht që të mos jenë kompetencë e Gjykatës Kushtetuese.³⁶ Këto dy parashikime, me natyrë të përgjithshme, nuk e zgjidhin problemin e konkurimit apo edhe të konfliktit midis juridiksioneve. Kështu legjislacioni nuk ka përcaktuar asnjë kriter mbi bazën e së cilës të specifikojë në mënyrë shteruese se cilat janë ato akte që kanë mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë arsye bëhet e nevojshme një analizë e kufirit se ku ndahet juridiksioni kushtetues dhe ai gjyqësor për të shqyrtuar akte të këtij lloji.

Parimisht mund të ngrihen disa hipoteza. Një ndër to ka të bëjë pranimin e ekzistencës së një juridiksioni konkurues të mirëfilltë. Sipas kësaj hipoteze Gjykata Kushtetuese dhe gjykatat administrative shqyrtojnë pa asnjë kufizim aktet normative nënligjore të cilat kundërshtohen pranë tyre. Hipoteza e dytë lidhet me shterimin e mjeteve, ku sipas së cilës, subjektet e interesuar duhet që detyrimisht të shterojnë fillimisht rrugën përpara Gjykatës Administrative të Apelit dhe më pas eventualisht në Gjykatën e Lartë (e cila e gjykon në Kolegjin Administrativ ose në Kolegje të Bashkuara), përpara se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Hipoteza e tretë lidhet me ndarjen e këtyre juridiksioneve bazuar në natyrën e pretendimeve që ngrihen nga kërkuesi/paditësi. Le t'i trajtojmë ato me rradhë.

a) Juridiksioni konkurues. Sipas kësaj hipoteze, kufiri midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor administrativ është një kufi teorik pa vlerë paktike. Në bazë të kësaj teorie, një akt mund të jetë objekt si i kontrollit kushtetues ashtu edhe i kontrollit gjyqësor administrativ.

35 LGJA, neni 7 gërma “a”: *Gjykatat administrative janë kompetente për: a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;*

36 LGJA, neni 8 gërma “a”: *Gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet: a) të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;*

Kjo lidhet me vetë shkaqet që parashikon LGJA mbi bazën e të cilava Gjykata Administrative e Apelit do të mund të shqyrtojë vlefshmërinë e një akti nënligjor normativ. Sipas nenit 37, pikat 3 dhe 4 rezulton se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton ligjshmërinë e aktit normative nënligjor bazuar në faktin nëse *a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit; b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit; c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë*. Pretendimet që mund të ngrihen bazuar në këto kritere, të cilat janë formuluar në mënyrë shumë të përgjithshme, mund të jenë si me natyrë kushtetuese ashtu edhe më natyrë ligjore. Madje në disa raste, standardet kushtetuese janë dubluar edhe si standarde ligjore. Kështu parimet e propocionalitetit dhe të barazisë që parashikohen nga nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës, parashikohen edhe si standarde ligjore nga nenet 12 dhe 17 të Kodit të Procedurave Administrative.

Përsa i përket të metave procedurale që mund të ketë një akt normativ nënligjor situata bëhet më e theksuar. Pretendimet kryesore që ngrihen për të metat e akteve normative nënligjore, nga pikëpamja kushtetuese, janë të meta që lidhen me mosrespektimin e kërkesave të nenit 118 të Kushtetutës. Por mos respektimi i kësaj dispozite, siç me të drejtë është pranuar edhe nga doktrina passjell njëkohësisht edhe paligjshmëri të aktit.³⁷

b) Juridiksioni i shkallëzuar. Sipas kësaj teorie, subjektet e prekura nga një akt normativ nënligjor kanë detyrimin që fillimisht t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Apelit dhe në rast të një vendimi negativ, ti drejtohen nëpërmjet rekursit Gjykatës së Lartë. Në rast se janë të pakënaqur edhe me këtë shkallë gjykimi atëherë mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Kjo teori duket se është debatuar edhe në Gjykatën Kushtetuese, ku disa gjyqtarë kushtetues në një “mendim pakice” kanë mbajtur qëndrimin se në fillim kërkesit duhet që t'i drejtohen juridiksion gjyqësor administrativ dhe më pas do të mund që t'i drejtohen juridiksionit kushtetues. Këto argumenta mund të përmbliidhen si vijon:

37 Sadushi, Sokol, “E Drejta Administrative 2, Teoria e aktit administrativ”, Shtëpia Botuese “ORA”, Tiranë 2005.

Së pari: *Respektimi i parimit të subsidiaritetit.* Parimi i subsidiaritetit është konsideruar si një vlerë e nënkuptuar kushtetuese në themelet e një shoqërie demokratike. Ai mund të jetë subsidiaritet institucional (institutional subsidiarity) apo subsidiaritet juridiksional (jurisdictional subsidiarity). Subsidiariteti institucional si parim ligjor është i konsoliduar dhe nënkupton që një organ gjithëpërfshirës më i lartë nuk duhet të merret me një çështje që një organ tjetër më i ulët mund të merret dhe ta zgjidhë atë në mënyrë efektive. Në gjykimin kushtetues gjerman subsidiariteti institucional ka frymëzuar federalizmin në një masë të konsiderueshme. Ndërsa subsidiariteti juridiksional është një instancë e subsidiaritetit institucional dhe ka të bëjë me ndarjen e përgjegjësisë për të gjykuar juridiksioneve të ndryshme. Koncepti i subsidiaritetit ka një rol konstruktiv në gjykimin dhe interpretimin kushtetues. Në jurisprudencën kushtetuese gjermane, subsidiariteti institucional pengon Gjykatën Federale të gjykojë mbi çështje për të cilat një juridiksion (fora) tjetër mund të vendosë. Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut ka juridiksion ekskluziv në një numër të kufizuar çështjesh por vetë ajo është shprehur qartë se këto raste janë të jashtëzakonshme dhe gjykata kryesisht i vë rëndësi të madhe përfitimit që ajo ka nga njohuritë e gjykatës/gjyqtarit a quo (atij që gjykon një çështje konkrete). Kështu Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut herë pas here preferon të mos gjykojë mbi një çështje kushtetutshmërie të një norme ligjore deri sa gjyqtarë të tjerë në juridiksione të tjera të vlerësojnë nëse norma ligjore duhet të shfuqizohet ose jo.³⁸

Së dyti: *Zgjerimi i juridiksionit gjyqësor administrativ.* Sipas të njëjtit mendim në pakicë nga pikëpamja teorike dhe normative, në thelb, kontrolli i ligjshmërisë ndaj akteve nënligjore normative, që ushtrohet nga Gjykata Administrative e Apelit është njëkohësisht edhe kontrolli i kushtetutshmërisë (nenet 4, 116 dhe 118 të Kushtetutës). Kuptimi normativist bazohet në hierarkinë juridike dhe në supremacinë e normës kushtetuese ndaj akteve më të ulëta, që në doktrinën kushtetuese njihet si parimi i epërsisë (supremacisë) të Kushtetutës. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të

38 Mendimi në pakicë në vendimin nr.60, datë 16.9.2016 i Gjykatës Kushtetuese, parag.15-16.

normave kushtetuese, që përbën një parim tjetër të rëndësishëm, atë të kushtetutshmërisë funksionale. Gjyqtari administrativ kur realizon kontrollin e përputhshmërisë së aktit administrativ me ligjin në fakt nuk ndalohet të realizojë dhe kontroll të kushtetutshmërisë, pasi kushtetutshmëria, siç u përmend më sipër, identifikohet edhe me parimin e hierarkisë së normave të së drejtës (stricto sensu), që do të thotë se aktet administrative dhe ligjet duhet të përputhen me normat e Kushtetutës. Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlershmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike” (shih vendimin nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetutshmëria e përfshin ligjshmërinë, pra një akt nënligjor antikushtetues është dhe i paligjshëm, ndërsa e kundërta nuk është gjithmonë e vërtetë, që do të thotë se një akt mund të jetë i paligjshëm, por jo patjetër antikushtetues. Në këtë këndvështrim, parimi i subsidiaritetit nënkupton që kur paraqiten pretendime për paligjshmërinë e një akti nënligjor, jo vetëm që gjykatat administrative duhet të kenë mundësinë të shprehen lidhur me thelbin e aktit, por edhe të kenë mundësinë të bëjnë kontrollin e ligjshmërisë e kushtetutshmërisë së tij, bazuar në parimin e hierarkisë së normave juridike.³⁹

Nga arsyetimi i mësipërm rezulton qartësisht se bazuar në parimin e subsidiaritetit dhe në mundësinë që ka juridiksioni gjyqësor administrativ për të kontrolluar aktet normative nënligjore, Gjykata Kushtetuese duhet që të refuzojë të shqyrtojë kërkesa kundër këtyre akteve nëse më parë nga subjekti kërkues nuk është shfrytëzuar rruga gjyqësore administrative. Në thelb të këtij arsyetimi kërkohet më parë shterimi i mjeteve juridike të zakonshme që më pas të shfrytëzohet rruga kushtetuese, e cila në këtë rast vepron si një instancë e fundit, mbasi të jetë shprehur Gjykata Administrative e Apelit dhe eventualisht Gjykata e Lartë.

39 Mendimi në pakicë në vendimin nr.60, datë 16.9.2016 i Gjykatës Kushtetuese, parag.20-21.

c) Juridiksioni i ndarë, bazuar në natyrën e pretendimeve. Sipas kësaj hipoteze parimisht ndarja ka të bëjë me natyrën e pretendimeve që ngrihen. Kështu në rast se ngrihen pretendime të natyrës kushtetuese çështja i përket normalisht juridiksionit kushtetues dhe në rast se pretendimet janë për paligjshmëri atëherë çështja i përket juridiksionit gjyqësor administrativ.

Ky moment është deri diku i qartë përsa i përket pretendimeve që ngrihen për të metat materiale të aktit. Në këtë rast, nëse ngrihen pretendime për cënimin e parimeve apo të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese atëherë çështja është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa nëse pretendimet ngrihen për të drejta ligjore atëherë çështja është në kompetencën e gjykatave administrative. Në këtë rast vetë LGJA parashikon kufijtë e shqyrtimit material të aktit normativ nënligjor duke përcaktuar se në këtë rast vlerësohen së pari nëse zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit, së dyti nëse zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit dhe së treti zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.⁴⁰

Duke analizuar të treja hipotezatat e mësipërme jemi të mendimit që konkluzioni më i qartë do të ishte një kombinim të hipotezës së parë (përsa i përket të pretendimeve për të meta procedurale të aktit) me hipotezen e tretë (përsa i përket pretendimeve për të meta materiale të aktit).

Kështu jemi të mendimit që nga pikëpamja materiale, juridiksioni kushtetues dhe gjyqësor administrativ ndahen nga njëri – tjetri bazuar në pretendimet që ka ngritur kërkuesi. Është e pamundur që Gjykata Administrative e Apelit të mund të shqyrtojë kërkesa që kanë të bëjnë me pretendime që janë më natyrë kushtetuese, të tilla si pretendimet në lidhje me cënimin e lirisë së shprehjes, së drejtës për informim, të drejtën e pronës, të drejtën për punë dhe profesion etj.

Nga ana tjetër Gjykata Kushtetuese nuk mundet që të shqyrtojë pretendime që kanë të bëjnë me cënim të të drejtave që burojnë nga ligji. Kështu për shembull nëse palët kufizohen vetëm në pretendime që kanë të bëjnë me të drejta të njohura ligjërisht por që nuk prekin element të së drejtës kushtetuese, kompetente do të ishte Gjykata Administrative

40 LGJA, neni 37, pika 3.

e Apelit. Në disa raste megjithëse ndarja mund të duket e vështirë në praktikë, evoluimi i jurisprudencës së të dyja juridiksioneve do ta bëjë në të ardhmen dallimin për raste të caktuara më të qartë.

Nga ana tjetër përsa i përket pretendimeve për të meta procedurale, jemi të mendimit që në këtë rast ndodhemi përballë juridiksionit konkurrues. Kështu nëse sipas nenit 118 pika 2 e Kushtetutës, nxjerrja e një akti të paautorizuar nga ligji passjell antikushtetutshmëri, sipas nenit 108, gërma “a”, nënpika “i” të K.Pr.A. po i njëjti veprim, që parashikohet si nxjerrja e aktit në tejkalim të kompetencave, passjell paligjshmëri. Në thelb pavarësisht emrit që mund t’i vejmë, në varësi të situatës, nxjerrja e një akti normativ nënligjor në mungesë të një autorizimi të shprehur ligjor sjell njëkohësisht antikushtetutshmërinë dhe paligjshmërinë e tij. Po e njëjta gjë mund të thuhet për formën dhe procedurën në krahasim me kërkesat e tjera të nenit 118 të Kushtetutës.

Në këtë rast dukshëm kemi një juridiksion konkurrues midis Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave administrative. Këto dy gjykata kanë të drejtë që të shqyrtojnë të metat procedurale të një akti normativ nënligjor bazuar në thelb në të njëjtat kritere kushtetuese dhe ligjore. Në këtë rast dallimi duhet të bëhet në bazë të aksesit që kanë subjektet për të kundërshtuar një akt të tillë në Gjykatën Kushtetuese apo në gjykatën administrative të apelit. Ky dallim është përcaktues pasi subjektet e kushtëzuar (veçanërisht organizatat dhe individët), në bazë të nenit 134 të Kushtetutës, përgjithësisht kanë një akses të kufizuar.⁴¹ Për këtë pjesë, ligjvënësi u ka siguruar këtyre subjekteve aksesin në gjykatën administrative të apelit.

Më konkretisht përsa u përket subjekteve, që shfaqen në formë

41 Vendimi nr.17, datë 25.7.2008 i Gjykatës Kushtetuese: *Edhe në lidhje me pretendimin për cenim të nenit 118 të Kushtetutës, Gjykata vëren se ky pretendim do të merrej në konsideratë vetëm në plotësim të kushtit të kërkuar nga pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës, pra vetëm nëse do të rezultonte se kërkuesi kishte një interes real të cenuar nga norma e goditur. Nga analiza e mësipërme, rezultoi se e drejta e lirisë së veprimtarisë ekonomike nuk cenohet nga akti, objekt shqyrtimi, dhe për pasojë, kërkuesi nuk legjitimohet për të iniciuar një proces kontrolli kushtetutshmërie, në lidhje me nenet 131/c dhe 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*

të organizuar dhe që legjitimohen për t'u drejtuar gjykimit kushtetues dhe atij gjyqësor administrativ, situata ndwrlkohet disi. Kështu sipas Kushtetutës, subjektet që mund të ankohen ndër të tjera janë organizatat e tjera⁴² por vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.⁴³ Nga ana tjetër sipas LGJA, rezulton se ankim në Gjykatën Administrative të Apelit mund të bëjnë çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik.⁴⁴

Duke i analizuar me kujdes këto dy dispozita si edhe bazuar në jurisprudencën kushtetuese, rezulton se në Gjykatën Kushtetuese mund të ankohen vetëm organizata të regjistruara sipas legjislacionit përkatës dhe që janë me anëtarësi të hapur.⁴⁵ Ndërsa formulimi që përdor LGJA është me i gjerë, përse i përket subjekteve që mund të legjitimohen në këtë rast. Kështu, pavarësisht përmendjes fillimisht të *shoqatave* si subjekte, ligji më pas të referon në *grupet e interesit*. Këto të fundit janë paraqesin një larshmëri të lartë ku përfshihen si organizata me anëtarësi ashtu edhe ato pa anëtarësi dhe që mund të shfaqen në forma të ndryshme.⁴⁶ Pra, në këtë drejtim rrethi i subjekteve që mund të ankohen është më i gjërë në gjykimin administrativ se sa në atë kushtetues.

Përse i përket hipozites së dytë jemi të mendimit që ajo nuk mundet që të merret në konsideratë. Kështu në rast se do të pranohej llogjika e subsidiaritetit atëherë neni 131, pika 1, gërma “c” e Kushtetutës do të mbetej pa kuptim përse i përket mundësisë së aksesit të subjekteve të kushtëzuara (Kryetari i kontrollit të Lartë të Shtetit, organet qe qeverisjes

42 Kushtetuta, neni 134, pika 1 gërma “h”.

43 Po aty, neni 134, pika 2.

44 LGJA, neni 15, gërma “d”.

45 Vendimi nr.7, datë 27.2.2013 i Gjykatës Kushtetuese, parag.19: *Referuar statusit të saj juridik, si një qendër së cilës i mungon anëtarësia, ajo nuk përfaqëson interesa të anëtarëve të saj, por, në cilësinë e organizatës jofitimprurëse, ndjek një qëllim në të mirë dhe interes të publikut duke ofruar, ndër të tjera, ndihmë ligjore falas (pro bono) për disa shtresa të caktuara të popullsisë, të cilat nuk kanë mundësi të përballojnë financiarisht shërbimet e një mbrojtësi ligjor apo shpenzimet gjyqësore.*

46 Olldashi (Boçi), Enkelejda, “Hyrje mbi teorinë e grupeve të interesit”, Shtëpia Botuese “Globus” R., Tiranë 2010, Tiranë 2010, fq.12-13.

vendore, komisionerirët që mbrojnë të drejtat e njeriut, organizatat e tjera). Kjo pasi nëse këto subjekte do të duhej që të shteronin mjetet e tjera juridike, përkatësisht kundërshtim i aktit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, atëherë ankimi i tyre në Gjykatën Kushtetuese nuk do të ishte një ankim kundër aktit nënligjor normativ (sipas nenit 131, pika 1 gërma “c” e Kushtetutës). Kjo sepse si dispozitat kushtetuese ashtu edhe ato ligjore⁴⁷ nuk parashikojnë shterimin e një rrugëve të tjera juridike.

Një tjetër argument në mbështetje të tezës së mësipërme lidhet edhe me traditën historike. Kështu megjithëse më parë, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (nenet 324 – 331), gjykatat e zakonshme nuk kishin të drejtë të shfuqizonin aktet normative nënligjore, ato përsëri ushtronin kontroll ndaj tyre. Në këtë drejtim në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë është pranuar vazhdimisht mundësia për të ushtruar kontroll mbi këto akte dhe në rast se ato nuk ishin në përputhje me ligjin atëherë shmangej zbatimi i tyre.⁴⁸ Pra, kontroll gjyqësor mbi aktet normative nënligjore ka pasur edhe më parë. Në atë kohë nuk është se kërkohej nga Gjykata Kushtetuese, që përpara se një akt normativ nënligjor të kundërshtohej përpara saj të shterohej edhe kjo rrugë gjyqësore. Ky konkluzion ishte mëse i drejtë pasi sic e përmendëm më sipër si Kushtetuta dhe ligji organik i Gjykatës Kushtetuese nuk e kërkojnë një gjë të tillë. Në këtë këndvështrim nuk mund të shërbejë si bazë të ndryshimit të kërkesave kushtetuese, fakti që më vonë ligjvënësi ka miratuar ligjin për krijimin e gjykatave administrative dhe i ka dhënë të drejtën Gjykatës Administrative të Apelit dhe eventualisht Gjykatës së Lartë të drejtën për të kontrolluar edhe ligjshmërinë e akteve normative nënligjore. Nëse do të pranohej ky moment si shkak për të ndryshuar qendrimin e Gjykatës Kushtetuese, atëherë kjo do të thotë që të pranohet teoria sipas së cilës Kushtetuta mund të ndryshohet edhe me ligje të zakonshme, teori që

47 Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, nenet 49 – 51/a.

48 Vendimi Unifikues nr.8, datë 12.9.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: Por verehet se, aktet e nxjerra nga Keshilli i Ministrave i kane kaluar kufijte e autorizimit te dhene nga ligji, pasi jane shtrire per ceshtje qe ligji nuk i ka parashikuar dhe tej parimeve qe vete ligji ka pranuar.

kuptohet është e papranueshme në një shtet të së drejtës. Duke u bazuar në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese sipas së cilës *atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji*,⁴⁹ arrihet lehtësisht në konkluzionin që miratimi i ligjit për gjykatat administrative nuk e ka ndryshuar natyrën e gjykimit kushtetues përsa i përket akteve normative nënligjore.

Duke vijuar me argumentat e tjerë, pretendimi për shterimin e rrugës gjyqësore administrative paraqet një tjetër problem. Kështu në rast se do të duhej të shterohet në fillim ankimet në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, ankimi në Gjykatën Kushtetuese në këtë rast do të ishte një ankim i zakonshëm individual (sipas nenit 131, pika 1, gërma “f” e Kushtetutës). Ky argument bazohet në faktin se pas ndryshimeve të fundit kushtetuese⁵⁰ individët (në nocionin individ, sipas jurisprudencës kushtetuese, përfshihet cdo subjekt që ka qenë palë në një mosmarrëveshje gjyqësore),⁵¹ mund të ankohen kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Me termin kundër çdo akti të pushtetit publik, në këtë rast do të kuptohen edhe aktet normative nënligjore. Me tej vetë ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të ndryshimeve që ka pesuar,⁵² me qëllim harmonizimit me ndryshimet kushtetuese, ka parashikuar se

49 Vendimi nr.212, datë 29.10.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

50 Realizuar në bazë të ligjit 76/2016.

51 Vendimi nr.23, datë 20.4.2016 i Gjykatës Kushtetuese, parag.14: Në jurisprudencën e saj Gjykata ka bërë dallimin e legjitimitetit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale, nga legjitimiteti i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. E drejta për akses në gjykatë, si një e drejtë e natyrës procedurale, duhet të respektohet e të përdoret nga çdo subjekt që konsiderohet palë në një proces dhe që preket në mënyrë të drejtpërdrejtë prej tij. Një e drejtë e tillë nuk mund të cenohet, sepse duke qenë një element i së drejtës në tërësi dhe që rrjedh nga thelbi i shtetit të së drejtës, garanton barazinë e palëve në procesin gjyqësor. Për këtë arsye ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk mund të kufizohet për asnjë subjekt, përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë.

52 Realizuar me ligjin nr.99/2016.

objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ.⁵³ Me tej po i njëjti ligj parashikon se kur Gjykata Kushtetuese shqyrton kushtetutshmërinë e një akti dhe arrin në përfundimin se ai bazohet mbi një ligj ose akt normativ antikushtetues, gjykata vendos njëkohësisht edhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ.⁵⁴

Parashikimet e mësipërme kushtetuese dhe ligjore tregojnë se nuk mundet që të pranohet një ankim kushtetues individual kundër një akti normativ nënligjor. Kjo sepse dispozitat e ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese e lidhin mundësinë e shqyrtimit të akteve normative nënligjore në kuadër të ankimeve individuale vetëm në rast se akti që kundërshtohet është bazuar në një akt normativ nënligjor. Pra vetë akti normativ nënligjor nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbas shterimit të mjeteve juridike, por vetëm indirekt.

Ky moment kompleksohet më tej edhe në rast se marrim edhe elementë të tjerë proceduralë si afati për t'u ankuar në Gjykatën Kushtetuese që është dy vjet për aktet normative nënligjore⁵⁵ dhe afati në rastin e ankimeve individuale që është katër muaj,⁵⁶ ndërsa LGJA për kundërshtimin e kateve normative nënligjore parashikon një afat tre vjeçar.⁵⁷ Në këtë këndvështrim duke qenë se ka dallime midis këtyre dy llojeve të ndryshme gjykimesh, atëherë shterimi i mjeteve në çdo rast nuk mund të konsiderohet si kusht për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të kundërshtuar aktet normative nënligjore.

53 Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, neni 71, pika 2.

54 Po aty, neni 71/b, pika 2.

55 LGJK, neni 50, pika 1: Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, sipas pikës 1 dhe pikës 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 49, të këtij ligji, mund të paraqiten brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.

56 LGJK, neni 71/a, pika 1, gërma “b”: Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur: ... b) kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit;

57 LGJA, neni 18, pika 3: *Padia kundër aktit nënligjor normativ duhet të paraqitet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit.*

4. Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave administrative në rastin e depozitimit të kërkesës/kërkesëpadisë në mënyrë të gabuar.

Një çështje e fundit që meriton të trajtohen në këtë rast është vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj administrative në rast se konstatohet se akti është kundërshtuar gabimisht pranë tyre, kur në fakt duhej që të shqyrtohej në juridiksionin tjetër. Duke qenë se në këtë rast, pavarësisht se ndodhemi përpara gjykatave, nga pikëpamja formale – juridike jemi përpara dy pushteteve të ndara që rregullohen respektivisht nga Pjesa VIII dhe Pjesa e IX e Kushtetutës. Për këtë arsye këto dy gjykata nuk mund të shpallin mungesën e kompetencës lëndore dhe t’ia dërgojnë aktet gjykatës tjetër. Duke u bazuar me analogji, në disa raste të ngjashme të jurisprudencës aktuale të Gjykatës së Lartë dhe asaj kushtetuese rezultoi se vendoset rrëzimi i kërkesës/kërkesëpadisë. Më konkretisht Gjykata e Lartë ka mbajtur këtë qëndrim:

*Në kuptim të kësaj dispozite gjykata, pasi konstaton moskompetencën e saj lëndore apo tokësore, është e detyruar të shprehet edhe për gjykatën së cilës i dërgon aktet për zhvillimin e gjykimit. **Kjo dispozitë përmban një rregullim procedural të zbatueshëm nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.** Rasti në shqyrtim nuk është i tillë dhe nuk ka të bëjë me kompetencën lëndore të ndonjë gjykate tjetër brenda sistemit të gjykatave të zakonshme. Po kështu, në zbatim korrekt të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **gjykata e shkallës së parë nuk mund t’i dërgojë çështjen për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, me arsyetimin se i mungon kompetenca lëndore për shqyrtimin e saj.***

12.3. Në vijim të argumentit ligjor të mësipërm, ky Kolegj, ndryshe nga përfundimi i gjykatës së shkallës së parë, në analizë dhe interpretim të dispozitave ligjore të zbatueshme për rastin konkret, vlerëson se gjykata ka gabuar kur ajo shprehet për moskompetencë lëndore të mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

...

16. Gjykata mund të shpallë moskompetencën lëndore, atëherë kur Kodi i Procedurës Civile apo ligji në mënyrë eksplicite ka përcaktuar gjykatën konkrete që ka kompetencën të marrë në shqyrtim çështjen,

gjykatë kjo që përfshihet brenda sistemit të gjykatave të zakonshme.

16.1. Për rastin në shqyrtim dhe në kushtet kur ligji për nga pikëpamja lëndore nuk ka përcaktuar ndonjë gjykatë tjetër si gjykatë kompetente, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, referuar neneve 6§1 dhe 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, vlerëson se paditësit të këtij gjykimi nga pikëpamja procedurale jo vetëm që nuk mund t'i mohohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, por nga ana tjetër as gjykata e shkallës së parë nuk mund të shpallë moskompetencën lëndore.

*17. Në një rast të tillë gjykata e shkallës së parë, për të arritur në një përfundim të drejtë duhet të analizojë juridikisht pretendimet e palës paditëse dhe, nëse konkludon se me padinë në shqyrtim kundërshtohet një akt administrativ ndaj të cilit, sipas nenit 326 Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të ngrihet padi, **duhet të rrëzojë padinë dhe jo të shpallë moskompetencën e saj.**⁵⁸*

Nga ana e saj Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qendrimin se:

Kolegji vlerëson se kërkuesi, para se t'i drejtohet kësaj Gjykate, duhet të shterrë të gjitha mjetet juridike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë për lirimimin nga detyra të organeve të krijuara me ligj është akt individual dhe si i tillë duhet kundërshtuar në rrugën e juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Vetëm pas përfundimit të gjykimit të zakonshëm, kërkuesi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate, nëse ka pretendimi lidhur me mosrespektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij, pasi nuk ka shterrur mjetet ligjore të parashikuara, si kusht paraprak për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.⁵⁹

Nga sa më sipër rezulton se edhe Gjykata Kushtetuese në rast se ndodhet përballë një situatë të tillë vendos moskalimin e çështjes në

58 Vendimi nr. 00-2010-1351 (436), datë 2.12.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

59 Vendimi nr.78, datë 18.7.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

seancë plenarë nëse kërkesa po shqyrtohet në Kolegjin/Mbledhjen e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe në rast se ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare atëherë vendoset rrëzimi i kërkesës.

Konkluzione

Aktiviteti gjithmonë e në rritje i veprimtarisë legjislativë të organeve ekzekutive, që shfaqet në formën e miratimit të akteve normative nënligjore, ka sjellë si pasojë që shpesh herë të drejtat dhe liritë themelore me natyrë kushtetuese dhe ato ligjore. Për këtë arsye nga ligjvënësi janë krijuar mekanizma të cilat mundësojnë aksesin në organe gjyqësore të individëve me qëllim kundërshtimin e këtyre akteve.

Për të ngritur nivelin e mbrojtjes, ligjvënësi ka proceduar me krijimin e gjykatave të specializuara të cilat sigurojnë një gjykim më të specializuar dhe profesional. Por krijimi i një shumëllojshmërie gjykatash krijon probleme përsa i përket ndërthurjeve të kompetencave. Në këtë drejtim shqyrtimi i akteve normative nënligjore ka krijuar një lloj paqartësie përsa i përket juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor administrativ.

Analiza e këtij artikulli ka pasur si qëllim që të japë një pasqyrë sa më të plotë dhe të krijojë një qartësi në lidhje me kompetencën lendore të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave administrative.

Në këtë këndvështrim rezulton se bazuar në bazën kushtetuese dhe ligjore aktuale, kemi një juridiksion të ndarë midis Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave administrative nëse pretendimet e ngritura kundrejt një akti normativ nënligjor janë me natyrë materiale dhe kemi juridiksion konkurrues nëse pretendimet e ngritura janë me natyrë procedurale.

Në këtë këndvështrim nëse kemi pretendime përsa i përket çënimit të drejtave kushtetuese, atëherë çështja duhet të gjykohet nga Gjykata Kushtetuese dhe nëse pretendimet janë me natyrë ligjore, atëherë çështja duhet të gjykohet nga gjykatat administrative. Një tjetër element dallues është edhe natyra e organit që ka nxjerrë aktin normativ nënligjor. Kështu nëse ky akt është nxjerrë nga organe kushtetuese, Gjykata Kushtetuese në varësi të pretendimeve ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes. Por nëse akti nënligjor është nxjerrë nga një organ që nuk parashikohet në Kushtetutë (pra, është krijuar me ligj), atëherë pavarësisht natyrës së pretendimeve çështja është pjesë e juridiksion gjyqësor administrativ.

Nga ana tjetër, nëse kemi pretendime për tejkalim kompetencash apo mos respektim të formës dhe procedurës për shkak të formulimit të nenit 118 të Kushtetutës, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e aktit, konkurojnë midis tyre. Më konkretisht pretendimi për cënim të kushteve të parashikuara nga neni 118 i Kushtetutës, passjell edhe antikushtetutshmëri dhe paligjshmëri të vetë aktit normativ nënligjor. Megjithatë duke pasur në konsideratë faktin që aksesit në gjykimin kushtetues është i kufizuar dhe i kushtëzuar për shumë subjekte ndërkohë gjykimi administrativ në këtë rast është më i hapur, atëherë dallimi përsa i përket ankimit kundrejt akteve normative nënligjore lidhet me lirinë e aksesit që gëzojnë subjektet pranë këtyre gjykatave.

Siç analizuam në këtë artikull, jemi të mendimit se nuk mund të pretendohet që ankimi në Gjykatën Kushtetuese të realizohet vetëm pasi të jenë shteruar mjetet e tjera juridike dhe konkretisht ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe më pas në Gjykatën e Lartë, nga subjektet që janë organizuar në forma të caktuar nga legjislacioni (shoqata, dhoma tregtie, sindikata, etj). Kjo sepse si Kushtetuta dhe baza ligjore e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese nuk parashikojnë si kusht shterimin e ndonjë mjeti tjetër juridik. Për më tepër që ankimi nëpërmjet shkallëve gjyqësore dhe më pas në Gjykatën Kushtetuese të con në rrugën e ankimit kushtetues individual, i cili për shkak të vecorive procedurale që paraqet është i ndryshëm nga kundërshtimi i akteve normative nënligjore që parashikohet në Kushtetutë.

Pavarësisht dallimeve që ka midis juridiksioneve, përsëri ekziston mundësia që subjekte të ndryshme të paraqesin kërkesën/kërkesëpadinë në juridiksionin e gabuar. Në këtë rast gjykatat duke qenë se i përkasin juridiksioneve të ndryshme nuk mundet që të shpallin moskompetencën dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Në këtë rast ato mund të vendosin, për Gjykatën Kushtetuese moskalim i çështjes në seancën plenare, ose rrëzimin e kërkesës ndërsa për gjykatat administrative rrëzimin e kërkesëpadisë.

Njohuritë mbi ndarjen e juridiksioneve kanë rëndësi, pasi gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementët e procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë individualizimi i saktë i gjykatës kompetente ndihmon në shmangien e gjykimeve të tepërta dhe prishjen e vendimeve

nga gjykatat më të larta duke sjellë si pasojë zvarritjen e çështjeve dhe gjykimin e tyre tej një afati të arsyeshëm.

Bibliografia

- Sadushi, Sokol, *“E Drejta Administrative 2, Teoria e aktit administrativ”*, Shtëpia Botuese “Ora”, Tiranë 2005.
- D’Orlando, Elena, *“La giustizia costituzionale in Austria”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Spechia, Marina Calamo, *“La giustizia costituzionale in Francia”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Belletti, Michele, *“Il sistema costituzionale portoghese”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Pistan, Carna, *“La giustizia costituzionale nell’Europa Centro-Orientale: Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Di Gregorio, Angela, *“La Corte Costituzionale della Russia”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Olldashi (Boçi), Enkelejda, *“Hyrje mbi teoritë e grupeve të interesit”*, Shtëpia Botuese “Globus R., Tiranë 2010, Tiranë 2010.
- Sadushi, Sokol, *“Drejtësia kushtetuese në zhvillim”*, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012.
- Sadushi, Sokol, *“Pushteti legjislativ i administratës”*, botuar në Revistën “Avokatia”, Nr.6, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shtypshkronja “Dea Print”, Tiranë, Prill 2013, fq.53-76.
- Dobjani, Ermir; Toska, Elsa; Puto, Erlir; Dobjani, Erajd; *“E drejta administrative – Kontrolli mbi Administratën Publike”*, Shtëpia

Botuese “EMAL”, Tiranë 2013.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 dhe ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, me ligjin nr. 9904, date 21.4.2008, me ligjin nr.88/2012, me ligjin nr.137/2015 dhe me ligjin nr.76/2016)
- Ligj nr.8116, datë, 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar.
- Ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligj nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar.
- Ligji nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
- Ligj nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.
- Vendimi nr.212, datë 29.10.2002 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.17, datë 25.7.2008 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.7, datë 27.2.2013 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.14, datë 21.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.23, datë 20.4.2016 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.60, datë 16.9.2016 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.78, datë 18.7.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.30, datë 2.3.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi Unifikues nr.8, datë 12.9.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.00-2010-1158 (360), datë 30.9.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr.00-2010-1351 (436), datë 2.12.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

LEGJISLACIONI SHQIPTAR MBI TRANSFERIMIN E ÇMIMEVE

Dr. Armela KROMIÇI

1. Çfarë është transferimi i çmimeve?

Ndërkombëtarizimi i tregjeve ka nxitur politikat e transferimit të çmimit të të mirave dhe të shërbimeve të shoqërive tregtare pjesë e të njëjtit grup, por që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në vende të ndryshme. Transfer pricing është metodologjia e manipulimit të çmimeve, që praktikohet nga këto shoqëri dhe bëhet me qëllim lëvizjen e të ardhurave të tatueshme nga një shoqëri në tjetrën, për evitimin e tatimit mbi fitimin. Transferimi i çmimeve të të mirave dhe shërbimeve përcaktohet nga shoqëria mëmë, qëllimi i së cilës është ai i rritjes së përfitimit edhe në dëm të shoqërive të tjera të grupit. Në këtë mënyrë, mëma transferon të ardhurat e saj nga vendet me regjim tatimor më të lartë drejt vendeve me regjim tatimor më të ulët. Ndër praktikatat e ndjekura nga shoqëritë tregtare me qëllim evitimin e tatimit apo uljen e barrës fiskale mund të përmendim, vënien në jetë të strategjive të delokalizimit të shoqërisë në vende të treta, shpërndarja e aktivëve në shoqëri të kontrolluara apo teknika e transferimit të çmimit.

Transferimi i çmimeve përcaktohet nga tarifat e shkëmbimit të mallrave apo shërbimeve ndërmjet shoqërive juridikisht të pavarura por që kontrollohen nga e njëjta shoqëri. Shtetet kanë përcaktuar në legjislacionet e tyre rregulla specifike që i referohen ripërcaktimit të vlerës së transaksioneve që kryhen ndërmjet shoqërive pjesë të të njëjtit grup. Ende sot mungon një rregullim tatimor ndërkombëtar i uniformuar pasi shtetet nuk cedojnë nga sovraniteti i tyre në përcaktimin e rregullave tatimore. Veprimtaria e shoqërive tregtare mbikëqyret si nga sistemet ligjore të shteteve të ndryshme ku e ushtrojnë aktivitetin e tyre shoqëritë tregtare ashtu edhe nga rregullat e përmbajtura në të drejtën ndërkombëtare private, ku një rol të rëndësishëm e luajnë marrëveshjet

dypalëshe apo shumëpalëshe për evitimin e tatimit të dyfishtë. Mungesa e një legjislacioni të harmonizuar ndërkombëtar mbi vlerësimin dhe ndëshkimin e teknikës së transferimit të çmimeve lë shteg për shoqëritë për të shmangur zbatimin e detyrimeve të tyre tatimore. Përcaktimi i metodologjisë së verifikimit të transferimit të çmimeve dhe gjetjes së ndëshkimit më të drejtë përbën shqetësim për administratat tatimore të vendeve të ndryshme. Kjo situatë, ka tërhequr edhe vëmendjen e institucioneve ndërkombëtare për redaktimin e disa rregullave bazë të zbatueshme për të gjitha vendet. Të shumta janë iniciativat e ndërmarra nga institucionet ndërkombëtare, si OECD, ICC, etj, me qëllim krijimin e një corpusi rregullash e parimesh të përbashkëta për harmonizimin e metodologjisë së vlerësimit të transaksioneve të kryera *intercompany* dhe regjimit tatimor të zbatueshëm.

2. Parimet dhe rekomandimet e OECD-së për transfer pricing

Rekomandimet e OECD-së kanë në fokusin e tyre krijimin e një korpusi rregullash të njëjta për të gjitha shtetet për vlerësimin e transaksioneve të kryera ndërmjet shoqërive pjesë të të njëjtit grup por që operojnë nën sistemin tatimor të vendeve të ndryshme. Për këtë qëllim, OECD-ja sygjeroi kalimin nga teoria e ashtuquajtur *unitary theory* në *separate accounting theory*¹. Sipas kësaj teorie secila njësi ekonomike duhet konsideruar si e pavarur, veçanërisht për sa i përket përcaktimit të pasurisë së saj dhe vlerësimit të operacioneve të shoqërive të të njëjtit grup. Ky model dhe rekomandimet që do e ndjekin janë të rëndësishme, pasi për herë të parë futet koncepti i vlerës së drejtë apo më saktë koncepti i ‘normalitetit të transaksioneve’ të kryera nga shoqëritë pjesë e të njëjtit grup.

Në 1995 OECD-ja miratoi raportin *Transfer Pricing Guidelines for Multinational Enterprises and Tax Administration*² që kishte për qëllim

1 Për më shumë mbi këto teori shih **C. Sommer**, *Separate Accounting or Unitary Apportionment?* Dissertation, Freie Universitat Berlin, 2010, Josef Eul Verlag, 2011.

2 <http://www.oecd.org/ctp/transfer-pricing/>

përcaktimin e çmimit të drejtë që duhet t'i zbatohet transaksioneve brenda grupit duke u bazuar në parimin e konkurrencës së lirë, *the arm's length principles*. Parimi i konkurrencës së lirë, do të jetë kriteri mbi të cilën do të vlerësohen çmimet e transaksioneve të kryera brenda për brenda grupit, për të verifikuar nëse shoqëritë kanë zbatuar transfer pricing. Sipas këtij parimi, çmimi i të mirave dhe i shërbimeve të shitura brenda grupit duhet të jetë i përafërt me çmimin e të mirave dhe të shërbimeve të ngjashme të shitura nga shoqëritë e treta të pavarura. Parimi i konkurrencës së lirë prezupozon që krahasimi i kushteve të zbatuara për një transaksion intercompany dhe i kushteve të zbatuara për një transaksion të ngjashëm ndërmjet palëve të treta të pavarura të jetë i përafërt. Nga ana tjetër, me qëllim përcaktimin e çmimit të drejtë konform parimit të konkurrencës së lirë është e nevojshme që transaksionet brenda grupit dhe ato me palët e treta të jenë të ngjashme dhe të krahasueshme.

Parimi i konkurrencës së lirë është i rregulluar në nenin 9 të Model Tax Convention të OECD-së. Sipas paragrafit të parë të këtij neni: *nëse shoqëria tregtare e një shteti merr pjesë direkt apo indirekt në drejtimin, kontrollin e shoqërisë të një shteti tjetër, apo kur të njëjtët persona marrin pjesë drejtpërsëdrejti apo në mënyrë indirekte në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e shoqërisë të një shteti tjetër, dhe dy sipërmarrjet në marrëdhëniet e tyre tregtare dhe financiare janë të lidhura nga kushte të pranuar apo të imponura të ndryshme nga ato që mund të lidhen ndërmjet shoqërive të pavarura, fitimet që në mungesë të këtyre kushteve do të realizoheshin nga njëra shoqëri, por për shkak të ekzistencës së këtyre kushteve nuk realizohen, mund të parashikohen në fitimet e kësaj shoqërie dhe për pasojë të tatonen. Ky nen parashikon të drejtën e administratës tatimore që të rivlerësojë duke e korrigjuar çmimin e transaksionit të kryer ndërmjet shoqërive pjesë të të njëjtit grup dhe më pas ta tatojë. Nëse transaksionet brenda grupit janë kryer në kushtet e konkurrencës së lirë, administrata tatimore nuk mund të korrigjojë çmimin e transaksionit. Përkatësisht në paragrafin e dytë të këtij neni përcaktohet se: *nëse një shtet parashikon në fitimet e tatueshme të një shoqërie fitimet e një shoqërie për të cilat kjo e fundit tatonen në një shtet tjetër dhe fitimet e tatuara në të vërtetë duhet të tatonen nga shteti i parë nëse kushtet e transaksionit do të ishin të njëjta me kushtet e përcaktuara nga palë të pavarura, atëherë ky shtet do të korrigjojë vlerën e tatimit mbi fitimin përkatës. Korrigjimi i vlerësimit të**

fitimit dhe tatimi i kësaj vlere mund të çojë në tatim të dyfishtë. Kështu nëse fitimi i shoqërisë X e shtetit A është korrigjuar në rritje dhe më pas tatohet, ky fitim është tatuar para korrigjimit edhe në shtetin B për fitimin e deklaruar nga shoqëria X. Për këtë arsye, me qëllim evitimin e tatimin të dyfishtë sipas paragrafit të dytë të nenit 9, shteti B duhet të rivlerësojë tatimin mbi fitimin, pasi ky fitim është tatuar në rritje nga shteti A. Vlen të theksohet se kjo dispozitë në paragrafin e katërt të saj nuk e detyron administratën e shtetit B që të korrigjojë tatimin e fitimit të shoqërisë X, mbi të cilën është verifikuar transfer pricing nga shteti A. Korrigjimi do të ndodhë vetëm nëse shteti B do të vlerësojë se korrigjimi i vlerës së fitimit të shoqërisë nga shteti A është bërë konform parimit të *arm's length*. E thënë ndryshe, shteti B nëse korrigjimin e shtetit A nuk e konsideron të drejtë në bazë të parimit të konkurrencës së lirë nuk detyrohet që të ulë tatimin e tij mbi fitimin e shoqërisë. Paragrafi i dytë i neni 9 nuk parashikon asgjë përsa i përket mënyrës sesi duhet të vlerësohet dhe të korrigjohet vlera e fitimit të deklaruar dhe më pas mënyra sesi do të tatohet ky fitim, duke i lënë në këtë mënyrë shteteve mundësinë për të rregulluar këtë aspekt në marrëveshje dy apo shumë palëshe.

2.1 Metodologjia e përcaktimit të transferimit të çmimeve sipas OECD-së

Sikurse e përmendet më lart, nëse verifikohen raste të transfer pricing, ndëshkimi që administrata tatimore do të ndërmerret është ai i ripërcaktimit të vlerës së transaksionit në bazë të vlerës normale të tregut për atë transaksion dhe më pas do të vazhdojë me tatimin e kësaj vlere. Por, korrigjimi i politikave të çmimeve të transferimit nënkupton nevojën për një analizë të plotë të funksionimit të të gjitha shoqërive pjesë të grupit që janë subjekte tatimore të vendeve të ndryshme. Kjo situatë e vërshtirëson në praktikë rivlerësimin e transaksionit të kryer ndërmjet shoqërive që i nënshtrohen legjislacioneve të ndryshme. Për këtë arsye, në pjesën e dytë të *Transfer Pricing Guidelines for Multinational Enterprises and Tax Administration*³, OECD-ja ka parashikuar disa mënyrë për vlerësimin dhe

3 http://www.keepeek.com/Digital-Asset-Management/oecd/taxation/oecd-transfer-pricing-guidelines-for-multinational-enterprises-and-tax-administrations-2010_tpg-2010-en#page278

përcaktimin e çmimit të drejtë për transaksionet brenda grupit, konform parimit të konkurrencës së lirë.

2.0.1 Medota e krahasimit të çmimit sipas parimit të konkurrencës së lirë (comparable uncontrolled price)⁴

Sipas kësaj metode, çmimi i transaksioneve të lidhura brenda grupit do të krahasohet me çmimin e transaksioneve të ngjashme të lidhura ndërmjet shoqërive të pavarura me të njëjtat kushte të tregut. Medota e krahasimit të çmimit mund të jetë e brendshme dhe në këtë rast do të krahasohet çmimi i transaksionit i lidhur nga shoqëria me një shoqëri tjetër të kontrolluar prej saj dhe çmimi i transaksionit për të njëjtin të mirë apo produkt të ngjashëm të lidhur nga shoqëria me një tjetër shoqëri të grupit. Ndërsa, kur çmimi i transaksionit të kryer ndërmjet shoqërive pjesë e një grupi do të krahasohet me çmimin e transaksionit të lidhur ndërmjet dy shoqërive të treta të pavarura, me të njëjtat kushte të tregut, metoda e krahasimit të çmimit është e jashtme. Në të dyja rastet duhet të merren në konsideratë disa faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në përcaktimin e transferimit të çmimit. Ndër këto faktorë me rëndësi të veçantë mund të përmendim:

- *tregun përkatës* ku janë kryer transaksionet. Është e rëndësishme që të merret në konsideratë tregu ku shiten produkte të njëjta. Tregu duhet të jetë i ngjashëm përse i përket përcaktimit të çmimit, kursit të këmbimit, kostove të shpërndarjes dhe faktorëve të tjerë krahasues të tregut;

- *cilësia e produktit* që merr në konsideratë jo vetëm aspektin e paraqitjes së jashtme të tij por edhe cilësinë e cila mund të ndikojë në shitjen e produktit;

- *kritere të tjera* që lidhen me transportin, amballazhimin, marketingun për shitjen e produktit, kushtet e shitjes, uljet që mund të jenë zbatuar, kursi i këmbimit, etj⁵;

4 Transfer pricing methods në <http://www.oecd.org/ctp/transfer-pricing/45765701.pdf>

5 Për problematikën e zbatimit të kësaj metode shih, L. Eden, The arm's length standard: making it work in a 21 st century world of multinationals and nation states, February 2015, f.14 në http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2568266

2.1.2 Metoda e çmimit të rishitjes (resale price)⁶

Sipas kësaj metodologjie, do të vlerësohet çmimi i blerjes së të mirave dhe shërbimeve nga shoqëria e kontrolluar dhe më pas rishitja e këtyre të mirave dhe shërbimeve tek palët e treta të pavarura. Në këtë rast, shoqëria e kontrolluar në cilësinë e blerësit të të mirave dhe shërbimeve nga mëma dhe në cilësinë e rishitësit tek të tretët nuk duhet të ndërhyjë për të ndryshuar cilësitë e produktit. Kjo metodë do të gjej zbatim vetëm nëse blerja e të mirave dhe shërbimeve nga mëma dhe rishitja e tyre tek të tretët do të bëhet në një interval të shkurtër kohor, pasi në këtë mënyrë do të evitohen ndryshimet e tregut, kostot e magazinimit, etj. Gjithashtu, kjo metodë do të gjejë zbatim nëse është e mundur krahasimi i të dhënave kontabël të deklaruara nga shoqëritë.

Për të përcaktuar nëse ekziston transfer pricing, administrata tatimore, çmimit të rishitjes do t'i zbresë një marzh bruto që njihet ndryshe si *resale price margin*. Ky marzh i referohet shumës me të cilën shitësi i produktit në tregun e lirë do të mbulojë shpenzimet e veta të shitjes, të kostove të transportit, marketingun apo ndryshimin e ambalazhit, etj. Përcaktimi i diferencës që do t'i zbritet çmimit të rishitjes përbën një aspekt të veçantë që kërkon vlerësimin e krahasueshëm të rishitjeve të tjera të bëra me të tretët apo ndërmjet palëve të treta për të mira dhe produkte të ngjashme.

2.1.3 Metoda e kostove plus (cost plus)

Metoda e kostove plus për vlerësimin e transferimit të çmimit merr në konsideratë çmimin e rishitjes së të mirave dhe të shërbimeve duke u nisur nga kostot e prodhimit, të cilave u shtohet një marzh i fitimit bruto, *mark-up*. Për zbatimin e kësaj metode është e rëndësishme vlerësimi i kujdesshëm i kontabilizimit të kostove. Marzhi i fitimit bruto do të përcaktohet me anë të krahasimit të marzhit të fitimit të transaksionit në verifikim me marzhin e fitimit bruto të realizuar nga e njëjta shoqëri në transaksione të ngjashme me palë të treta të pavarura. Në mungesë të transaksioneve të ngjashme me palë të treta të pavarura, do të krahasohet marzhi i fitimit bruto të transaksionit në shqyrtim me transaksionet e

6 Transfer pricing methods në <http://www.oecd.org/ctp/transfer-pricing/45765701.pdf>

ngjashme të kryera ndërmjet palëve të treta të pavarura. Zakonisht, kjo teknikë vlerësimi gjen zbatim në rastet kur veprimtaria e shoqërisë përqendrohet kryesisht në furnizimin e shërbimeve për shoqëritë e tjera të grupit. Një rëndësi të veçantë kanë kriteret e përzgjedhura në përllogaritjen e kostove bazë, mbi të cilën do t'i shtohet marzhi i fitimit bruto. Gjithashtu, është e rëndësishme që marzhi i fitimit bruto **të jetë i tillë që të garantojë përfitimin efektiv të shoqërisë dhe të mbulimit të rreziqeve të marra përsipër nga kjo e fundit sipas kushteve të tregut.**

2.1.4 Metoda e shpërndarjes së fitimit (transactional profit split)⁷

Metodologjia e bazuar në mënyrën sesi shpërndahen fitimet ndërmjet shoqërive pjesë të grupit merr në shqyrtim të gjitha përfitimet e realizuara nga transaksioni dhe mënyrën sesi më pas ky fitim ndahet ndërmjet shoqërive të kontrolluara dhe mëmës. Shpërndarja e fitimit ndërmjet shoqërive pjesë e grupit që kanë marrë pjesë në transaksion duhet të bëhet duke patur **në konsideratë funksionin e kryer nga secila shoqëri që ka marrë pjesë në të**, rreziqet e marra përsipër dhe aktivitetin e ushtruar nga secila shoqëri. OECD-ja parashikon dy metodologji për të vlerësuar shpërndarjen e fitimit. Metodologjia e parë është ajo e analizës së kontributit të dhënë, ndërsa, metodologjia e dytë **merr në analizë diferencën** e mbetur. Kjo metodologji ka avantazhin që të përdoret edhe në mungesë të transaksioneve të ngjashme të lidhura ndërmjet mëmës dhe shoqërive të treta të pavarura.

2.1.5 Metoda e bazuar në marzhin neto të transaksionit (transactional net margin method)⁸

Kjo metodë bazohet në vlerën neto të të ardhurave të realizuara nga shoqëria gjatë transaksioneve ndërmjet shoqërive pjesë e të njëjtit grup. Vlera neto e të ardhurave të realizuara nga shoqëria në transaksionet e kontrolluara do të krahasohet me transaksionet e ngjashme të pavarura të shoqërisë të realizuara sipas vlerës së tregut. Nëse një krahasim i tillë nuk është i mundur, do të vlerësohet marzhi neto i fitimit i shoqërive të

7 Idem

8 Idem

treta të pavarura që realizojnë transaksione të ngjashme. Kjo metodë për vlerësimin e transfer pricing merr në konsideratë disa faktorë që mund të influencojnë në përlllogaritjen e vlerës neto të transaksionit, ku mund të përmendim: pozitën konkurruese dhe tryshinë e ushtruar nga konkurruesit e tjerë të rinj, diferencat e kostove të kapitalit, eksperiencën e shoqërisë, eficientë e administrimit dhe strategjitë e përndjekura nga shoqëria.

3. Legjislacioni shqiptar mbi transferimin e çmimeve

Ligjvënësi shqiptar me ligjin nr 42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8348, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” rregulloi në legjislacionin shqiptar teknikën e transferimit të çmimeve.

Ligji, në pikën 1 të tij, ndalet tek trajtimi i konceptit të palëve të lidhura, që ekziston kur: *i) një person merr pjesë direkt apo indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e personit tjetër; ose ii) i njëjti/të njëjtët person/persona marrin pjesë direkt apo indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e të dy personave.* Më tej dispozita sqaron se: *një person merr pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një personi tjetër, kur: i) ai person zotëron, direkt ose indirekt, 50 për qind ose më shumë të kapitalit aksionar të personit tjetër; ose ii) efektivisht kontrollon vendimet e biznesit të këtij personi tjetër.* Në mungesë të kësaj marrëdhënie, palët do të konsiderohen të pavarura. Kjo dispozitë duhet lexuar së bashku me nenin 207 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, i cili sqaron rastet kur shoqëritë pjesë e një grupi ndodhen në marrëdhënie varësie apo kontrolli dhe rastet kur marrëdhënia ndërmjet shoqërive pjesë e grupit është influencuese, por jo kontrolluese. Sipas pikës 1 të nenit 207, marrëdhënia mëmë-shoqëri e kontrolluar ekziston kur një shoqëri tregtare sillet dhe vepron rregullisht, sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër. Ky kontroll quhet grup kontrollues. Ndërsa, kur një shoqëri, zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë tjetër ose ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë tjetër, ndonëse kemi një marrëdhënie varësie, ndodhemi përpara një grupi influencues dhe jo një

grupi kontrollues. Në këtë mënyrë, me anë të interpretimit sistematik të nenit 207, pika 1 dhe 2 dhe nenit 1 të ligjit nr. 42/2014, transfer pricing mund të ekzistojë vetëm ndërmjet shoqërive pjesë e grupit ndërmjet të cilave ekziston një marrëdhënie e kontrolluar dhe jo në kushtet e një marrëdhënie të influencuar.

Në pikën ç) të nenit 1 të këtij ligji përcaktohet kushti që transaksioni i kontrolluar për verifikimin e ekzistencës së *transfer pricing* duhet të kryhet ndërmjet dy palëve ku njëra palë është rezidente, dhe pala tjetër është jorezidente në Shqipëri, pra palët i nënshtrohen dy legjislacioneve të ndryshme tatimore. Sipas pikës dh) të nenit 1: *termi “transaksion” përfshin një ujudi, mirëkuptim, marrëveshje apo praktikë direkte ose indirekte mes palëve, e detyrueshme ose jo ligjërisht apo me synimin që të jetë ligjërisht e detyrueshme, dhe përfshin çdo marrëdhënie biznesi ndërmjet personave të lidhur.*

Nga leximi i nenit 1 i ligjit nr. 42/2014, vërejmë se për të verifikuar ekzistencën e transferimit të çmimit sipas legjislacionit shqiptar, duhet të përmbushen dy kushte kumulative. Në radhë të parë, shoqëritë duhet të jenë të lidhura në një marrëdhënie varësie, pra njëra shoqëri, mëma duhet të kontrollojë direkt ose indirekt me 50% ose më shumë kapitalin e shoqërisë tjetër, shoqërisë së kontrolluar. Së dyti, shoqëria mëmë dhe shoqëria e kontrolluar duhet t'i nënshtrohen legjislacionit tatimor të dy vendeve të ndryshme. Vetëm nëse ekzistojnë këto dy kushte, do të vlerësohet nëse është zbatuar praktika e transferimit të çmimeve sipas rregullave të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr.42/2014. Kjo dispozitë sqaron se: *nëse një tatimpagues që është subjekt i tatimfitimit merr pjesë në një apo më shumë transaksione të kontrolluara, ai duhet të përcaktojë fitimin e tatueshëm në një mënyrë që është në përputhje me parimin e tregut.* Në këtë mënyrë, legjislacioni shqiptar do të bazohet në parimin e konkurrencës së lirë për përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një tatimpaguesi që merr pjesë në një apo më shumë transaksione duke i krahasuar transaksionet e lidhura ndërmjet palëve në marrëdhënie varësie me transaksionet e lidhura ndërmjet palëve të pavarura. Nëse kushtet e zbatuara në transaksionet e lidhura nuk janë konform parimit të konkurrencës së lirë, atëherë, fitimet e tatueshme të tatimpaguesit mund të rriten në atë masë që të jenë në përputhje me parimin e tregut.

Për të përcaktuar nëse një transaksion i kontrolluar i kryer ndërmjet shoqërive pjesë e një grupi është në përputhje me parimin e tregut, vlerësimi i tij dhe më pas zbatimi i sanksionit përkatës do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në nenit 3 të ligjit nr. 42/2014. Kjo dispozitë rregullon: 1. *metodën e krahasimit të çmimeve ndërmjet transaksioneve të kontrolluara dhe atyre të pavarura*, e cila konsiston në krahasimin e çmimit të vendosur për mallra apo shërbime të transferuara në një transaksion të kontrolluar me çmimin e vendosur për mallra apo shërbime të transferuara në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm; 2. *metoda e çmimit të rishitjes*, e cila konsiston në krahasimin e marzhit të rishitjes, që një blerës mallrash në një transaksion të kontrolluar fiton nga rishitja e asaj prone në një transaksion të pakontrolluar, me marzhin e rishitjes që fitohet në transaksione shitblerjesh të pakontrolluara të krahasueshme; 3. *metoda kosto plus*, e cila konsiston në krahasimin e rritjes (marzhit të fitimit) mbi kostot direkte dhe indirekte në furnizimin e mallrave e shërbimeve në një transaksion të kontrolluar me rritjen e marzhit të fitimit të këtyre kostove direkte dhe indirekte në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm; 4. *metoda e marzhit neto të transaksionit*, e cila konsiston në krahasimin e marzhit neto të fitimit ndaj një baze të përshtatshme, p.sh., kostot, shitjet, asetet, që një palë arrin në një transaksion të kontrolluar, me marzhin neto të fitimit ndaj së njëjtës bazë të arritur në transaksione të pakontrolluara të krahasueshme; 5. *metoda e ndarjes së fitimit të transaksionit*, sipas së cilës çdo personi, të lidhur që merr pjesë në një transaksion të kontrolluar, i alokohet pjesa e fitimit të përbashkët/humbjes që rrjedh nga ky transaksion, që një person i pavarur do të fitonte nga pjesëmarrja në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm.

Nga leximi i kësaj dispozite, vërejmë se ligjvënësi shqiptar është bazuar në parimet e përgjithshme të OECD-së për përcaktimin e ekzistencës së transfer pricing. Sipas nenit 3 të ligjit nr. 42/2014, shoqëria mund të zbatojë një metodë të transferimit të çmimit të ndryshëm nga metodat e mësipërme, kur ajo provon se asnjë nga metodat e miratuara nuk mund të përdoret në mënyrë të arsyeshme për të përcaktuar përputhshmërinë me parimin e tregut për transaksionet e kontrolluara dhe metoda e zgjedhur prej saj jep një rezultat në përputhje me parimin e tregut. Por në këtë rast,

tatimpaguesi do të ketë barrën e provës për të provuar se transaksioni i kryer është konform parimit të konkurrencës së lirë.

Ligjvënësi shqiptar në nenin 3 të këtij ligji ka parashikuar mundësinë e nënshkrimit të një marrëveshjeje ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore me qëllim përcaktimin e kriterëve në përputhshmëri me parimin e tregut, mbi të cilat do të vlerësohen transaksionet e ardhshme të kontrolluara të lidhura nga tatimpaguesi për një periudhë kohore të përcaktuar, duke përcaktuar në këtë mënyrë çmimin në avancë të këtyre transaksioneve.

Ndërkohë, ligji nr. 43/2014 përcakton dënimet që i zbatohen tatimpaguesit që ka aplikuar transferimin e çmimit. Kështu, në rast të mosparaqitjes në kohë të *“Njoftimit të transaksioneve vjetore të kontrolluara”*, në përputhje me dispozitat përkatëse të udhëzimit të Ministrisë të Financave, *“Për transferimin e çmimit”*, tatimpaguesi dënohet me një gjobë fikse prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, për çdo muaj vonesë. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për secilin muaj apo pjesë të muajit, gjatë të cilit pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, shuma nuk mund të jetë më e madhe se 25 për qind e detyrimit të papaguar. Në rast rregullimesh të detyrimeve tatimore, për efekt të transferimit të çmimit, në bazë të dispozitave të nenit 36 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, të ndryshuar, nga ligji nr. 42/2014, tatimpaguesi është i detyruar të paguajë vetëm detyrimin shtesë dhe interesat, por jo gjobën.

3.1 Marrëveshjet e çmimit në avancë

Ligjvënësi shqiptar në nenin 36/7 dhe në udhëzimin nr. 9, datë 27.02.2015 *“Mbi marrëveshjet e çmimit në avancë”* u jep mundësinë shoqërive tregtare pjesë e një grupi që të lidhin një marrëveshje me administratën tatimore me qëllim përcaktimin paraprak të çmimit të transaksioneve që mund të lidhin shoqëritë pjesë e të njëjtit grup për një periudhë të caktuar kohe⁹, në bazë të një grupi të përshtatshëm kriteresh.

9 Sipas nenit 7 të udhëzimit nr. 9/2015, data e fillimit të marrëveshjes në avancë

Këto kritere do të përcaktohen në bazë të parimit të tregut të lirë. Nëse administrata tatimore dhe tatimpaguesi do të lidhin një marrëveshje për përcaktimin e çmimit në avancë nuk do të gjejnë zbatim pika 3 e nenit 36 për ato transaksione që janë pjesë e marrëveshjes për atë kohë sa kushtet dhe afatat e përcaktuara në marrëveshje janë plotësuar.

4. Dokumentacioni që duhet të hartohet për transferimin e çmimeve brenda grupit

Një ndër aspektet kryesore që rregullohen nga parimet e OECD-së, ka të bëjë me dokumentacionin që duhet të paraqitet me qëllim justifikimin e transferimit të çmimeve të shoqërive brenda grupit që operojnë nën legjislacionin tatimor të vendeve të ndryshme. OECD-ja vë theksin tek nevoja e hartimit të dokumentave të standardizuara që dokumentojnë transaksionet brenda grupit. Dokumenti i standardizuar mundëson vlerësimin e transaksioneve dhe pajtueshmërinë e tyre me vlerën normale të çmimeve të tregut. Me paraqitjen e këtij dokumentacioni shoqëritë përfitojnë nga regjimi i përjashtimit të tatimit dhe të sanksioneve për mosdeklarimin korrekt të detyrimeve tatimore. Duke qenë se barra e provës për të përfituar nga regjimi i përjashtimit të tatimit është e shoqërive, këto të fundit, duhet paraprakisht për operacionet financiare brenda grupit, të mbajnë një dokumentacion të redaktuar korrektësisht dhe ta paraqesin sa herë që i kërkohet. Në këtë aspekt edhe Bashkimi Europian është në një linjë me parimet e OECD-së dhe kërkon për shoqëritë të justifikojnë me dokumenta rastet e transaksione cross-border të kryera brenda grupit. Si OECD-ja edhe ligjvënësi europian vënë theksin tek nevoja e dhënies administratës tatimore, së të gjithë informacionit të nevojshëm nga ana e shoqërive tregtare, në mënyrë të tillë që administrata tatimore të mund të verifikojë në mënyrë eficiente vlerën e transaksioneve brenda grupit.

Komisioni Europian më 19 korrik të 2002 krijoi një forum me

duhet të jetë viti fiskal që vijon me datën e nënshkrimit të marrëveshjes. Data e fillimit të marrëveshjes duhet të jetë viti fiskal që vijon datën e nënshkrimit të marrëveshjes. Marrëveshja lidhet për një afat maksimal 5 vjeçar me përjashtim të rastit të rasteve kur marrëveshja e çmimit në avancë i përket zbatimit të një marrëveshje reciproke qeveritare të ratifikuar me ligj.

ekspertë të fushës me qëllim dhënien e zgjidhjeve të pranueshme nga shtetet anëtare përsa i përket metodologjisë që duhet të zbatojnë shtetet përsa i përket dokumentacionit që duhet të përgatitet tatimpaguesit¹⁰. Rekomandimet e këtij forumi kishin si qëllim zbatimin uniform nga ana e shteteve anëtare të direktivave të përcaktuara nga OECD-ja. Qëllimet e Forumit mbi Transfer Pricing mund të përmbliidhen në tre drejtime kryesore:

i. Hartimi i një kodi sjelljeje i pranueshëm për të gjitha shtetet anëtare që ka në fokusin e tij dokumentin që duhet të hartohet nga shoqëritë pjesë e një grupi që lidhin ndërmjet tyre transaksione cross-border;

ii. Krijimin e rregullave që kanë në fokusin e tyre zgjidhjen me arbitrazh të konflikteve të mundshme që lindin nga nevoja për evitim të tatimit të dyfishtë dhe përshtatjen e legjislacioneve të shteteve anëtare me direktivat e BE-së në këtë drejtim;

iii. Përcaktimin e kriterëve dhe rregullave të përshtatshme për favorizimin e marrëveshjeve paraprake për formimin e çmimeve (*advance pricing agreements*) ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe grupeve cross-border **të shoqërive tregtare që operojnë në to.**

Në 27 qershor 2006, Bashkimi European ka miratuar *Rezolutën 2006/ C 176/ 01*¹¹ që përmban kodin e sjelljes që duhet të respektojnë shoqëritë tregtare përsa i përket hartimit të dokumentacionit të nevojshëm për justifikimin e transferimit të çmimeve brenda grupit¹². Dokumentat që duhet të hartohen nga shoqëritë pjesë e grupit janë dy. *Masterfile*, i cili përmban të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të përbashkët për të gjitha shoqëritë pjesë e grupit dhe të gjitha transaksionet e lidhura cross-border ndërmjet tyre. Ndërsa dokumenti i dytë *countryfile* përmban të gjithë informacionin referuar shoqërisë së një vendi të caktuar dhe

10 <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2001:0582:FIN:EN:PDF>

11 [http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3AA42006X0728\(01\)](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3AA42006X0728(01))

12 A. Dragonetti, V. Piacentini, A. Sfrondini, *Manuale di fiscalità internazionale*, Ipsoa ed., III ed., 2008, f. 1132.

transaksionet cross-border të kryera vetëm prej saj. Nëse shoqëria do të ketë detyrimin për të paraqitur të dyja dokumentat apo vetëm njërin prej tyre, kjo do të përcaktohet nga roli dhe pozita që ka shoqëria brenda grupit.

Masterfile i cili përqendrohet **në dhënien e informacionit** mbi grupin në tërësi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të biznesit dhe të strategjisë së grupit përfshirë dhe ndryshimet e ndodhura në vitin e mëparshëm;

b) një përshkrim të detajuar të grupit përsa i përket organizimit të tij qoftë nga pikëpamja operative ashtu dhe nga pikëpamja juridike;

c) identifikimi i strategjisë së përndjekur nga grupi dhe ndryshimet e mundshme të saj krahasuar me vitet e mëparshme;

d) listën e të gjitha operacioneve të kryera intercompany si dhe përshkrimin e tyre të paraqitur në mënyrë të përmbledhur;

e) transaksionet e lidhura brenda grupit të cilat kategorizohen në tre nënkategori:

i. dhënien e të mirave materiale dhe jo materiale, ofrimin e shërbimeve, përfshirë dhe shërbimet financiare, mbi të cilat duhet dhënë informacion i detajuar mbi natyrën dhe vlerën e tyre, duke përcaktuar njëkohësisht cilat shoqëri pjesë e grupit i kanë ofruar;

ii. shërbime funksionale të ofruara nga shoqëritë në interesin e aktivitetit inter-company, siç mund të jetë shërbimi i marketingut apo administrimi i kontabilitetit **të grupit**, etj;

iii. marrëveshjet e ndryshme të hartuara ndërmjet shoqërive pjesë të grupit për ndarjen e shpenzimeve brenda shoqërive pjesë të grupit duke përcaktuar kostot, objektin dhe kohëzgjatjen e këtyre marrëveshjeve dhe subjektet e përfshira;

f) listën e funksioneve dhe të rreziqeve të shoqërive pjesë e grupit;

g) pronësinë e intangibles dhe të royalties **të paguara**;

h) politikat e përcaktimit të transferimit të çmimeve dhe justifikimin e tyre sipas parimit të *arm's length principles*;

i) marrëdhëniet e krijuara me administratën tatimore, duke

sqaruar nëse ekzistojnë marrëveshje të nënshkruara ndërmjet tyre, si dhe premtimin për të dhënë çdo informacion të kërkuar;

Ndërsa *countryfile*, ka përmbajtje të ngjashme me informacionin e paraqitur në *masterfile* por hartohet vetëm për një shoqëri dhe rolin e saj në grup. Ky dokument duhet të përmbajë:

a) një përshkrim të detajuar të shoqërisë dhe të strategjisë së saj, përfshirë dhe ndryshimet e strategjisë krahasuar me vitet e mëparshme;

b) sektorin në të cilin e ushtron aktivitetin shoqëria;

c) strukturën operative dhe organizative të saj;

d) informacioni, apo përshkrimi i detajuar përsa i përket transaksioneve të kryera me shoqëritë e tjera pjesë e grupit, në vitin kontabël të mëparshëm. Ky informacion duhet të sqarojë;

i. karakteristikat e mallrave dhe shërbimeve të ofruara;

ii. analizën funksionale, rreziqet e marra përsipër nga shoqëria dhe të mirat e përdorura;

iii. afatet kontraktuale dhe natyra e kontratave të lidhura prej saj;

iv. kushtet ekonomike;

v. strategjitë e shoqërisë;

e) metodën e zgjedhur për përcaktimin e transferimit të çmimit, ku duhet të sqarohet metoda e zgjedhur dhe krahasimi i tyre me çmimet e tregut dhe zbatimin e politikave të transferimit të çmimit të zbatuara nga shoqëria krahasur me politikat e grupit në tërësi;

f) ekzistencën e marrëveshjeve për ndarjen e kostove, në të cilën shoqëria merr pjesë.

Mbi rëndësinë e hartimit të dokumentave të standardizuara është shprehur edhe ligjvënësi shqiptar. Në këtë drejtim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka hartuar *Udhëzimin nr. 16, datë 18.06.2014*, i cili jo vetëm sqaron aspektet kryesore të ligjit për transferimin e çmimeve por edhe përmban modelet referuese për informacionin që duhet të paraqitet në dokumentat e hartuar nga shoqëritë për transaksionet cross-border brenda grupit. Këto dokumente janë hartuar sipas modelit të përcaktuar në Guideline të OECD-së.

5. Përfundime

Ky punim nuk ka për qëllim të ezaurojë të gjithë problematikën që lidhet me transferimin e çmimit, por kërkon të vejë theksin tek rëndësia e analizimit të këtij mekanizmi edhe në vendin tonë. Gjithnjë e më shumë shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar janë të lidhura apo ndërverprojnë me shoqëri të krijuara sipas ligjit të një vendi të tretë. Zhvillimi dinamik i tregut shqiptar dhe ndërkombëtarizimi i tij në rritje, bën të nevojshme rritjen e kapaciteteve të autoriteteve tatimore shqiptare për t'iu përgjigjur sfidave në këtë drejtim. Për këtë arsye, kërkohet një profesionalizëm i lartë nga ana e punonjësve tatimorë në përcaktimin e metodës më të mirë në vlerësimin e transferimit të çmimeve brenda grupit, sipas metodologjisë së hartuar nga OECD-ja që gjen zbatim edhe në legjislacionin shqiptar. Nga ana tjetër, duhet patur kujdes që ripërcaktimi i vlerës së drejtë për transaksionet cross-border brenda grupit të mos përkthehet në një kosto më të madhe dhe ndëshkuese për taksapaguesit.

6. Referenca

- Ligji nr. 42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshme në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 43/2014 “Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 16, datë 18.06.2014 “Për transferiminin e çmimit”;
- Udhëzimi nr.9, datë 27/02/ 2015 “Mbi marrëveshjet e çmimit të transferimit në avancë”;
- OECD On Transfer Pricing Guidelines for Multinational Enterprises and Tax Administrations 2010; OECD On The Transfer Pricing Methods;
- Communication from the Commission to the Council, the European Parliament and the Economic and Social Committee towards and Internal Market without tax obstacles A strategy for providing companies with a consolidated corporate tax base for

their EU-wide activities, Brussels, 23.10.2001 COM(2001) 582 final;

- Resolution of the Council and of the representatives of the governments of the Member States, meeting within the Council, of 27 June 2006 on a code of conduct on transfer pricing documentation for associated enterprises in the European Union (EU TPD), (2006/C 176/01);
- **A. Dragonetti, V. Piacentini, A. Sfrondini**, *Manuale di fiscalità internazionale*, Ipsoa ed., III ed., 2008, f. 1132;
- **C. Sommer**, *Separate Accounting or Unitary Apportionment?*, Dissertation, Freie Universitat Berlin, 2010, Josef Eul Verlag, 2011;
- **G. Hufbauer, E. Jung, T. Moran, M. Vieiro**, *The OECD's "Action Plan" to Raise Taxes on Multinational Corporations, 2015* në http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2663503;
- **L. Eden**, *The arm's length standard: making it work in a 21st century world of multinationals and nation states*, February 2015, f.14 në http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2568266

MBI FENOMENIN KRIMINAL TË PASTRIMIT TË PARAVE

Msc. Ardit MUSTAJ¹

Hyrje

Pastrimi i produkteve të veprave penale ose i njohur shkurt si pastrimi parave është procesi i fshehjes së origjinës së paligjshme të parave dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin nga veprimtaritë e ndryshme kriminale. Në këtë proces paratë dhe të ardhurat me prejardhje të paligjshme futen në qarkullimin civil dhe ekonomi dhe përdoren për qëllime të ligjshme, duke fshehur burimin e tyre të vërtetë. Fshehja e burimit u mundëson kriminelëve të gëzojnë këto përfitime, por edhe t'i përdorin për vazhdimin e veprimtarive kriminale.

Pastrimi i parave është një fenomen kriminal në rritje dhe shumë shqetësues, mjaft i lidhur me krimin e organizuar dhe me financimin e terrorizmit, prandaj lufta kundër tij është në qendër të politikës së sotme penale në shkallë ndërkombëtare. Në Shqipëri rezultatet konkrete të saj duket se nuk i po përgjigjen kërkesave në rritje për goditjen e kësaj veprimtarie kriminale. Megjithëse që prej vitit 2000 janë ndërmarrë hapa të shumtë në nivel legjislativ, organizativ dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, të dhënat zyrtare në të vërtetë japin tregues të ulët të rasteve të pastrimit të parave të zbuluara dhe ndëshkuara nga sistemi penal dhe vështirë se reflektojnë shtrirjen dhe madhësinë reale të këtij fenomeni kriminal.

1 Doktorant pranë Departamentit të drejtës Penale/ Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë

Sipas statistikave zyrtare, në vitet 2007², 2008³, 2009⁴, 2010⁵, 2011⁶, 2012⁷, 2013⁸ dhe 2014⁹ ka patur respektivisht 3, 2, 8, 5, 4, 4, 8 dhe 4 çështje penale për pastrimin e parave apo pastrimin e produkteve të veprës penale (neni 287 i Kodit Penal), ku janë dënuar përkatësisht nga 5, 1, 20, 11, 10, 5, 5 dhe 4 persona. Këta tregues të ulët janë evidentuar edhe nga ekspertët e MONEYVAL në Raportin e Vizitës së Katërt Vlerësuese për Shqipërinë, Prill 2011, ku midis të tjerave thuhet: “...*Shqipëria ka kriminalizuar plotësisht pastrimin e parave dhe përgjithësisht në përputhje me Konventat e Vjenës dhe Palermos. Megjithatë ka patur pak dënime për pastrim parash...*”¹⁰ dhe për këtë shkak Shqipëria u vendos nën procedurën e monitorimit për plotësimin e rekomandimeve përkatëse në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ndërsa në Raportin e Gjashtë të Monitorimit të MONEYVAL, Shtator 2015, janë njohur përmirësimet e bëra nga Shqipëria në tre vitet e fundit duke pohuar: “...*Shqipëria ka amenduar Kodin Penal për të zgjidhur mangësitë e identifikuar në Raportin Vlerësues. Janë përfshirë të gjitha kategoritë e veprave penale kryesore dhe elementët fizikë të pastrimit të parave janë sjellë në përputhje me Konventat e Palermos dhe të Vjenës. Ka një tendencë në rritje të dënimeve për pastrim parash...*”¹¹ dhe për këto arsye Shqipëria u hoq nga procedura e monitorimit, megjithatë

2 Ministria e Drejtësisë. 2008. Vjetari Statistikor 2007 (fq.43).

3 Ministria e Drejtësisë. 2008. Vjetari Statistikor 2008 (fq.45).

4 Ministria e Drejtësisë. 2010. Vjetari Statistikor 2009 (fq.47).

5 Ministria e Drejtësisë. 2011. Vjetari Statistikor 2010 (fq.44).

6 Ministria e Drejtësisë. 2012. Vjetari Statistikor 2011 (fq.41).

7 Ministria e Drejtësisë. 2013. Vjetari Statistikor 2012 (fq.44).

8 Ministria e Drejtësisë. 2014. Vjetari Statistikor 2013 (fq.43).

9 Ministria e Drejtësisë. 2015. Vjetari Statistikor 2014 (fq.43). Ky është Vjetari Statistikor i fundit i publikuar deri në Mars 2016.

10 Moneyval. 2011. Report on Fourth Assessment Visit: Anti-Money Laundering and Combating the Financing of Terrorism, Albania (fq.8).

11 Moneyval. 2015. 4th Round Mutual Evaluation of Albania: 6th Regular Follow-Up Progress Report. (fq.7). Ky është edhe dokumenti i fundit i vlerësimit deri në këto momente i këtij organizmi për Shqipërinë.

raporti nuk konkludon me një vlerësim pozitiv përfundimtar pasi thotë: “...Efektiviteti i përgjithshëm do të duhet të demonstrohet në kontekstin e një vizite në vend...”¹²

Nga ana tjetër, Global Financial Integrity, një organizatë me seli në Washington, në raportin e publikuar në Dhjetor 2012 në lidhje me lëvizjet e paligjshme të parave në të gjitha vendet në zhvillim për periudhën 2001-2010, për Shqipërinë ka përllogaritur se gjatë kësaj periudhe kanë dalë jashtë vendit 1.36 miliardë \$ (pa llogaritur këtu edhe lëvizjet e parave në *cash*), të cilat dyshohen se janë para të përfshira në procesin e pastrimit¹³.

Në këtë punim, përkundrejt statistikave të ulëta zyrtare, maten dhe analizohen tregues të ndryshëm për të patur një përfytyrim më konkret të madhësisë së mundshme të këtij fenomeni në vendin tonë, me qëllim që t’i shërbehet vlerësimit të gjendjes reale të këtij kriminaliteti dhe, lidhur me të, politikës së luftimit të tij.

Vlerësimi i fenomenit nisur nga matjet mbi sasitë e parave që pastrohen

Të masësh sa para pastrohet në një vend është mjaft e vështirë sepse ky fenomen karakterizohet nga fshehtësia. Është vetë natyra dhe thelbi i pastrimit të parave që aktivitetet që lidhen me të të mbahen sekrete. Statistikat zyrtare regjistrojnë ngjarjet kriminale, por jo transaksionet vijuese që kryhen me përfitimet nga veprimtaria kriminale. Për të vertetuar përhapjen dhe rrezikshmërinë e fenomenit kriminal të pastrimit të parave është e nevojshme që të tregohen edhe shumat relative parave të pastruara, të cilat përfshihen edhe në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik të një vendi. E njëjta logjikë funksionon edhe për Shqipërinë. Sapo fillon të merresh me studimin e këtij problemi ndeshesh me mungesën e të dhënave, të cilat e vështirësojnë shumë punën në këtë fushë. Pak me ndryshe është situata në vendet e tjera ku prej rreth 20-25 vitesh janë kryer studime të ndryshme për të matur madhësinë dhe efektet që mund

12 Po aty.

13 Global Financial Integrity. 2012. Illicit Financial Flows From Developing Countries: 2001-2010 (fq.37).

të ketë fenomeni i pastrimit të parave.

Disa organizata ndërkombëtare dhe autorë të ndryshëm kanë bërë përpjekje për të përllogaritur dhe treguar një madhësi të krahasueshme të këtij fenomeni kriminal. FMN ka llogaritur madhësinë e parave të pastruara në masën 2-5 % të GDP-së në shkallë botërore ose midis 590 miliardë \$ - 1.5 trilion \$. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) ka llogaritur se në vitin 2009 shuma e parave të pastruara në shkallë botërore shkon në rreth 2.7% të GDP-së botërore (midis 2.1-4%) ose rreth 1.6 trilion \$ (shuma e përgjithshme e të ardhurave nga krimi i organizuar dhe trafiku i lëndëve narkotike është llogaritur në rreth 3.6 % të GDP-së dhe nga kjo shumë pjesa që përfaqëson rreth 2.7% të GDP-së shkon për t'u pastruar)¹⁴.

Walker (1999), studiues australian, ishte i pari që ndërtoi një model ku përllogariti se në të gjithë botën pastrohen rreth 2.85 trilion \$/vit¹⁵. Thelbi i modelit të tij është se ai në fillim llogariti *sasinë e parave që kanë nevojë për t'u pastruar që gjeneroheshin në çdo vend* dhe pastaj llogariti *atë pjesë të këtyre parave të gjeneruara që për t'u pastruar dërgoheshin në një vend tjetër*. Kështu, *sasia e përgjithshme e parave që pastrohen në çdo vend të botës u llogariti si shuma e asaj pjese të parave të gjeneruara në një vend të cilat pastrohen brenda atij vendi plus paratë që vijnë për t'u pastruar nga vendet e tjera të cilat janë gjeneruar në ato vende*. Këtë model, i përmirësuar më pas nga studiues të tjerë siç do të përmendet më poshtë, do të përdorim për të përafëruar madhësinë e këtij fenomeni edhe për Shqipërinë.

Walker llogariti 20 vendet kryesore që gjenerojnë sasitë më të mëdha të parave për pastrim në shkallë botërore dhe që përbëjnë rreth 90% të totalit të parave të pastruara (Tabela 1) dhe 20 vendet kryesore ku shkojnë flukset më të mëdha të parave për pastrim dhe që përbëjnë rreth 70 % të totalit të parave të pastruara (Tabela 2).

14 United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC). 2011. Estimating illicit financial flows resulting from drug trafficking and other transnational organized crimes. Research Report, si dhe <http://www.fatf-gafi.org/pages/faq/moneylaundering/> (akses dt.4.9.2013).

15 Walker, John. 1999. How Big is Global Money Laundering? Journal of Money Laundering Control. Vol. 3, No. 1 (abstract).

Mbi fenomenin kriminal të pastrimit të parave

	Vendi i origjinës	Sasia (miliardë \$/vit)	% e totalit
1.	United States	1320	46.3
2.	Italy	150	5.3
3.	Russia	147	5.2
4.	China	131	4.6
5.	Germany	128	4.5
6.	France	125	4.4
7.	Romania	116	4.1
8.	Canada	82	2.9
9.	United Kingdom	69	2.4
10.	Hong Kong	63	2.2
11.	Spain	56	2.0
12.	Thailand	33	1.2
13.	South Korea	21	0.4
14.	Mexico	21	0.7
15.	Austria	20	0.7
16.	Polonia	20	0.7
17.	Philippines	19	0.7
18.	Netherlands	18	0.6
19.	Japan	17	0.6
20.	Brasil	17	0.6
	Të tjerat	29	9.9

Tabela 1: 20 vendet kryesore të origjinës së parave të pastruara.

	Destinacioni	Shuma (miliardë \$/vit)	% e totalit
1.	United States	538	18.9
2.	Cayman Is.	138	4.9
3.	Russia	120	4.2
4.	Italy	106	3.7
5.	China	95	3.3
6.	Romania	90	3.2
7.	Canada	85	3.0
8.	Vatican City	80	2.8
9.	Luxembourg	78	2.8
10.	France	68	2.4
11.	Bahamas	66	2.3
12.	Germany	61	2.2
13.	Switzerland	58	2.1
14.	Bermuda	53	1.9
15.	Netherlands	50	1.7
16.	Liechtenstein	49	1.7
17.	Austria	48	1.7
18.	Hong Kong	45	1.6
19.	U.Kingdom	44	1.6
20.	Spain	35	1.2

Tabela 2: 20 vendet kryesore të destinacionit të parave të pastruara.

Modeli i Walker u përmirësua nga studiues të Shkollës Ekonomike të Utrehtit, Hollandë, që e përdoren për të matur madhësinë e fenomenit të pastrimit të parave në Hollandë në një studim të kryer në vitin 2006 për llogari të Ministrisë së Financave të atij vendi¹⁶ (në vijim modeli hollandez). Ata arritën në përfundimin se brenda në Hollandë gjenerohen

16 Utrecht School of Economics Netherlands and Australian National University. 2006. The Amounts and Effects of Money Laundering. Report for the Ministry of Finance.

dhe pastrohen midis 3.2 dhe 4.2 miliardë \$, ndërsa rreth 14-21 miliardë \$ të tjera futen për t'u pastruar nga vendet e tjera (20 vendet kryesore të botës ku gjenerohen para për pastrim).

Sipas këtij modeli, për llogaritjen e sasisë së parave që gjenerohen në çdo vend përdoren këto variabla: 1) Statistikat për nivelin e krimit në vend; 2) GDP për frymë; 3) Të dhënat për korrupsionin; 4) Sasia e parave për t'u pastruar të rregjistruara për çdo krim.

Për Shqipërinë, variablat 1, 2, 3 gjenden nga të dhënat zyrtare dhe nga studimet e organizmave ndërkombëtare, ndërsa variabli 4 është shumë i vështirë të gjendet, pasi baza për të është ekzistenca e të dhënave apo studimeve të mëparshme mbi kostot e krimit në vend dhe në Shqipëri aktualisht nuk ka të tilla.

Prandaj, në këtë punim nuk mund të llogaritim sasinë e parave që gjenerohen dhe njëkohësisht pastrohen në Shqipëri, por mund të bëjmë një matje të përafërt të sasisë së parave që gjenerohen në vendet e tjera dhe që vijnë për t'u pastruar në Shqipëri pasi të dhënat që kërkohen mund të gjenden apo të përlllogariten. Sipas modelit kjo realizohet duke (1) llogaritur se sa tërheqës (atraktiv) është një vend për pastruesit e parave dhe më pas (2) duke matur pjesët (propocionet) e parave që shkojnë nga një vend në tjetrin, duke përdorur këtu edhe një variabël distance mes vendeve.

Indeksi i atraktivitetit për pastruesit e parave është përlllogaritur për të gjitha vendet e botës në modelin hollandez (Tabela 3). Për këtë arsye të dhënat për indeksin e atraktivitetit për çdo vend do të merren drejtëpërdrejtë në këte tabelë. Megjithatë, vlen për t'u sqaruar rruga e ndjekur për t'i nxjerrë këto të dhëna. Është përdorur kjo formulë: *Aktraktiviteti* = $(GDP) \times (3 \times BS + GA + SWIFT + FD - 3 \times CF - CR - EG + 10)$, ku:

GDP- PBB për frymë;

BS- Sekretin bankar, i shkallëzuar nga 1 (vende ku nuk ka ligje për sekretin bankar) në 4 (vende ku janë të miratuara ligje për sekretin bankar);

GA- Sjellja e qeverisë, e shkallëzuar nga 0 (qeveri kundër pastrimit të parave) në 4 (qeveri tolerante ndaj pastrimit të parave);

SWIFT- Vend anëtar i SWIFT (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication), i shkallëzuar në 0 (vend jo anëtar) dhe 1 (vend anëtar);

FD- Depozitat Financiare, është sistemi financiar i depozitave në PBB (për të llogaritur këtë është përdorur një metodë më vete);

CF- Konflikti, i shkallëzuar nga 1 (vend ku nuk ka konflikte) në 4 (vende ku ka situata konflikti);

CR- Korrupsioni, është indeksi i Transparency International, i shkallëzuar nga 1 (i ulët) deri në 5 (i lartë);

EG- Anëtar i Grupit EGMONT, i shkallëzuar në 0 (jo anëtar) dhe 1 (anëtar).

Luxembourg	55.4
Bermuda	26.4
Switzerland	25.7
Cayman Islands, ..Hong Kong, Austria, Liechtenstein, ...	21-20
Canada, ...Vatican City (Holy See)	17-15
France...,Germany, Netherlands	15-13
Italy, ...Bahamas ...	13-12
...United States	12-11
...United Kingdom, Spain...	10-9
...Russia, ...	4-2
... Romania,...Albania, ...	2-1
...China, ...	1-0

Tabela 3: Indeksi i atraktivitetit

Hapi tjetër është bashkimi i rezultateve të atraktivitetit me rezultatet e variablit të distancës. Variabli i distancës nënkupton se sa më afër janë vendet me njeri tjetrin, aq më i madh është propocioni i parave të pastruara. Në kohën e globalizimit të tregjeve financiare koncepti i distancës nuk është thjesht distanca fizike mes vendeve. Distanca fizike mund të luajë rol, por është më realiste që të merren në konsideratë edhe faktorë të tjerë, duke arritur kështu një rezultat për variablin e distancës për secilin shtet. Formula për këtë është: $Distanca = Gjuha + tregtia + e kaluara koloniale + distanca fizike$. Gjuha, e kaluara koloniale, tregtia llogariten me shkallëzim nga 0 (e njejtë) - 1 (e ndryshme), distanca fizike

nga 1 (më i afërti) - 7 (më i largëti). Kjo e fundit shkallëzohet nga 1-7 duke marrë për bazë rajonet e ndryshme të botës dhe jo shtete të veçanta, në mënyrë që llogaritjet të jenë sa më pak të komplikuar. Në këtë rast vlera e distancës fizike mes vendeve konkrete do përcaktohet nga rajonet ku ato ndodhen (Tabela 4).

	North America	South America	Europe	Africa	Middle East	Asia	Southeast Asia
North America	1	3	3	5	4	5	7
South America		1	5	6	6	5	7
Europe			1	2	2	3	4
Africa				1	3	3	4
Middle East					1	2	4
Asia						1	2
Southeast Asia							1

Tabela 4: Distancat mes zonave

Pastaj indeksi i *atraktivitetit* dhe variabli i *distancës* kombinohen me njëri-tjetrin në formulën e mëposhtme për të gjetur pjesën e parave “të pista” të gjeneruara për pastrim në çdo vend të cilat shkojnë për t’u pastruar në vendet e tjera:

$$P(X, Y_i) = \frac{1}{\sum_{i=1}^n \left(\frac{\text{atraktiviteti}(Y_i)}{\text{distanca}(X, Y_i)} \right)} \times \frac{\text{atraktiviteti}(Y_i)}{\text{distanca}(X, Y_i)}$$

ku P është propocioni i parave që shkojnë nga vendi X në vendin Y_i (psh: X është Italia dhe Y_i është Shqipëria) dhe $i = 1 \dots n$ janë të gjitha vendet e botës. Për shembull: Propocioni i parave që shkojnë nga vendi X (Italia) tek vendi Y_i (Shqipëria) është i barabartë me atraktivitetin e Shqipërisë, i peshuar me distancën mes Italisë dhe Shqipërisë. Kjo pastaj korrektohet me rezultatin total të atraktivitetit për të gjitha vendet me qëllim që rezultati të mos dalë më i madh se 1. Me anë të kësaj mënyre, sipas modelit, nga paratë që gjenerohen në Itali gjendet pjesa që shkon

për t'u pastruar në Shqipëri, në raport kjo me pjesën e parave që shkon për t'u pastruar nga Italia në të gjitha vendet e tjera të botës.

Përpara aplikimit të formulës për Shqipërinë duhet të bëjmë disa supozime me rëndësi:

-Qëllimi i punimit është që nëpërmjet aplikimit të modeleve ekzistuese t'i përafrohemi madhësisë reale të fenomenit të pastrimit të parave. Prandaj, si vende që gjenerojnë para për pastrim do të marrim disa nga vendet kryesore me të cilat kemi lidhje ekonomike, tregtare ose emigracioni dhe që gjenden në tabelën 1, siç janë Italia, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Franca. Do të ishte me interes që këtu të përfshiheshin edhe vende si Greqia, Turqia dhe ndonjë vend tjetër i rajonit që mund të plotësojnë të njëjtat kritere, por në këtë punim kjo është e pamundur pasi këto vende nuk gjenden në tabelën 1 dhe për pasojë nuk kemi të dhëna për sasinë e parave që gjenerojnë për pastrim.

-Për thjeshtëzim do të marrim për bazë vetëm 20 vendet kryesore të destinacionit të parave, që përbëjnë 70 % të sasisë totale të parave në shkallë botërore dhe rezultati do të korrigjohet me 0.7, duke arritur kështu një përafrim real.

Këto supozime i gjejmë logjike për këto arsye:

Së pari: Për shkak të lidhjeve tregtare shumë më të pakta dhe të mungesës së zhvillimit ekonomik sikurse Hollanda, si dhe mosqënies si nyje e rëndësishme tregtie e financiare në shkallë botërore si Hollanda (e favorizuar edhe nga pozicioni gjeografik), Shqipëria nuk ka të njëjtën situatë. Për shembull, është e panevojshme që në hapësirat që lejon ky punim të kërkohet për para që vijnë për t'u pastruar nga Hong Kongu apo Koreja e Jugut në Shqipëri. Është shumë më reale që të merren për bazë vende si Italia, Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar me të cilat vendi ynë ka lidhjet më të ngushta tregtare dhe/ose një numër të madh emigrantësh shqiptarë.

Së dyti: Është praktikisht shumë e vështirë që të llogarisësh kombinimet e atraktivitetit të 20 vendeve kryesore (që gjenerojnë para për pastrim e që përbëjnë rreth 90% të totalit) me mbi 100 vendet e tjera të botës tek të cilat shkojnë paratë e tyre për t'u pastruar. Duke marrë për bazë 20 vendet që përfaqësojnë rreth 70 % të shumës dhe duke e korrigjuar rezultatin me 0.7, mund të arrihet një vlerësim mjaft i pranueshëm.

Së treti: Vetë qëllimi i këtij punimi nuk është që të llogaritet saktë sasi të e parave që pastrohen në Shqipëri, për shkakun e thjeshtë se kjo është e pamundur për cilindo, por që nëpërmjet aplikimit të modeleve ekzistuese t'i përafrohemi sa më shumë madhësisë reale të këtij sektori dhe të jepet një përfytyrim konkret i tij.

Kështu, rezultatet e variablit të distancës së këtyre katër vendeve në raport me secilin prej 20 vendeve kryesore të destinacionit të parave janë llogaritur dhe jepen në tabelën 5.

	SHBA	Ishujt Cayman	Rus	Itali	Kinë	Rum	Kanad	Vatik	Luks	Fra	Baha
Itali	5	6	4	1	6	4	6	1	4	3	6
Gjermani	5	6	4	3	6	4	6	4	3	3	6
Francë	5	6	4	3	7	4	4	4	2	1	6
Mb.Bashk.	3	4	4	3	6	4	4	4	4	3	4

...vazhdim

	Gjerm	Zvi	Bermu	Holl	Liten-shtein	Aus	Hong Kong	Mbret. Bashk	Span
Itali	3	2	6	3	4	4	7	3	3
Gjermani	1	3	6	3	2	2	7	3	3
Francë	3	3	6	3	4	4	7	3	3
Mb.Bashk.	3	4	4	3	4	4	5	1	3

Tabela 5: Variabli i distancës me 20 vendet kryesore të destinacionit.

Indeksi i atraktivitetit të të gjitha vendeve është llogaritur në modelin hollandez (Tabela 3). Duke patur parasysh kushtet e Shqipërisë në raport me vendet e tjera të vlerësuara me indeksin 2-1, çmohet më e arsyeshme të përdoret indeksi "1". Indekset e atraktivitetit të Italisë, Gjermanisë, Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar me të njëjtin argument do të merren: Italia "12.5", Gjermania "14", Franca "14", Mbretëria e Bashkuar "9.5".

Rezultatet e variablit të distancës së Italisë, Gjermanisë, Francës dhe

Mbretërisë së Bashkuar me Shqipërinë paraqiten në tabelën 6.

	Gjuha	Tregtia/ emigrantët	E kaluara Koloniale	Distanca fizike	Totali
Italia	1	0	1	1	3
Gjermania	1	1	1	1	4
Franca	1	1	1	1	4
Mb.Bashkuar	1	1	1	1	4

Tabela 6: Variabli i distancës me Shqipërinë.

Të dhënat e tabelave 3, 5 dhe 6 zbatohen në formulën e $P(X, Y_i)$ dhe arrijmë në këto propocione të parave që vijnë nga secili prej katër shteteve për t'u pastruar në Shqipëri:

$$P(\text{Itali} - \text{Shq}) = \frac{1}{149.5} \times \frac{1}{3} = 0.002229$$

ku në pjesën e parë numri 149.5 është shuma e atraktiviteteve të 20 vendeve kryesore e korrigjuar secila me variablin përkatës të distancës mes Italisë dhe çdonjërit prej këtyre vendeve që ka dalë nga llogaritjet, ndërsa në pjesën e dytë numri 1 është atraktiviteti i Shqipërisë, ndërsa numri 3 është variabli i distancës së Shqipërisë me Italinë.

$$P(\text{Gjermani} - \text{Shq}) = \frac{1}{149.1} \times \frac{1}{4} = 0.00167$$

$$P(\text{Mbr.Bashkuar} - \text{Shq}) = \frac{1}{133.1} \times \frac{1}{4} = 0.001878$$

$$P(\text{Francë} - \text{Shq}) = \frac{1}{149.3} \times \frac{1}{4} = 0.001674$$

Në vijim, duke ditur sasitë e parave që gjenerojnë Italia, Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar të cilat jepen në tabelën 1, mund të gjejmë atë pjesë të tyre që vijnë për t'u pastruar në Shqipëri. Kështu, për Italinë kemi $0.002229 \times 150 \text{ miliardë } \$ = 0.33435 \text{ miliardë } \$$; për Gjermaninë $0.001676 \times 128 \text{ miliardë } \$ = 0.214528 \text{ miliardë } \$$; për Mbretërinë e Bashkuar $0.001878 \times 69 \text{ miliardë } \$ = 0.129582 \text{ miliardë } \$$; për Francën kemi $0.001674 \times 125 \text{ miliardë } \$ = 0.20925 \text{ miliardë } \$$. Në total sasia e parave që vjen nga të katër këto shtete rezulton $0.88771 \text{ miliardë } \$/\text{vit}$ ose $887.71 \text{ milion } \$/\text{vit}$.

Kjo shumë përbën rreth 6.7-7.4 % të GDP-së së vendit tonë të viteve të fundit (për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012, GDP-ja varion mes 11.86 – 13.12 miliardë \$), si dhe është afër madhësisë së fenomenit të pastrimit të parave në raport me GDP-në që kanë identifikuar organizatat ndërkombëtare apo autorët e ndryshëm. Megjithatë, duke patur parasysh se është pranuar nga institucionet dhe organizmat përkatës se vendi ynë ka akoma një sektor jo të vogël informal dhe të pa raportuar të ekonomisë e që mund të arrijë në një përqindje të konsiderueshme të GDP-së (mund të shkojë deri në 50 % të GDP-së zyrtare sipas *The World Factbook* të CIA-s), madhësia e shumës së parave të pastruara të llogaritur më lart mund të përbëjë në të vërtetë një përqindje më të vogël të madhësisë së ekonomisë reale (GDP-së reale).

Kështu, nëpërmjet modelit të mësipërm matëm në një shkallë të përafërt sasinë e parave që vijnë në Shqipëri për t'u pastruar nga disa prej vendeve të tjera me të cilat ne kemi më shumë lidhje. Por, madhësisë së këtij fenomeni duhet t'i shtohen edhe shumat e parave që në çdo kohë mund të vijnë nga vende të tjera që, për pamundësi objektive, nuk janë marre në konsideratë në përlllogaritjet e mësipërme, si dhe sasia e parave që gjenerohen në Shqipëri dhe që pastrohen po këtu, për të cilat shpjeguar më lart arsyet se përse nuk mund t'i llogaritim në këtë punim.

Me anë të këtij modeli është e mundur gjithashtu që formula $P(X, Y_i)$ të aplikohet për Shqipërinë edhe ndaj vetvetes (duke aplikuar atraktivitetin e vendit për veten e tij dhe minimumin e distancës fizike), ku nga tërësia e parave që gjenerohen në vend për t'u pastruar, mund të gjendet sa është propocioni apo përqindja që mbetet për t'u pastruar brenda vendit dhe sa është ajo që shkon për t'u pastruar në vendet e tjera. Kjo bën të mundur që, duke ditur më parë sasinë totale të parave të gjeneruara (sikurse janë nxjerrë për shembull nga Walker në tabelën 1 vendet kryesore), të gjendet sasia e parave që mbetet brenda vendit dhe ajo që shkon jashtë për qëllime pastrimi. Për shembull, në modelin hollandez nga kjo përlllogaritje ka rezultuar se 44% e parave të gjeneruara për t'u pastruar në Hollandë mbeten në Hollandë, ndërsa pjesa tjetër do të shkojë jashtë vendit. Gjithashtu në vlerë totale ka rezultuar se rreth 30 miliardë \$ pastrohen çdo vit në Hollandë, nga të cilat 26 miliardë \$ vijnë nga jashtë dhe 4 miliardë \$ janë nga pjesa e parave që janë gjeneruar në Hollande dhe që mbeten për t'u pastruar po aty.

Vlerësimi i fenomenit nisur nga veprat penale prej nga rrjedhin përfitimet e paligjshme

Për të patur një përfytyrim më konkret për madhësinë e fenomenit kriminal të pastrimit të parave/produkteve të veprave penale mund të referojmë edhe tek shkalla e përhapjes së krimeve kryesore (*predicate offences*) të cilat janë veprat penale që gjenerojnë produkte dhe përfitime të paligjshme pjesa më e madhe e të cilave i nënshtrohen më pas procesit të pastrimit, domethënë të fshehjes së burimit të paligjshëm të tyre dhe paraqitjes si të ardhura apo pasuri të fituara në mënyrë të ligjshme. Vepra penale e pastrimit të parave ose pastrimit të produkteve të veprave penale¹⁷ lidhet me kryerjen më parë të veprave tjera penale, përfitimet e të cilave pastrohen. Megjithëse neni 287 i Kodit tonë Penal që parashikon veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” nuk përjashton asnjë vepër penale prej nga mund të rrjedhin përfitimet e paligjshme, në aspektin praktik janë disa lloje apo grupe veprash penale të cilat pranohet se janë përgjithësisht veprat më tipike që gjenerojnë të ardhura dhe përfitime për autorët e tyre e që kanë nevojë të futen në procesin e pastrimit dhe këtu bëjnë pjesë kryesisht veprat e listuara në tabelën e mëposhtme¹⁸:

17 Megjithëse shpesh në praktikë përdoret termi pastrim i parave, në fakt në këtë koncept juridikisht përfshihen të gjitha përfitimet e paligjshme që rrjedhin nga veprat penale, të cilat quhen produkte të veprave penale. Ky është koncepti që jepet në aktet juridike ndërkombëtare si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000, Konventa e Këshillit të Europës “*Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit*” e vitit 2005, Konventa Penale për Korrupsionin e Këshillit të Europës e vitit 1999, etj., si dhe në Kodit tonë Penal në nenin 287 të tij.

18 Moneyval. 2011. Report on Fourth Assessment Visit: *Anti-Money Laundering and Combating the Financing of Terrorism, Albania* (fq.65-66).

Veprat penale	Dispozitat e Kodit Penal
Krijimi dhe pjesmarrja në organizatë kriminale	333, 333/a, 334
Terrorizmi, përfshirë edhe financimin e tij	230, 230/a, 230/b, 230/d
Trafikimi i personave dhe dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	110/a, 128/b, 298
Shfrytëzimi seksual dhe trafikimi i femrave (përfshirë edhe atë të të miturve)	100, 101, 114/b
Trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe i substancave psikotrope	283, 283/a
Trafikimi i paligjshëm i armëve	278/a
Trafikimi i paligjshëm i sendeve të vjedhura dhe i mallrave të tjera	138, 138/a, 141/a
Korrupsioni	164/b, 244-245, 259-260, 312, 319, 319/a
Mashtrimet	143, 143/a, 144,
Falsifikimi i parave	183
Falsifikimi i veprave të artit, vulave, produkteve	147, 190, 288
Krimet kundër mjedisit	201-203
Vrasjet dhe plagosjet e rënda	76-85, 87-88
Rrëmbimi, heqja e paligjshme e lirisë	109, 109/a, 110
Vjedhet, vjedhjet me dhunë apo armë	134-136, 138-141, 192/a
Kontrabanda	171-177
Shtrengimi për dhënie pasurie, shkatërrimi i pronës	109/b, 152
Falsifikimet e dokumentave	165, 184-185, 187-189, 191
Rrëmbimi i anijeve, avionëve dhe mjeteve të tjera	111

Tabela 7: Veprat penale kryesore që gjenerojnë të ardhura të paligjshme (*predicate offences*).

Në një kuptim të përgjithshëm është logjike që të ekzistojë një lidhje në raport të drejtë mes nivelit të kriminalitetit për veprat penale të mësipërme dhe pastrimit të përfitimeve të paligjshme të rrjedhura prej tyre (pa përjashtuar edhe vepra të tjera penale). Sa më i lartë të jetë numri i krimeve nga ku rrjedhin përfitime të paligjshme aq më të mëdha do të jenë vetë këto të fundit dhe për pasojë këtë tendencë do të ketë edhe nevoja për pastrimin tyre, duke çuar realisht në një numër më të lartë të lartë të rasteve të kryerjes së krimit të pastrimit të parave/produkteve të veprave penale.

Në tabelën e mëposhtme (tabela 8) për secilin nga vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014 jepet numri i përgjithshëm i çështjeve penale të gjykuara për krimet e mësipërme dhe i të dënuarve për to¹⁹, krahasuar me numrin e çështjeve penale dhe të personave të dënuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal²⁰. Për secilin vit, për ta bërë më të thjeshtë paraqitjen në tabelën 8, numri i çështjeve penale dhe i personave të dënuar për veprat e listuara në tabelën e mësipërme (tabela 7) nuk është paraqitur në mënyrë të detajuar për çdo grup veprash penale, por në total.

19 Të dhënat janë marrë dhe përpunuar nga Vjetarët Statistikorë të viteve 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 të botuar nga Ministria e Drejtësisë, konkretisht: fq.39-44 të Vjetarit Statistikor 2007, fq.39-46 të Vjetarit Statistikor 2008, fq.41-49 të Vjetarit Statistikor 2009, fq.38-45 të Vjetarit Statistikor 2010, fq.35-42 të Vjetarit Statistikor 2011, fq.38-45 të Vjetarit Statistikor 2012, fq.37-45 të Vjetarit Statistikor 2013 dhe fq.36-44 të Vjetarit Statistikor 2014.

20 Të dhënat për këtë veprë penale janë përmendur në fillim të këtij punimi.

	2007		2008		2009		2010	
	Çështje penale	Të dënuar	Çështje penale	Të dënuar	Çështje penale	Të dënuar	Çështje Penale	Të dënuar
Veprat penale kryesore që sjellin përfitime të paligj.	2471	2815	2668	3185	2427	2950	2402	3038
Pastrimi i produkteve të veprave penale	3	5	2	1	8	20	5	11

...vazhdim

	2011		2012		2013		2014	
	Çështje penale	Të dënuar	Çështje penale	Të dënuar	Çështje penale	Të dënuar	Çështje Penale	Të dënuar
Veprat penale kryesore që sjellin përfitime të paligj.	2882	3713	3216	3994	3141	3957	3162	3828
Pastrimi i produkteve të veprave penale	4	10	4	5	8	5	4	4

Tabela 8: Krahasimi i çështjeve të gjykuara dhe i të dënuarve të veprave penale kryesore që gjenerojnë të ardhura të paligjshme dhe të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprave penale.

Është me rëndësi të theksohet se nuk duhet spekuluar me shifrat e mësipërme në kuptimin që të kërkohet një përafrim i numrit të çështjeve penale dhe i të dënuarve respektivë apo të kërkohet një raport i caktuar mes numrit të çështjeve penale që sjellin përfitime dhe i të dënuarve për to dhe çështjeve apo të dënuarve për pastrim parash/përfitimesh nga veprat

penale. Ky nuk është as qëllimi i këtij punimi. Për më tepër, përcaktimi apriori i një shkalle apo raporti të zbulimit të rasteve të pastrimit të parave/përfitimeve nga veprat penale është i pamundur pasi në procesin e pastrimit futet një pjesë e madhe por asnjëherë e gjithë sasia e përfitimeve nga veprat penale dhe nga ana tjetër, duke qënë se është një veprimtari e fshehtë, është objektivisht e vështirë që të zbulohen 100% të rasteve të kryerjes së saj. Megjithatë, në lidhje me objektin e trajtimit të këtij punim, nuk mund të mos vihet re që në disa vite rradhazi, përkundrejt shifrave që variojnë midis 2400-4000 në vit të numrit të çështjeve penale apo të personave të dënuar për veprat penale burim kryesor të ardhurash të paligjshme, janë vetëm 2-8 rastet e gjykuara të pastrimit të produkteve të veprave penale në vit dhe 1-20 të personave të dënuar për to në vit me vendim përfundimtar. Pra, vihet re një dispropocion shumë i madh mes këtyre çështjeve dhe mes të dënuarve, megjithëse vitet fundit ka një tendencë të lehtë rritje në krahasim shifrat simbolike të viteve të mëparshme. Edhe në qoftë se brenda grupit të madh të veprave penale të cituara më lart (tabela 7) do të merreshin për bazë vetëm disa nga llojet më tipike që lidhen edhe me kriminalitetin e organizuar dhe sjellin shumë përfitime të paligjshme, si psh. ato që lidhen me organizatat kriminale dhe me shfrytëzimin dhe trafikimin e personave, trafikimin e lëndëve narkotike dhe trafikimin e armëve, përsëri raportet me pastrimin e parave janë të rendit të disa qindrave kundrejt shifrave 1-20. E njëjta situatë është edhe po të merren për bazë vetëm veprat me natyrë thjesht ekonomiko-financiare që kanë si qëllim realizimin e përfitimeve pasurore si psh. vjedhjet, mashtrimet, falsifikimet, kontrabanda dhe korrupsioni. Këto të dhëna në tërësi evidentojnë në mënyrë të qartë se shtrirja e fenomenit kriminal të pastrimit të parave apo pastrimit të produkteve të veprave penale jo vetëm që nuk përfaqësohet nga ajo që është zbuluar nga autoritetet zbatimit të ligjit dhe kjo mund të jetë e pranueshme deri në një farë mase për vetë natyrën e fshehtë të kësaj veprave penale dhe vështirësitë objektive në zbulimin e saj, por treguesit e mësipërm të kriminalitetit janë indicje të forta për gjykuar se shumica e rasteve të pastrimit nuk arrihen të zbulohen nga organet përkatëse dhe se ky fenomen ka një shtrirje dhe përhapje shumë më të gjërë sesa ç'mund të tregojnë statistikat zyrtare.

Konkluzione

Diskutimi mbi pastrimin e parave apo produkteve të veprave penale do të mbetet një përpjekje teorike nëse nuk do të dimë në një shkallë të krahasueshme apo të matshme edhe shtrirjen dhe madhësinë reale të këtij fenomeni kriminal.

Në këtë punim kemi treguar, nëpërmjet aplikimit të një modeli të pranuar dhe të përdorur në studime të kryera në vendet perëndimore, një minimum objektiv të sasisë së parave që mund të pastrohen në Shqipëri, sasi e cila rezultoi e konsiderueshme. Rezultatet e nxjerra janë përpjestimisht të përafërta dhe në nivele të krahasueshme me të dhënat e organizmave ndërkombëtarë apo të vendeve të tjera të zhvilluara (siç janë Holanda dhe Australia ku është aplikuar modeli). Për të patur një tablo më të plotë të madhësisë së fenomenit të pastrimit të parave në vendin tonë, kësaj shume duhet t'i shtohet edhe një pjesë e vogël e parave që mund të vijnë edhe nga vende të tjera veç atyre që janë vlerësuar më lart, si dhe sasia e parave që gjenerohen dhe pastrohen në Shqipëri.

Gjithashtu, përveç aplikimit të modelit të mësipëm, në punim u përpunuan dhe u analizuan edhe të dhënat për përhapjen e atij kriminaliteti që është më tipik dhe shërben më së shumti si burim kryesor për të nxjerrë përfitime të paligjshme, të cilat kanë nevojë më pas që të futen në procesin e pastrimit. Për tetë vitet e fundit që janë marrë në analizë (2007-2014), për të cilat statistikat zyrtare janë të publikuara deri në kohën e këtij punimi, numri i rasteve të gjykuara për pastrim parash apo produkteve të veprave penale dhe i të dënuarve respektivë rezultoi i papërfillshëm në krahasim me treguesit e këtij kriminaliteti për të njëjtën periudhë, megjithëse vihet re një tendencë të lehtë rritjeje vitet e fundit.

Rezultatet e nxjerra konfirmojnë se lufta konkrete ndaj pastrimit të parave në vendin tonë akoma nuk i përgjigjet plotësisht shkallës reale të përhapjes së këtij kriminaliteti (në të vërtetë ky shqetësim është prezent në të gjitha vendet, por numri i rasteve të zbuluara të pastrimit të parave në vendet perëndimore është në një raport shumë më të lartë). Ato janë edhe një indikator i mangësive të derivonshme në legjislacionin përkatës të pastrimit të parave dhe në aftësitë e organeve tona të zbatimit të ligjit.

Lufta kundër pastrimit të parave duhet finalizohet me rezultate

konkrete. Në fund të fundit ato janë matësi real i të gjitha përpjekjeve që po bëhen në vendin tonë në këtë drejtim. Prandaj edhe njohja sa më e plotë e karakterit dhe shtrirjes reale të fenomenit kriminal të pastrimit të parave do të orientojë më mirë gjykimet për zgjedhjen, implementimin dhe vlerësimin e politikave penale dhe masave të tjera legjislative dhe organizative që mund ndërmerren për trajtimin e tij. Ndryshimet e vitit 2012 në Kodin Penal në lidhje me veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe ato të ligjit të posaçëm për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, pritet të sjellin më shumë rezultate në luftën kundër këtij fenomeni kriminal.

Bibliografia

1. Financial Action Task Force on Money Laundering. 2012. *International Standards on Combating Money Laundering and the Financing of Terrorism & Proliferation - The FATF Recommendations*.

2. Utrecht School of Economics Netherlands and Australian National University. 2006. *The Amounts and Effects of Money Laundering. Report for the Ministry of Finance*.

3. Walker, John. 1999. How Big is Global Money Laundering? *Journal of Money Laundering Control*. Vol.3, No.1 (abstrakti nw <http://www.emeraldinsight.com/journals.htm?articleid=1648417>, (akses dt.4.9.2013)).

4. Moneyval. 2011. *Report on Fourth Assessment Visit: Anti-Money Laundering and Combating the Financing of Terrorism, Albania*.

5. Moneyval. 2015. *4th Round Mutual Evaluation of Albania: 6th Regular Follow-Up Progress Report*.

6. United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC). 2011. *Estimating illicit financial flows resulting from drug trafficking and other transnational organized crimes. Research Report*.

7. Global Financial Integrity. 2012. *Illicit Financial Flows From Developing Countries: 2001-2010* (fq.37).

8. <http://www.fatf-gafi.org/pages/faq/moneylaundering/> (akses dt.4.9.2013).

9. <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/al.html> (akses dt.4.9.2013).
10. <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.CD> (akses dt.4.9.2013).
11. Ministria e Drejtësisë. 2008. *Vjetari Statistikor 2007*.
12. Ministria e Drejtësisë. 2008. *Vjetari Statistikor 2008*.
13. Ministria e Drejtësisë. 2010. *Vjetari Statistikor 2009*.
14. Ministria e Drejtësisë. 2011. *Vjetari Statistikor 2010*.
15. Ministria e Drejtësisë. 2012. *Vjetari Statistikor 2011*.
16. Ministria e Drejtësisë. 2013. *Vjetari Statistikor 2012*.
17. Ministria e Drejtësisë. 2014. *Vjetari Statistikor 2013*.
18. Ministria e Drejtësisë. 2015. *Vjetari Statistikor 2014*.

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NGA SHTETET ANËTARE

Alkelina GAZIDEDE

Hyrje

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut nga shtetet anëtare është një ndër çështjet më të rëndësishme në kuadrin ligjor të të drejtave të njeriut në sistemin europian. Neni 1 dhe 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut parashikon se është detyrim i shteteve ratifikuese të KEDNJ për të zbatuar çdo detyrim që i rrjedh nga gjykimi i çështjeve kundër tij, për të cilin është disponuar me një vendim të formës së prerë, kur është konstatuar se ka dhunuar dispozitat dhe parimet e Konventës.

Duke vënë theksin mbi procesin e ekzekutimit, kryesisht pas hyrjes në fuqi të Protokollit Nr. 14, qëllimi i këtij artikulli është të paraqesë një reflektim mbi procesin e zbatimit të gjykimeve të Gjykatës së Strasburgut për shkak të rëndësisë që paraqet ky proces nëpërmjet funksionit të tij për parandalimin e dhunimit të Konventës Europiane dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

1. Detyrimi për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Respektimi i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Lirive Themelore dhe në veçanti i gjykimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut është një element themelor në mbrotjen e të drejtave të njeriut, shtetit ligjor dhe stabilitetit të demokracisë në sistemin politiko-ligjor të unifikimit europian.

Në përputhje me nenin 46-1 të Konventës Europiane për të Drejtat e

Njeriut, shtetet anëtare të GJEDNJ kanë detyrimin ligjor për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të saj, të cilat rrjedhin nga gjykime, në të cilat konstatohet shkelje e të drejtave të parashikuar në Konventë. Parimet e përgjithshme mbi detyrimin e shteteve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të GJEDNJ janë në përputhje me bazën ligjore, natyrën dhe qëllimin e saj.

Baza ligjore për detyrimin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut nga shtetet anëtare gjendet në nenin 46 të KEDNJ, e cila parashikon:

1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.¹

Kushtet ligjore, në bazë të të cilave një vendim gjyqësor do të cilësohet i formës së prerë, përcaktohen në përmbajtjen e nenit 44, i cili parashikon:

Vendimet përfundimtare

1. Vendimi i Dhomës së Madhe është përfundimtar;

2. Vendimi i një Dhome bëhet përfundimtar kur;

a) palët deklarojnë se nuk do të kërkojnë që çështja t'i kalojë Dhomës së Madhe; ose

b) nuk është kërkuar kalimi i çështjes në Dhomën e Madhe tre muaj pas datës së vendimit;

c) kolegji i Dhomës së Madhe rrëzon kërkesën për kalimin e çështjes, sipas nenit 43.^{3 2}

Neni 46-1 shpreh detyrimin e përgjithshëm për të ekzekutuar me vullnet të lire vendimet. Për këtë arsye, parimet e përgjithshme parashikojnë përgjegjësinë e shteteve kur provohet se ka dhunuar përmbajtjen e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo nënkupton detyrimin e

1 Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 46 pika 1 e saj

2 Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 43 pika 3 e cila parashikon se aplikimi do të pranohet nga një kolegji prej pesë gjyqtarësh të Dhomës së Madhe, në qoftë se çështja ngre një problem serioz që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e Konventës ose të protokolleve të saj, ose një çështje serioze të një rëndësie të përgjithshme

shtetit respektiv për t'i dhënë fund dhunimit ligjor të KEDNJ-së, të ofrojë shpërblim për dëmin e shkaktuar dhe të parandalojë shkelje të tilla, në të ardhmen. Po kështu, sipas nenit 39-1 të Konventës, Gjykata në çdo fazë të gjykimit mund të vihet në dispozicion të palëve të interesuara, me qëllim që të arrihet një zgjidhje me pajtim për çështjen mbi bazën e respektimit të të drejtave të njeriut sipas përcaktimit në Konventë dhe protokolleve të saj.

Ky vendim, i cili në përgjithësi përfshin dhe një dëmshpërblim në vlerë monetare nga shteti tek aplikanti, është gjithashtu objekt i supërvizimit të Komitetit të Ministrave, sipas parashikimit të nenit 39-4.³

Në çështjen Marckx kundër Belgjikes⁴ bëhet e qartë natyra në thelb deklarative e gjykimeve të saj, ç'ka do të thotë se shtetet janë të lira për të zgjedhur mënyrën e ekzekutimit të ketyre detyrimeve që rrjedhin nga një vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Megjithatë, kjo liri nuk është absolute, duke qenë se është subjekti i mbikqyrjes nga ana e Komitetit të Ministrave sipas nenit 46-2 të KEDNJ⁵.

Burimi i këtij detyrimi është rezultat i faktit që Gjykata, në parim, nuk mund të sugjerojë se cilat masa individuale apo kolektive duhet të zbatohen shtetet në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të saj. Gjithashtu, GJEDNJ nuk mundet as të anulojë, të shfuqizojë ose të modifikojë dispozitat statutore ose vendimet individuale të ndërmarra nga autoritete administrative ose gjyqësore.

Qëllimi i detyrimit të ekzekutimit të vendimeve është i trefishtë:

Së pari, në përputhje me nenin 46/1 të KEDNJ, detyrimi për

3 Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 39 pika 4 parashikon se Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut për çregjistrimin e një çështje e cila është zgjidhur me pajtim i dërgohet Këshillit të Ministrave i cili mbikqyr zbatimin e kushteve të zgjidhjes me pajtim të përcaktuar në vendim.

4 Çështja Marckx kundër Belgjikes, Aplikimi Nr 6833/74 (13 Qershor 1979), Seria A nr 31

5 Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 46 në piken 2 të saj parashikon se vendimi i formës së prerë të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut i përcillet Këshillit të Ministrave i cili do të survejojë ekzekutimin e tij.

të ekzekutuar vendimet e gjykateve është e kufizuar vetëm në palët pjesmarrëse në procedim. Për këtë arsye shtetet të cilat marrin pjesë nëpërmjet një pale të tretë në gjykim sipas nenit 36 të KEDNJ⁶ nuk i nënshtrohen detyrimit për të ekzekutuar përmbajtjen e vendimit. Megjithatë, në përputhje me nenin 1 të KEDNJ shtetet duhet të marrin parasysh interpretimin e Konventës nga Gjykata, kur ato “sigurojnë” të drejtat e Konventës, duke i dhënë një efekt “erga omnes”⁷ gjykimeve.

Së dyti, pjesa detyruese e një vendimi është e formuluar në pjesën e dispozitivit të saj. Megjithatë, edhe pse pjesa e specifikimit të detyrimeve, për aq sa deklarata e shkeljes mund të jetë e pasur me mjete ligjore, interpretimi i motiveve mund të jetë i domosdoshëm, sidomos kur objekti i mosmarrëveshjes është një problem strukturor i identifikuar nga Gjykata.

Së treti, gjykata në çështjen Vermeire kundër Belgjikës⁸ është shprehur se detyrimi për ekzekutimin e vendimit është i menjëhershëm. Kjo nënkupton se shtetit respektiv nuk i akordohet periudha tranzitore për të përshtatur masa të përgjithshme apo individuale. Sikurse është trajtuar me lart, në këtë artikull, GJEDNJ gjithashtu përcakton një afat të arsyeshëm ligjor brenda të cilës vendimi duhet të ekzekutohet përmes marrjes së masave të përgjithshme e individuale. Ky detyrim përfundon kur Komiteti i Ministrave miraton një rezolutë përfundimtare, e cila e mbyll çështjen.

2. Masat Individuale

Lloji i parë i masave të cilat ndërmerren nga shtetet kur konstatohet se kanë dhunuar KEDNJ janë ato individuale, të cilat kane tre aspekte: I

6 Kryetari i Gjykatës, në interes të administrimit të rregullt të drejtësisë, mund të ftojë çdo Palë Kontraktuese që nuk është palë në gjykim ose një person të interesuar që nuk është kërkues të paraqesë komente me shkrim ose të marrë pjesë në seancë.

7 Është një shprehje latine e cila nënkupton “në drejtim të të gjithëve”. Në terminologjinë ligjore, të drejtat ose detyrimet erga omnes i drejtohen të gjitha palëve.

8 Çështja Vermeire kundër Belgjikës, Aplikimi Nr. 12849/87 (29 Nëntor 1991), Seria A nr 214-C

jepet fund dhunimit të të drejtave, të sigurojnë restitutio in integrum dhe të paguajnë demshpërblim kur vendoset nga gjykata.

Detyrimet e shteteve

a.Dhënia fund e dhunimit të të drejtave

Kur Gjykata Europiane e të drejtave të Njeriut konstaton me vendim gjyqësor të formës së prerë se një shtet ka shkelur parashikimet e KEDNJ, shtetet janë të detyruara që t'i japin menjëherë fund shkeljes së të drejtës në bazë të Nenit 46/1 dhe Nenit 1 të KEDNJ.

b.Restitutio in integrum – Rikthimi në gjendjen para se të ndodhte shkelja e së drejtës

Ky detyrim bazohen në nenin 46/1 të KEDNJ. Është detyrimi i shteteve për të shpërblyer për shkeljen e kryer në bazë të legjislacionit ndërkombëtar publik. Në çështjen Pampamichalopoulos kundër Greqisë⁹ gjykata është shprehur se shteti duhet të ndërmarrë masa për zhdëmtimin në një mënyrë të tillë që kur është e mundur situata ligjore të kthehet në gjendjen para dhunimit të së drejtës .Në gjykimin Brumaresou kundër Rumanisë¹⁰, gjykata shprehet se ndreqja duhet të ketë si qëllim ta rikthejë aplikantin në gjendjen kur shkelja nuk kishte ndodhur.

Në rastet kur parimi “Restitutio in integrum”, nuk mund të realizohet për shkak të natyrës së çështjes, shtetet nuk çlirohen nga detyrimi i tyre por ato paguajnë një shumë monetare, e cila përkon me vlerën hipotetike të “Restitutio in integrum”.

c.Shpërblim i drejtë

Obligimi i tretë i shteteve në lidhje me masat individuale është pagimi i një shpërblimi të drejtë sikurse parashikohet në nenin 41 të

9 Çështja Papamichalopoulos kundër Greqisë, Aplikimi Nr 14556/89 (31 Nëntor 1995), Seria A nr 330-B

10 Çështja Brumarescu kundër Rumanisë, Aplikim Nr. 28342/95 (23 Janar 2001), GJEDNJ 2001-I

Konventës : “Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”¹¹

Sipas nenit 46/1 shtetet kanë detyrimin për te paguar një shpërblim të drejtë kur gjykata ka konstatuar shkelje sipas nenit 41, përgjithësisht brenda tre muajve. Disponimi për një shpërblim të drejtë është suplementare e “Restitutio in integrum” dhe disponohet për të brenda tre seancave degjimore ku përcaktimi i shpenzimeve, dëmit material dhe jo material mbetet në çmuarjen e gjykatës.¹²

Një zhvillim i fundit në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut nënvizon se shtetet nuk e përmbushin detyrimin e tyre sipas nenit 46/1 të KEDNJ kur ato paguajnë shpërblimin e drejtë sipas nenit 41. Për shembull, në çështjen Scozzari dhe Giunta kundër Italisë¹³, e rikonfirmuar në çështje të tjera si Hirsi Jamaa dhe të tjerë kundër Italisë¹⁴, gjykata është shprehur “ Një vendim në të cilin gjykata konstaton shkelje, atëhere ajo i mponon shtetit te paditur detyrimin ligjor jo vetem për te paguar aplikantit shumën qëi korrespondon shpërblimit të drejtë, por edhe për të zgjedhur në varësi të mbikëqyrjes së Komitetit të Ministrave masat e duhura individuale të cilat duhet të adaptohen në mënyrë te tille që ti jepet fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për ta përmirësuar aq sa është e mundur efektet e shkeljes se të drejtës. Kështu, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut insiston në detyrimin e shteteve për të ndër marrë masa të përshtatshme të cilat sigurojnë që vendimet ligjore kombëtare të përputhen me parimet e Konventës. Kjo

11 Ky shpërblim duhet t'i jepet aplikantit Brenda tre muajve, kur me vendim të Gjykatës është konstatuar shkelja e shtetit kundër të cilit drejtohet çështja

12 Deborah Forst, Ekzekutimi i gjykimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ICL Journal

13 Çështja Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, Aplikimi Nr. 39221/98 dhe 41963/98 (13 Korrik 2000), GJEDNJ 2000-VIII,

14 Çështja Hirsi Jamaa dhe të tjerë kundër Italisë, Aplikimi Nr. 27765/09 (GJEDNJ 23 Shkurt 2012)

praktikë e re ligjore është implementuar me qëllim që shpërblimi i drejtë të mos jetë me një alternative në masat individuale dhe të përgjithshme, por të konsiderohet një sanksion ndëshkues.

3. Praktika ligjore në lidhje me shpërblimin të drejtë

Në lidhje me detyrimin për t' i dhën fund dhunimit të Konventës, lloje të ndryshme masash janë implementuar nga shtetet. Një nga praktikat me të zakonshme është revokimi i një vendimi kombëtar administrative kur është konstatuar se është në shkelje të Konventës si në çështjen Omojudi dhe A.W.Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar¹⁵.

Një tjetër lloj mase është përfundimi i procedimeve në çështjen ku konstatohet një shkelje e Nenit 6. Për shembull në çështjen Ceteroni dhe të tjetër kundër Italisë, autoritetet italiane njoftuan gjykatat kombetare në lidhje me gjykimin në GJEDNJ me qëllim për të përshpejtuar procedimet në pritje.

Në lidhje me detyrimin e “restitutio in integrum” një game e gjere masash janë identifikuar.

Së pari, shtetet implementuan një praktike ligjore për rihapjen e çështjeve pas gjykimit nga ana e GJEDNJ kur konstatohet se është në shkelje me nenin 6. Në çështjen Öcalan kundër Turqisë, ku u konstatua një shkelje e Nenit 6 për shkak të mungesës së pavarësisë dhe paanshmërisë, gjykata u shpreh se “rihapja e çështjes është një mase e përshtatshme në adresimin e shkeljes”¹⁶.

Keshtu, Gjykata u shpreh se rihapja e çështjeve për rigjykim është një masë e përshtatshme për të përmbushur parimin “Restitutio in integrum”.

Komiteti i Ministratave në mbështetje të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut shprehet se procedura e rihapjes së gjykimeve është e drejtë nëse përmbushen kërkesat e Rekomandimit 2000 ose për të miratuar veprime ligjore për të bërë të mundur, sikurse është shprehur në

15 Omojudi dhe A.W. Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikimi Nr.1820/08 (GJEDNJ 24 Nëntor 2009), dhe Komiteti i Ministrave, ‘ezoluta (2011)82’, 8 Gusht 2011

16 Çështja Öcalan kundër Turkey, Aplikimi Nr. 46221/99 (12 Maj 2005), GJEDNJ 2005-IV

çështjen Dorigo kundër Italisë.

Së dyti shteteve mund t'i kërkohej të rishikojnë, të revokojnë ose të lëshojnë Urdhëra administrative, të tillë si në çështjen Da Silva dhe Hoogkamer kundër Hollandës në të cilën Gjykata i akordoi një leje qendrimi pasi u konstatuar një shkelje e nenit 8¹⁷.

Së treti, masat individuale mund të shprehen në dëmshpërblimin e shumave monetare dhe pronave, sikurse në çështjen Brumarescu dhe të tjerë kundër Rumanisë¹⁸, ku shteti ose duhej të rikthente pronën aplikantit ose të paguante një shumë monetare në vlerë të njëjtë me vlerën e pronës.

Së fundmi, masa të veçanta të natyrave të ndryshme mund të jenë të nevojshme. Për shembull, Mbreteria e Bashkuar lëshoi një Çertifikate të njohjes së seksit për aplikantin transeksual dhe i pagoi asaj një pension në përputhje me praktikën ligjore në çështjen Grant kundër Mbretërisë së Bashkuar¹⁹.

Gradualisht, pagimi i shpërblimit të drejtë duket se ka sjellë rezultate pozitive pasi vetëm në çështje përjashtimore janë kaluar afatet ligjore.

4. Masat e Përgjithshme

Lloji i dytë i masave, të përgjithshmet, lidhen kryesisht me detyrimin për të parandaluar dhunime të ngjashme të Konventës në të ardhmen.

a) Detyrimet e shtetit

Detyrimi për të adoptuar masa të përgjithshme për të parandaluar dhunime të ngjashme të Konventës në të ardhmen është një koncept relativisht i ri dhe i justifikuar nga fakti se gjykimet e GJEDNJ janë të privuara nga efekti i drejtpërdrejtë. Bazohet në detyrimet e ndryshme të

17 Çështja Rodrigues Da Silva dhe Hoogkamer kundër Hollandës, Aplikimi Nr. 50435/99 (31 Janar 2006), GJEDNJ 2006 dhe Këshilli i Ministrave *'Rezoluta e datës 3 June 2010.'*

18 Çështja Brumarescu kundër Rumanisë, Aplikim Nr. 28342/95 (23 Janar 2001), GJEDNJ 2001-I

19 Çështja Grant kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikimi Nr. 32570/03 (23 Maj 2006), GJEDNJ 2006-VII Komiteti i Ministrave –Rezolutë datë 14 Shtator 2011

cilat rrjedhin nga nenet 46/1 dhe 1 e KEDNJ-se dhe e ka origjinen në legjislacionin ndërkombëtar publik. Këto masa përfshijne detyrimin e shtetit për të dëshmshpërblyer problemet strukturore të identifikura nga gjykata. Pra, ky detyrim është i një rëndësie të veçante në çështjet kur gjykata identifikon dhunime strukturore ose sistematike të Konventës . Për të përmbushur detyrimin për të marrë masa të përgjithshme, shtetet duhet të analizojnë nëse shkelja ligjore buron nga një normë, vendim, jurisprudencë ose një praktikë shtetërore dhe të identifikojë se cilit autoritet i atribuohet shkelja. Sikurse e theksuar në çështjen Marck kundër Belgjikës, shtetet nuk mund të aplikojnë më, pas konstatimit të shkeljes, dispozitën e cila dhunon Konventën dhe duhet të ndërmarrin masa tranzitore derisa rregulli ligjor të jetë në përputhje me Konventën. Masat tranzitore në këtë rast janë të nevojshme, e megjithatë Gjykata është shprehur se masat tranzitore nuk duhet të krijojnë apo të paraqesin situata diskriminuese dhe për këtë arsye gjyqtarët kombëtare duhet të sigurojnë një efekt të plotë të standarteve të Konventës sikurse është interpretuar nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut edhe pas përshtatjes të një legjislacioni të ri²⁰. Ndonjëherë, gjykata përcakton një afat, gjatë gjykimit, për miratimin e masave të përgjithshme të kërkuara. Për shembull, në çështjen M.T dhe Greens kundër Mbretërisë së Bashkuar, gjykata u shpreh se shteti respektiv kishte detyrimin për të sjellë propozime legjislativ me qëllim amendimin e legjislacionit të gjykueshëm brenda gjashtë muajve.

Në çështjet kur një problem strukturor është identifikuar, veçanërisht kur gjykata lëshon një gjykim pilot, shtetet duhet të sigurojnë një dëshmshpërblim të brendshëm edhe për çështjet në pritje. Zakonisht, vetëm shteti që merr pjese në mënyre të drejtpërdrejtë në gjykim ka detyrimin për të ndërmarrë masa të përgjithshme. E megjithatë, praktika ligjore ka treguar se disa shtete kanë amenduar legjislacionet e tyre duke marrë si bazë gjykimet e GJEDNJ ndaj shteteve të tjerë dhe gjykatat kombëtare marrin parasysh interpretimin e Konventës në formën e precedentëve ligjore.

Për këtë arsye, gjykimet e ECHR gëzojnë një autoritet bindës për legjislatorët dhe gjykatat kombëtare dhe një efekt parandalues sepse shtetet janë në dijeni se rrezikojnë të dënohen ligjërisht për çdo shkelje të

20 Çështja Fabris kundër Francës, Aplikimi Nr. 16574/08 (7 Shkurt 2013)

konstatuar. Kjo është e lidhur me efektin “erga omnes” të gjykimeve, e cila vjen si pjesë e detyrimit për të siguruar të drejtat e Konvenes sipas nenit 1 të saj. Pra shtetet duhet të marrin parasysh interpretimin e Konventës në precedentët ligjore kur ato mbrojnë të drejtat e parashikuara në Konventë. Në gjykimin Maestri kundër Italisë, gjykata u shpreh se “rrjedh nga Konventa dhe nga Neni 1 në veçanti, se në ratifikimin e Konventës, shtetet ratifikuese marrin përsipër detyrimin që legjislacioni i tyre të jetë në përputhje me parashikimet e Konventes”²¹

Komiteti i Ministrave, gjithashtu, inkurajon shtetet të verifikojnë pajtueshmërinë e drafteve ligjore, ligjeve ekzistuese dhe praktikave administrative me Konventën. Nga njëra anë ato duhet të sigurojnë se kanë mekanizma për të verifikuar sistematikisht pajtueshmërinë e drafteve ligjore me përmbajtjen e Konventës dhe nga ana tjetër duhet të sigurojnë që përshtatja e ligjeve dhe praktikave administrative të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të parandalohet dhunimi i Konventës.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës së fundi ka theksuar rëndësinë e kësaj doktrine në rezolutën e përshtatur në Gusht 2012 në të cilën publikuan një raport të Komitetit të Çështjeve Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut, e cila pranon se precedentet ligjore krijojnë një trup ligjor pas të cilit autoritetet shtetërore janë të lidhura. Pra, Asambleja Parlamentare rekomandon shtetet për të marrë parasysh precedentët ligjore të konsoliduar prej gjykatës kur ato paraqesin drafte ligjore dhe për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen duke marrë në konsideratë interpretimet ligjore të bërë në çështjet e shqyrtuara në GJEDNJ kundër shteteve të tjera kur konstatohen ngjashmëri ligjore mes çështjeve.

5. Praktika ligjore

Masa të përgjithshme të ndërmarra nga shtetet respondete (të drejtpërdrejt) në gjykim

Tipe të ndryshme masash mund të zbatohen nga shtetet për të

21 Çështja Maestri kundër Italisë, Aplikimi Nr. 39748/98 (17 Shkurt 2004), GJEDNJ 2004-I.

përmbushur detyrimet e tyre për të parandaluar në të ardhmen dhunime të Konventës. Fillimisht, gjysma e masave të përgjithshme konsistojnë në ndryshimet ligjore. Normalisht, gjykata nuk ekzaminon pajtueshmërinë e dispozitave ligjore me Konventën, duke qenë se trajton çështje individuale dhe fokusohet në rrethanat konkrete të çështjes. Shkeljet ligjore të Konventës shpesh e kanë origjinën në paqëndrueshmërinë e legjislacionit ose për shkak të dispozites ligjore e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë dhunon Konventën ose sepse ka një boshllëk në legjislacionin e brendshëm. Nga ana tjetër shteteve u kërkohet të mos aplikojnë me dispozitat që vijnë në shkelje me përmbajtjen e Konventës dhe të modifikojnë legjislacionin sikur në çështjen Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar²². Nga ana tjetër, shteteve u kërkohet të paraqesin ndryshime ligjore për të siguruar të drejtat e Konventës. Për shembull, Franca në çështjen Ravon dhe të Tjetë kundër Francës²³, paraqiti një amendim ligjor i cili parashikonte mundësinë për të apeluar kundër Urdhërave të cilat autorizonin kërkime para presidentit të gjykatës së apelit.

Kur dhunimi vjen si rezultat i praktikave të gjykatave kombëtare të cilat interpretojnë dispozitat legjislativë në një mënyrë që sjell dhunimin e Konventës një modifikim në jurisprudencë mund të jetë e përshtatshme. Pasi u denua në çështjen Aka kundër Turqisë nga një vendim i formës së prerë të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Turqia siguroi një efekt të drejtpërdrejtë të gjykimeve të GJEDNJ²⁴.

Masat të cilat kanë lidhje me informimin e autoriteteve respektive dhe publikut në përgjithësi janë të përhapura dhe janë provuar të jenë efikase për të parandaluar shkeljet në të ardhmen. Komiteti i Ministrave gjatë publikimit të gjykimeve të GJEDNJ, inkurajoi shtetet që çështjet të cilat mund të përdoren si precedent ligjor të përkthehen në gjuhën kombëtare në materiale të përshtatshme dhe të përhapen në trupat publike, me shpjegime nese është e mundur. Duke vazhduar me tej, Komiteti i

22 Çështja Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikimi Nr. 7525/76 (22 Tetor 1981), Seria A nr 45.

23 Çështja Ravon dhe të tjerë kundër Francës, Aplikimi Nr. 18497/03 (GJEDNJ 21 Shkurt 2008)

24 Çështja Aka kundër Turqisë, Aplikimi Nr.19639/92 (23 Shtator 1998), GJEDNJ1998-VI.

Ministrave gjithashtu inkurajon shtetet që të aplikojnë trajnime mbi Konventën dhe precedentet ligjore të prodhuar nga gjykimet e GJEDNJ në studimet e shkencave ligjore e politike, gjithashtu edhe për profesionet ligjore dhe të përforsimit të ligjit.

Gjithashtu, masat praktike, përfshijnë edhe takime të gjyqtarëve dhe dialog politik ndërmjet dy shteteve të cilat janë të lidhur në të njëjtin gjykim.

BIBLIOGRAFIA

- Council of Europe, ‘Report of the Group of wise Persons to the Committee of Ministers’, CM(2006)203, 15 November 2006
- Committee on Legal Affairs and Human Rights, Implementation of judgments of the European Court of Human Rights: 8th report, 2015
- Çështja Aka kundër Turqisë, Aplikimi Nr 19639/92 (23 Shtator 1998), GJEDNJ1998-VI.
- Çështja Brumarescu kundër Rumanisë, Aplikim Nr. 28342/95 (23 Janar 2001), GJEDNJ 2001-I
- Çështja Fabris kundër Francës, Aplikimi Nr 16574/08 (7 Shkurt 2013)
- Çështja Frérot kundër Francës, Aplikimi Nr 70204/01 (GJEDNJ 12 Qershor 2007).
- Çështja Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikimi Nr. 7525/76 (22 Tetor 1981), Seria A nr 45.
- Çështja Maestri kundër Italisë, Aplikimi Nr 39748/98 (17 Shkurt 2004), GJEDNJ 2004-I.
- Çështja Marckx kundër Belgjikës, Aplikimi Nr 6833/74 (13 Qershor 1979), Seria A nr 31
- Çështja Grant kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikimi Nr. 32570/03 (23 Maj 2006), GJEDNJ 2006-VII Komiteti i Ministrave – Rezolutë datë 14 Shtator 2011
- Çështja Hirsi Jamaa dhe të tjerë kundër Italisë, Aplikimi Nr 27765/09 (GJEDNJ 23 Shkurt 2012)
- Çështja Öcalan kundër Turkey, Aplikimi Nr 46221/99 (12 Maj

2005), GJEDNJ 2005-IV

– Çështja Omojudi dhe A.W. Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikimi Nr .1820/08 (GJEDNJ 24 Nëntor 2009), dhe Komiteti i Ministrave, ‘rezoluta (2011)82’, 8 Gusht 2011

– Çështja Ravon dhe te tjere kundër Francës, Aplikimi Nr 18497/03 (GJEDNJ 21 Shkurt 2008)

– Çështja Rodrigues Da Silva dhe Hoogkamer kundër Hollandës, Aplikimi Nr . 50435/99 (31 Janar 2006), GJEDNJ 2006-I dhe Këshilli i Ministrave ‘Rezoluta e datës 3 June 2010.’

– Çështja Papamichalopoulos kundër Greqisë, Aplikimi Nr 14556/89 (31 Nëntor 1995), Seria A nr 330-B

– Çështja Salduz kundër Turqisë, Aplikimi Nr 36391/02 (27 Nëntor 2008) GJEDNJ 2008.

– Çështja Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, Aplikimi Nr 39221/98 dhe 41963/98 (13 Korrik 2000), GJEDNJ 2000-VIII,

– Çështja Vermeire kundër Belgjikës, Aplikimi Nr . 12849/87 (29 Nëntor 1991), Seria A nr 214-C

– Deborah Forst, Ekzekutimi i gjykimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ICL Journal

– Supervision of the execution of judgments and decisions of the European Court of Human Rights, 1-st to 8-th Annual Reports by the Committee of Ministers

– http://www.cncdh.fr/article368d.html?id_article=876

– <http://www.coe.int/en/web/portal/reform-of-the-european-court-of-human-rights>

– http://www.echr.coe.int/Documents/2010_Interlaken_FinalDeclaration_ENG.pdf

– http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Reports/Stats/Statistiques_2014_en.pdf

– <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1063779&Site=CM> (last consultation on 3 July 2012).

KONTROLLI I PËRQENDRIMEVE: NJË NGA SHTYLLAT E SË DREJTËS SHQIPTARE TË KONKURENCËS

Ermal NAZIFI, PhD.c. Petrina BROKA Ph.D.

1. Hyrje

Lufta për të fituar sa më shumë tregje dhe klientë është qëllimi kryesor i një biznesi¹. Kjo mund të arrihet nëpërmjet rritjes graduale të biznesit duke investuar në drejtim të cilësisë së produkteve, cmimeve sa më konkurruese, marketingut, kërkimit dhe zhvillimit etj. Por një mënyrë tjetër e shpejtë është edhe përqendrimi (bashkimi) i ndërmarrjeve të pavarura. Arsyet e përqendrimit të ndërmarrjeve mund të jenë nga më të ndryshmet, por arsyet kryesore të përmendura gjerësisht në literaturë janë: rritja e ndërmarrjeve, krijimi i sinergjive dhe arritja e efikasitetit ekonomike².

Në kuadër të globalizimit dhe ndërkombëtarizimit të tregtisë në mbarë botën përqendrimet e ndërmarrjeve shihen si një mjet i shpejtë të hyrë në tregje të reja. Shqipëria ka një peshë të vogël në ekonominë botërore, por gjithsesi është prekur nga kjo veprimtari, në disa mënyra:

- në kuadër të investimeve të huaja, (ku një kompani e huaj bashkohet me një shoqëri vendase. Psh. Blerja e aksioneve të disa kompanive vendase të sigurimeve nga kompani ndërkombëtare).
- në kuadër të zhvillimit të kompanive shqiptare, (kompani vendase bashkohen me njëra tjetër psh. Në tregun e sigurimeve kompania Eurosig bleu aksionet e INSIG)

1 Shih për më tepër, Autoriteti i Konkurrencës, “Politika kombëtare e konkurrencës”, Afërdita, 2006. Fq.7

2 Shih, p.sh. Steven M. Bragg, “Mergers & Acquisitions: A Condensed Practitioner’s Guide”, John Wiley and Sons 2009, fq. 1-5.

- Rastet e privatizimeve të ndërmarrjeve shtetërore nga investitorë vendas apo të huaj etj.

Në nivel botëror, viti që lamë pas ka qenë një vit record për sa I përket përqendrimeve. Në 2015 kanë ndodhur përqendrime me nivelin më të lartë të transaksioneve në histori duke arritur në 4.9 trilion dollarë amerikanë duke kaluar rrekordin e mëparshëm prej 4.6 trilion të vendosur në 2007.³

2. Kuadri ligjor

Në shumë sisteme të së drejtës së konkurrencës, autoritetet e konkurrencës, kanë të drejtën të hetojnë përqendrimet ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, të cilat mund të jenë të dëmshme për konkurrencën. Është e qartë se, nëse një ndërmarrje bashkohet me një ndërmarrje konkurrencte të saj, konsumatorët do të kenë mundësi më të vogla zgjedhjeje dhe mund të detyrohen të paguajnë çmime më të larta. Transaksione të tilla nuk mund të kryhen pa autorizimin e autoriteteve të konkurrencës. Kjo, pasi një nga qëllimet kryesore të politikës së konkurrencës është të parandalojë ndërmarrjet me fuqi të ndjeshme në treg, që të zvogëlojnë prodhimin, apo të rrisin çmimin mbi nivelin konkurrues. Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme, që autoritetet e konkurrencës të kenë mundësinë të shqyrtojnë transaksionet, që çojnë ose mund të çojnë në ndryshime të strukturës së tregut.

Megjithatë, rivaliteti për kontrollin e ndërmarrjeve me anë të bashkimeve ose formave të tjera të riorganizimit, përthithjeve, është në vetvete pjesë e procesit konkurrues dhe duhet pasur kujdes në ndërhyrjet në këtë proces. Kjo, pasi vetëm një numër i vogël i përqendrimeve ka mundësi të dëmtojnë konkurrencën në mënyrë të ndjeshme.

Në shumë vende, autoritetet e konkurrencës mund, ose në bazë të ligjit duhet, të llogarisë çdo rritje të efikasitetit, që mund të rezultojë nga një përqendrim dhe të peshojë këto përfitime përkundrajt efekteve negative që shkaktohen nga ulja e konkurrencës. Madje, një përqendrim, i cili mund të rezultojë si monopol në treg, mund të lejohet, në rast se

3 <http://www.cnbc.com/2015/12/23/the-biggest-merger-deals-of-2015.html>

përfitimet në efikasitet janë mjaftueshëm të mëdha. Megjithatë, autoriteti ka shumë gjasa që të kundërshtojë një përqendrim të propozuar, edhe nëse pritet që ky të sjelli dobi të konsiderueshme në efikasitet, kur dobi të ngjashme, mund të përfitohen në mënyra të tjera, që nuk dëmtojnë konkurrencën, ose që e dëmtojnë me pak atë.

Kontrolli i përqendrimit të ndërmarrjeve në Republikën e Shqipërisë, me qëllim ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg bëhet nga Autoriteti i Konkurrencës në bazë të ligjit 9121, “Për mbrojtjen e Konkurrencës” (LPMK)⁴. Në këtë mënyrë, kontrolli i përqendrimeve përbën një nga shtyllat e së drejtës shqiptare të konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës, që nga viti 2004 ka realizuar kontrollin e mbi 90 përqendrimeve (pa llogaritur këtu përqendrimet që janë njoftuar pranë AK por nuk plotësonin kushtet ligjore për tu kontrolluar nga ky autoritet)⁵.

Me termin “përqendrim” sipas LPMK, do të kuptohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit, si rrjedhojë e:

- Bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra –tjetra.
- Përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje ose pjesë të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave ose asetëve, kontratës ose çdo mjeti të ligjshëm.
- Kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjesë të këtyre të fundit.
- Krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, e cila nuk ka si objekt, apo pasojë, bashkërendimin e veprimtarive konkurruese, ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura.

4 Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Fletorja Zyrtare: Viti 2003, Nr. 71, Faqe 3189.

5 <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/02/A-i-Konkurrences-Raporti-Vjetor-2015-2016.pdf>

3. Llojet e përqendrimeve

Klasifikimi i llojeve të ndryshme të përqendrimeve bëhet në varësi të kriterëve të ndryshme. Kështu, nëse si kriter do të merret qëndrimi i organeve drejtuese, përqendrimet mund të jenë miqësore (*friendly*), ose armiqësore (*hostile*). Pra, nëse përqendrimi i synuar është i mirëpritur nga organet drejtuese, jemi para një përqendrimi miqësor. Ndërsa, jemi përpara një përqendrimi armiqësor, në rast se organet drejtuese janë kundër përqendrimit, por blerësi arrin të fitojë kontrollin me metoda të ndryshme, si: duke blerë aksionet e aksionerëve të vegjël, duke përfituar nga situata të vështira ekonomike të ndërmarrjes, etj.

Një tjetër kriter, është klasifikimi në bazë të tregut ku vepron ndërmarrja. Në bazë të këtij kriteri, përqendrimet ndahen në horizontale, vertikale dhe konglomerate. Pra, nëse ndërmarrjet veprojnë në të njëjtin nivel tregu, do të kemi përqendime horizontale (psh. dy ndërmarrje prodhuese) dhe, nëse veprojnë në nivel të ndryshëm tregu, do të kemi përqendime vertikale (psh. një prodhues dhe një distributor). Ndërsa, me përqendime konglomerate, do të kuptohen përqendrimet ndërmjet ndërmarrjeve, që veprojnë në tregje të ndryshme produkti, si psh. përqendrimi i një ndërmarrjeje në tregun e importit të naftës me një bankë.

Një tjetër klasifikim i përqendrimeve bëhet në bazë të transaksionit që kryhet. Këto lloje përqendrimesh përshkruhen nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”⁶. Sipas këtij ligji, këto lloje janë: bashkimi me përthithje dhe bashkimi me krijimin e një shoqërie të re.

Kështu, “bashkim me përthithje” do të kemi, në rastin kur, dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet kalimit të të gjitha aktiveve e pasivëve të njëjës, ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie.

Ndërsa, me “bashkim me krijim i një shoqërie të re”, do të kuptojmë themelimin e një shoqërie të re tek e cila kalohen të gjitha aktivitetet e pasivitetet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re.

6 Shih, Argita Malltezi “E drejta shqiptare e shoqërive tregtare”, Media Print 2011, fq. 271 -277.

4. Kontrolli i përqendrimeve në legjislacionin shqiptar

1.1 Një vështrim historik i kontrollit të përqendrimeve

Gjatë regjimit komunist, ekonomia shqiptare, ishte një ekonomi e centralizuar plani. Të gjitha ndërmarrjet ishin në pronësi të shtetit dhe në këtë mënyrë, kontrolli i përqendrimeve ishte tërësisht i panevojshëm. Me kalimin e Shqipërisë nga një ekonomi plani, në një ekonomi të lirë tregu, lindi edhe nevoja e kontrollit të përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve.

Për herë të parë, kontrolli i përqendrimeve është parashikuar që në ligjin “Për konkurrencën” të vitit 1995⁷, megjithëse nuk është marrë asnjë vendim nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij. Në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, të vitit 2004, përsëri parashikoheshin një sërë dispozitash për kontrollin e përqendrimeve, e cila ka qenë një pjesë të rëndësishme e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Pas vitit 2006 në ekonominë shqiptare kemi një “valë” përqendrimesh, të cilat kanë ndodhur kryesisht në sektorin financiar (përkatësisht atë bankar dhe të sigurimeve), por edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë⁸. Ndryshimet e ligjit, që u bënë në vitin 2010, sollën edhe ndryshime të rëndësishme për kontrollin e përqendrimeve. Ndryshimi kryesor ishte ndryshimi i mënyrës së vlerësimit të përqendrimeve nga testi i dominancës, në testin e pengimit të ndjeshëm të konkurrencës efektive, ndryshimi i kufirit të xhiros, etj., për të cilat do të flitet në vazhdim.

1.2 Kufiri i Xhiros

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës ka parashikuar se kriteri, që duhet të përmbushë një përqendrim për tu njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës, është arritja e një kufiri minimal të xhiros të shoqërive tregtare pjesëmarrëse në përqendrim. Ky kriter, është i ndryshëm nga ligji i mëparshëm për konkurrencën, i cili kërkonte që të arrihej të plotësoheshin

7 Ligji Nr. 8044 datë 7.12.1995, “Për konkurrencën”.

8 Servete Gruda, Albana Dibra “*Effects of mergers and acquisition in the market structure and their control- Albanian case*”, Conference Proceedings “*Economies in Transition-during and after 4 december 2009, Camaj Pipa, Shkodër 2010*”.

kufijtë e pasurisë së ndërmarrjes. Ligji parashikonte se kërkesa për lejimin e bashkimit duhet të bëhej nëse pasuria e një prej shoqërive pjesëmarrëse, në vitin e fundit financiar, arrin një vlerë kontabël, jo më pak se 50 milionë lekë ose, nëse pasuria e shoqërive pjesëmarrëse në bashkim, në vitin e fundit financiar, arrin vlerën kontabël në jo më pak se 200 milionë lekë.

Konkretisht, në bazë të ligjit të ri për mbrojtjen e konkurrencës, përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet, për të marrë autorizim, nëse në vitin e fundit financiar, *para përqendrimit*⁹:

a) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun ndërkombëtar është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.

b) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.

1.3 Përftimi i Kontrollit

Një tjetër element thelbësor, për një përqendrim, është përftimi i kontrollit. Kontrolli, në kuptim të LK, mund të vendoset nëpërmjet të drejtave, kontratave ose çdo mënyre tjetër, të cilat, në mënyrë të veçantë ose të kombinuar, në bazë juridike ose faktike, krijojnë mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi veprimtarinë ekonomike të një ndërmarrjeje. Raste të tilla kemi kur kontrolli vendoset:

- a) me anë të së drejtës së pronës;
- b) me anë të së drejtës për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aktiveve të një ndërmarrjeje;
- c) të drejtave ose kontratave, që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në përbërjen, votimin ose vendimet e organeve drejtuese të një ndërmarrjeje¹⁰.

9 LPMK neni 12 para ndryshimeve të Vitit 2010 (Ligji Nr. 10 317 datë 16. 09 .2 010 Fletorja Zyrtare e vitit 2 010 N r. 135).

10 Neni 10 Paragrafi 2 I LPMK

4.3.1 Kontrolli i vetëm

Mënyra kryesore për vendosjen e kontrollit të vetëm është kur një ndërmarrje blen shumicën e së drejtës së votave të një ndërmarrjeje tjetër. Është pikërisht, e drejta e votës, ajo që përcakton kontrollin dhe jo numri i aksioneve. Kjo, pasi në praktikë mund të ndodhë, që një aksioner në pakicë të ketë kontrollin e vetëm të shoqërisë kur në bazë të të drejtave të fituara në bazë të ligjit apo *de facto* kur është aksioner preferencial dhe ka mundësi të përcaktojë politikën tregtare të ndërmarrjes. Kjo psh. në rastet kur aksioneri në minorancë mund të emërojë më shumë se gjysmën e organeve drejtuese të ndërmarrjes. Një tjetër rast është kur aksioneri në pakicë gjithsesi të arrijë të përcaktojë shumicën e votave pasi aksionerët e tjerë janë shumë të vegjël.

4.3.2 Kontrolli i përbashkët

Në rastin e kontrollit të përbashkët, dy ose më shumë ndërmarrje duhet të jenë në gjendje të kenë një rol vendim-marrës përcaktues në politikën tregtare të një ndërmarrjeje tjetër. Nocioni i rolit përcaktues përfshin edhe pushtetin e bllokimit të veprimeve, që kanë rëndësi strategjike për ndërmarrjen. Në dallim nga kontrolli i vetëm, ku një aksioner ka mundësinë e përcaktimit të vendimmarrjes për çështje strategjike, në rastet e kontrollit të përbashkët, ekziston mundësia e bllokimit nga një iniciative të tillë nga një ose disa ndërmarrje, të cilat mund të mos kenë mundësinë e përcaktimit të politikave, por mund të kenë votë bllokuese, pra pa të cilat nuk mund të miratohet një politikë e tillë. Kjo ndodh zakonisht kur dy ndërmarrjet, që kanë kontrollin, kanë vota të barabarta.

Në këtë rast, do të kemi kontroll të përbashkët pavarësisht nëse ka një marrëveshje për të fituar kontrollin e përbashkët, apo jo. Kontrolli i përbashkët mund të ekzistojë edhe kur aksionarë në minorancë kanë të drejtën e vetos për vendime, që janë thelbësore për përcaktimin e sjelljes strategjike të ndërmarrjes.

1.4 Testi i vlerësimit të përqendrimeve

Siç e përmendëm më sipër, Autoriteti i Konkurrencës, kontrollon përqendrimet me qëllim që të parandalojë cenimin e konkurrencës

së lirë dhe efektive në treg. Ky test është mbështetur në Rregulloren e BE 139/2004 dhe është miratuar së bashku me paketën e ndryshimeve të ligjit të konkurrencës së vitit 2010¹¹. Përpara këtyre ndryshimeve vlerësimi i përqendrimeve bëhej në bazë të testit të dominancës, sipas të cilit Komisioni “ndalon përqendrimet e ndërmarrjeve, që rrezikojnë të krijojnë ose të forcojnë pozitën dominuese të një ose të më shumë ndërmarrjeve”.

Në bazë të këtij testi, përqendrimet të cilat kanë efekte jo konkurruese nuk mund të ndaloheshin, nëse nuk krijojnë pozitë dominuese. Për këtë arsye, u pa i nevojshëm, që testi i dominancës të rishikohej në mënyrë që të përfshiheshin të gjithë efektet anti konkurrues të përqendrimit, si psh. rritja e nivelit të çmimeve, ulja e prodhimit (output-it), diversifikimi, sjellja e risive, etj. Në Bashkimin Europian, një ndryshim i tillë u bë i domosdoshëm pas rrëzimit të disa vendimeve të Komisionit nga Gjykata Europiane e Drejtësisë¹².

Sipas testit të ri:

“Komisioni ndalon përqendrimet e ndërmarrjeve, që kufizojnë, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese¹³.”

Ky test krijon mundësinë për një fleksibilitet më të lartë, pasi koncepti i dominancës është një nga efektet antikonkurrues, që mund të ketë një përqendrim, që shqyrtohet nga Autoriteti i Konkurrencës. Në dallim nga testi i dominancës, faktori kryesor i vlerësimit është pengimi i rëndësishëm i konkurrencës efektive dhe dominancë është vetëm një nga elementet e këtij pengimi të mundshëm.

Autoriteti duhet të bëjë një vlerësim të plotë të efekteve të përqendrimit ndaj konkurrencës në përgjithësi dhe jo vetëm në vlerësimin e dominancës. Pra, do të vlerësohet në mënyrë të plotë eficientat dhe faktorët e tjerë të

11 *Ib. id.* Neni 13.

12 Psh. Rasti Airtours/First Choice. Shih psh. C.J Cook, C.S. Kerse, “EC Merger Control”, Botimi 4, Thomson West 2006.

13 Rregullorja 139/2004 për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (ECMR) OJ L24 29.01.2004, f.1.

evoluimit të tregut pas përqendrimit. Krijimi i efencave është një nga mbrojtjet ligjore, që i bëhet një përqendrimi, i cili *et ceteris paribus* do të ishte jo konkurrues dhe nuk do të autorizohet.

Vlerësimi i efencave është një nga elementet kryesore të vlerësimit të një përqendrimi¹⁴. Ndërmarrjet duhet të përgatiten mirë, që të paraqesin para autoriteteve të konkurrencës një pasqyrim të qartë të efencave, të cilat duhet të balancojnë efektet negative të mundshme të një përqendrimi. Një përqendrim mund të rrisë konkurrueshmërinë në industri, duke përmirësuar kushtet e zhvillimit dhe duke rritur standardet në treg. Por gjithashtu është e mundur që efencat që sjell një përqendrim, të shkaktojnë kundërveprim dhe pasoja në konkurrencë dhe në veçanti dëmtimin e mundshëm të konsumatorëve¹⁵.

1.5 Afatet për njoftimin e përqendrimit

Formalisht, vlerësimi i një përqendrimi fillon me momentin e njoftimit pranë autoritetit të konkurrencës. Sipas nenit 10/2, përqendrimet të cilat plotësojnë kufirin e xhiros, njoftohen brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes për bashkim, për përfitim kontrolli ose për krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët. Para ndryshimeve të vitit 2010, ky ligj parashikonte një afat maksimal njoftimi, prej një jave. Njoftimi përtej afatit maksimal, përbënte një shkelje të rëndë të konkurrencës dhe dënohej me gjobë, prej 2 deri në 10 % të xhiros vjetore të vitit paraardhës¹⁶.

Ligji i ndryshuar, e konsideron njoftimin përtej afatit, si një shkelje

14 An Renckens, “*Welfare standards, substantive tests, and efficiency considerations in merger policy: defining the efficiency defense*”, *Journal of Competition Law and Economics*, Doi. 1–31, 10. 1093/joclec/nhm 007

15 Sipas nenit 13 paragrafi 2 i LPMK, efencat mund të merren parasysh për të lejuar përqendrimin, nëse plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha këto kushte: (a) efencat në fjalë kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së konsumatorëve ose, të paktën, neutralizojnë efektet e mundshme negative që mund të sillte përqendrimi; (b) efencat ekonomike janë ose do të jenë rezultat i përqendrimit nën shqyrtim dhe, për krijimin e tyre, nuk ekzistojnë mënyra alternative më pak anti-konkurruese, se përqendrimi në fjalë; (c) efencat ekonomike duhet të jenë të verifikueshme.

16 LPMK para ndryshimeve të vitit 2010, neni 74.

të lehtë të ligjit. Vetëm në rastet kur përqendrimi ka hyrë në fuqi para se të njoftohet në Autoritetin e konkurrencës dhe ka pasoja negative për konkurrencën, përbën një shkelje të rëndë të ligjit. Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të nenit 59 të ligjit, mund që të shqyrtojë përqendrimet me iniciativën e vet edhe në mungesë të një njoftimi.

1.6 Përfundimi i shqyrtimit të kontrollit të përqendrimit

Në përfundim të procedurës së kontrollit të përqendrimit, Komisioni mund të vendosë:

1. Autorizimin e përqendrimit.
2. Autorizimin e përqendrimit me kushte dhe përqendrime.
3. Ndalimin e përqendrimit¹⁷.

Në rast se përqendrimi autorizohet, palët vazhdojnë në kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore dhe ekonomike për të kryer efektivisht përqendrimin. Në rastin e realizimit të një përqendrimit, para ose pas ndalimit të tij, Komisioni detyron ndërmarrjet pjesëmarrëse, që të marrin masat e nevojshme për rivendosjen e menjëhershme të situatës së mëparshme, veçanërisht, që të kryejnë ndarjen e ndërmarrjeve të bashkuara ose heqjen dorë nga pjesëmarrjet ose aktivet e përfuara.

Gjithashtu, Komisioni mund t'u kërkojë ndërmarrjeve pjesëmarrëse të bëjnë propozime për rivendosjen e konkurrencës efektive, duke u përcaktuar atyre afatin përfundimtar për realizimin e këtyre propozimeve. Nëse Komisioni pranon masat e propozuara, ai përcakton afatin kohor dhe mënyrën e zbatimit të këtyre masave nga ndërmarrjet pjesëmarrëse.

Një tjetër mundësi, është realizmi i përqendrimit me kushte dhe detyrime. Këto kushte duhet të jenë në përpjesëtim me pasojat antikonkurrese të përqendrimit¹⁸.

17 Argita Malltezi, “E drejta shqiptare e shoqërive tregtare”, Mediaprint 2011, faqe 278.

18 Ligji ka parashikuar një listë jo shteruese të kushteve të mundshme që mund të vendosen për autorizimin e përqendrimit si: (a) shitjen e pjesëve të ndërmarrjeve; (b) shitjen e çdo lloj pjesëmarrjeje mbi veprimtarinë e një ndërmarrjeje; (c) ndërprerjen ose lidhjen e marrëdhënieve kontraktore; (ç)

5. Zhvillimet e fundit në fushën e kontrollit të përqendrimeve në Shqipëri

Ashtu si edhe në tregjet botërore gjatë vitit 2015 është vënë re rritja e numrit të njoftimeve të përqendrimeve pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ky ndryshim vjen si pasojë e dinamikave në tregun e brendshëm si dhe të transaksioneve mes kompanive të huaja, të cilat kanë xhiro në tregun e brendshëm dhe për pësoje klasifikohen si transaksione të cilat duhet të njoftohen pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Gjithashtu, në kuadër të mbikëqyrjes së tregut, Autoriteti i Konkurrencës ka administruar të gjithë databasen mbi transaksionet e shitëblerjes së aksioneve nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe ka filluar me nismën e tij procedurat e vlerësimit nëse rastet përmbushnin kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, të cilat nuk ishin njoftuar nga palët të përfshira në transaksion.¹⁹

Gjatë vitit 2015, janë shqyrtuar dhe autorizuar 11 praktika përqendrimesh lidhur me përfitimën e kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re. Përqendrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premisat e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqendruar në treg në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi si dhe direktivave komunitare.

Vendimet e Autoritetit të Konkurrencës në Vitin 2015 vazhdojnë të jenë jo problematike dhe nuk është kaluar në fazën e dytë të kontrollit të tyre. Deri tani në historinë e Autoritetit të Konkurrencës nuk ka pasur asnjë rast ndalimi përqendrimi.

dhënien e licencave; (d) detyrimin për të vepruar ose për të mos vepruar në një mënyrë të caktuar. Shitja e pjesëve të ndërmarrjeve dhe shitja e pjesëmarrjes mbi veprimtarinë janë kushte strukturore ndërsa kushtet e tjera të përmendura më sipër janë kushte sjelljeje.

19 Autoriteti i Konkurrencës, raporti vjetor 2015 dhe synimet kryesore të punës për vitin 2016, faqe 35.

6. *Konkluzione dhe rekomandime*

Ekonomia shqiptare po shkon vazhdimisht drejt rritjes së brendshme, si dhe një tërheqje më të madhe të kapitaleve të huaja. Kjo situatë do të çojë në një rritje të numrit të përqendrimeve. Një faktor i rëndësishëm për këtë rritje do të jetë edhe privatizimi i aseteve publike, si dhe ngritja e një tregu kapitalesh funksional. Gjithashtu, afrimi gjithnjë e më i madh i Shqipërisë me Bashkimin Europian, do të ndikojnë në rritjen e numrit të përqendrimeve në ekonominë shqiptare.

Në mënyrë, që të qartësohet sa më mirë kontrolli i përqendrimit të ndërmarrjeve, për të gjithë palët e interesuara, është e domosdoshme, që Autoriteti i Konkurrencës të përmirësojë më tej aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e konkurrencës. Kjo duhet bërë në përputhje me legjislacionin europian të fushës i cili konsiderohet si një ndër sistemet më të mira të kontrollit të përqendrimeve në botë. Gjithashtu, duhet të miratohen e botohen akte të ndryshme si udhëzues e guida për procedurën e kontrollit të përqendrimeve në vend, të cilat ti drejtohen si specialistëve të fushës, ashtu edhe ndërmarrjeve të interesuara.

Autoriteti i Konkurrencës duhet të bashkëpunojë me entet e ndryshme rregullatore si dhe me Qendrën Kombëtare të Biznesit, për të pasur një sistem sa më të plotë informacioni mbi përqendrimet e mundshme në treg. Gjithashtu, duhet, që ky autoritet të kontrollojë tregun për përqendrimet të pa-njoftuara, pranë këtij institucioni, si dhe për përqendrimet *de facto*, që mund të jenë në treg, në mënyrë që të parandalohen sjelljet antikonkurruese.

Në mënyrë që të mos ketë pengesa ligjore dhe praktike në këtë proces rritje, duhet një bashkëpunim ndërmjet bizneseve dhe konsulentëve të tyre me Autoritetin e Konkurrencës, për të realizuar me sukses procesin e kontrollit të përqendrimeve. Kjo, kërkon edhe një zhvillim të mëtejshëm të kërkimit shkencor dhe profesional në fushën e së drejtës së konkurrencës dhe asaj të kontrollit të përqendrimeve në veçanti, si dhe një përfshirje më të gjerë në kurrikulat e universiteteve si në programet e ciklit të parë ashtu edhe në ciklet më të larta.

Bibliografia

1. ABA Section of Antitrust law, “*Antitrust law Developments*”, (4th edition), Chicago, ABA Books 1997.
2. Autoriteti i Konkurrencës, “Politika Kombëtare e Konkurrencës”, Tiranë, Afërdita 2006.
3. Bragg S.M., “*Mergers & Acquisitions: A Condensed Practitioner’s Guide*”, Hoboken, John Wiley and Sons 2009
4. Cook C.J, Kerse C.S., “EC Merger Control”, 4-th edition, London, Thomson West 2006.
5. Furse M., “*The law of merger control in the EC and the UK*”, Oxford, Hart Publishing 2007.
6. Gruda S., Dibra A. “*Effects of mergers and acquisition in the market structure and their control – Albanian case*”, Conference Proceedings “Economies in Transition-during and after”, Shkodër, Camaj Pipa, 2010.
7. Jones A., Sufrin B., “*EC Competition Law: Text, Cases & Materials*”, Oxford, Oxford University Press 2010.
8. Malltezi A., “E drejta shqiptare e shoqërive tregtare”, Tiranë, Mediaprint 2011.
9. O’Connor D.E., Faille C. C, “Basic Economic Principles: A Guide for Students”, Santa Barbara, Greenwood Publishing Group 2000.
10. Office for Official Publications of the European Union, “EU Competition Law: Rules Applicable to Merger Control”, Luxemburg, European Commission 2010.
11. Renckens A., “*Welfare standards, substantive tests, and efficiency considerations in merger policy: defining the efficiency defense*”, Journal of Competition Law and Economics 2007, 3(2): 149-179.
12. Rodger B.J. and MacCulloch A., “*Competition Law and Policy in the EC and UK*”, 4-th Edition, Abingdon and Neë York, Routledge-Cavendish 2009.
13. Sherman A.J., Milledge H.A. “*Mergers & Acquisitions from A to Z*”, 2-nd Edition, New York, Amacom 2007.

KORRUPSIONI DHE EFEKTET NEGATIVE TË TIJ NË SHQIPËRI

Sali SHEHU

1. Hyrje

Gjatë dy dekadave të fundit ka patur një rritje të interesit publik kudo në botë lidhur me nivelin e korrupsionit. Që nga viti 1998 deri në ditët e sotme, 41 vende kanë nënshkruar Konventën kundër rryshfetit të OECD. Në fund të vitit 2005, hyri në fuqi konventa e UN kundër korrupsionit, e cila konsiderohet si konventa më gjithëpërfshirëse e korrupsionit deri në ditët e sotme. Në vitin 2007 Banka Botërore ka lançuar strategjinë mbi Qeverisjen dhe Antikorrupsionin (GAC)¹. Vitet e fundit Departamenti i Sigurisë dhe Drejtësisë në SHBA karritur përpjekjet në luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu shumë organizata dhe agjenci ndërkombëtare janë përfshirë në luftën kundër korrupsionit në të gjitha vendet. Edhe Shqipëria bën pjesën në grupin e vendeve të përfshira në luftën kundër korrupsionit.

Veçanërisht gjatë dekadës së fundit, në Shqipëri është rritur ndërgjegjësimi rreth pranisë së korrupsionit dheluftës kundër tij. Ai ka qenë një ndër prioritetet e qeverisë shqiptare. Pas vitit 2000, në kuadër të detyrimeve që duhet të plotësohen për procesin e integritetit në BE dhe nevojën për të përshtatur legjisllacionin kombëtar me të drejtën komunitare (acquis communautaire), qeveritë shqiptare kanë shprehur vullnetin e tyre për të luftuar korrupsionin.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar konventat e Këshillit të Evropës: Konventa e Ligjit Civil kundër Korrupsionit në vitin 2000 dhe Konventa e Ligjit Penal kundër Korrupsionit në vitin 2001. Në vitin 2006 Shqipëria u bë pjesë e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,

1 *“Governance and Anti-Corruption - Ways to Enhance the World Bank’s Impact”*, World Bank, 2006

si rezultat i së cilës u krijua “Implementation Review Mechanism” i cili kishte për qëllim reformën anti-korrupsion².

Kuadri ligjor për luftën kundër korrupsionit është inkorporuar në legjislacionin ekzistues penal. Kodi penal përfshin format kryesore të Korrupsionit dhe Kodi i Proçedures Penale përfshin disa mënyra të veçanta hetuese për të luftuar korrupsionin.

Në vitin 2012, Inspektoriati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit nënshkruan një memorandum mirëkuptimi me qëllim luftën kundër korrupsionit, duke krijuar një bazë të dhënash mbi praktikat korruptuese në administratën publike. Në vitin 2012, qeveria e Shqipërisë aprovoi disa kufizime, të përfshira në Kushtetutën e Shqipërisë, mbi imunitetin e gjyqtarëve dhe zyrtarëve të lartë publikë.

Në muajin shkurt të vitit 2016, qeveria shqiptare aprovoi krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Investigimi i korrupsionit të zyrtarëve të lartë publikë është një nga objektivat kryesorë të kësaj strukture. Një hap të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit përbën edhe miratimi i ligjit të vetingut në muajin gusht të vitit 2016. Ky ligj rregullon mënyrën se si do të bëhet vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga institucionet publike dhe institucionet e tjera të drejtësisë. Ligji i vetingut është ligji i parë miratuar nga shtatë projektligjet që plotësojnë reformën në drejtësi.

Nga ana tjetër Bashkimi Evropian ka mbështetur financiarisht qeverinë e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit. Në vitin 2009, **Këshilli i Evropës filloi një projekt me ndihmë teknike kundër korrupsionit të quajtur «Projekti kundër korrupsionit në Shqipëri» (PACA), me një vlerë totale 2.130.000 Euro³.** Por sipas raporteve të Komisionit Evropian, efektet e këtyre përpjekjeve nuk janë ndjerë akoma. Shkalla e ndëshkueshmërisë është shumë e ulët. Prandaj prioritet për qeverinë shqiptare mbetet reforma në sistemin e drejtësisë, e kërkuar nga të gjitha strukturat dhe institucionet ndërkombëtare.

Të gjitha këto përpjekje në luftën kundër korrupsionit pasqyrojnë konsensusin në rritje akademik dhe politik se korrupsioni është i lartë

2 Law No. 9492, dated 13.3.2006.

3 PACA - Project Anti Corruption in Albania.

në vendet në zhvillim dhe është i kushtueshëm. Rritja e interesit publik në luftën kundër korrupsionit tregon besimin se duke dhënë nxitjen e nevojshme, politikanët, zyrtarët publikë dhe shoqëria civile në këto vende mund të reduktojnë shkallën e korrupsionit.

Punimi është ndërtuar nëpeshë seksione. Pas hyrjes, bëhet një analizë sasiore shkallës së korrupsionit në Shqipëri. Fillimisht janë përshkruar rezultatet e disa studimeve të kryera nga institucione kombëtare në bashkëpunim me ato ndërkombëtare. Shkalla e korrupsionit në Shqipëri është analizuar nëpërmjet treguesve të korrupsionit të publikuar nga Transparency International dhe Banka Botërore, të cilët pranohen dhe përdoren nga pjesa më e madhe e shteteve në botë. Seksioni i tretë i artikullit përshkruan efektet e korrupsionit në ekonomi, politikë dhe shoqëri. Në detaje, pasojat ekonomike të korrupsionit paraqiten në seksionin e katërt. Në mbyllje të punimit jepen disa përfundime lidhur me pasojat e korrupsionit në ekonomi.

2. Matja dhe niveli i korrupsionit në Shqipëri

Shumica e studimeve mbi nivelin e korrupsionit është mbështetur nësondazhet dhe anketimet mbi korrupsionin. Këto anketime kanë avantazhin e mbulimit të mirë - është shumë më e lehtë të pyesësh dikë rreth perceptimit që ka ai mbi korrupsionin sesa të matësh drejtpërdrejtë shkallën e korrupsionit.

Në Shqipëri janë kryer studime të ndryshme mbi perceptimin e qytetarëve mbi korrupsionin. Instituti për Alternativat e Zhvillimit dhe Kërkimit (IDRA)⁴ ka kryer disa anketime lidhur me çështjen e korrupsionit në Shqipëri. Sipas gjetjeve të këtyre studimeve (gjatë viteve 2005 dhe 2009), njerëzit më të korruptuar ishin nëpunësit e doganës dhe tatimeve, doktorët, politikanët, gjyqtarët dhe prokurorët. Institucionet fetare, presidentët, media dhe ushtarakët konsideroheshin nga qytetarët si personat më pak të korruptuar.

Në vitin 2011, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin në Vienë në bashkëpunim me Institutin e Statistikës në Shqipëri kreu një studim në shkallë kombëtare mbi korrupsionin në Shqipëri. Sipas

4 *"Impunity – Perception and experience of Albanian citizens"*, IDRA

rezultateve të këtij studimi, shqiptarët mendojnë se korrupsioni është një nga tre problemet më të mëdha me të cilat përballohet vendi i tyre: rreth 37 përqind renditin papunësinë si problemin më kryesor, 22 përqind e personave të intervistuar renditin korrupsionin dhe 20 përqind renditin varfërinë si problemin më të madh me të cilin përballen shqiptarët. Rreth 28,3 përqind e popullsisë së rritur midis moshës 18 dhe 64 vjeç, kanë pohuar se kanë patur ekspozim direkt ose indirekt ndaj rryshfetit. Midis krimeve të ndryshme vjedhja, ofendimi, fyerja, rryshfeti zë vendin kryesor. Një pjesë e madhe e rryshfetit karakterizohet nga shkëmbimi: palët që përfaqësohen në rryshfet marrin dhe japin secila diçka në këmbim. Shesh ato nuk ndodhen në të njëjtin pozicion: një prej tyre ka fuqinë që të negociojë kushtet e këmbimit. Rryshfetet paguhen përpara kryerjes së shërbimit në mënyrë që të përshpejtohet kryerja e shërbimit ose pas kryerjes së shërbimit në formën e një “falenderimi”. Pjesën më të madhe të rryshfeteve shqiptarët e japin për një trajtim më të mirë (71 përqind), për të përshpejtuar procedurat (9 përqind) dhe për të shmangur pagesat e gjobave (9 përqind). Më shumë se 70 përqind e të intervistuarve që kanë pohuar se kanë dhënë rryshfete, u ka paguar rryshfet doktorëve (71 përqind), pothuaj gjysma u kanë paguar infermierëve (47 përqind) dhe 14 përqind e të intervistuarve u kanë paguar rryshfet edhe policëve. Si rezultat doktorët dhe infermierët janë nënpunësit publik që marrin më shumë rryshfete. Nënpunës të tjerë të shtetit që marrin rryshfete janë policët, doganierët, gjyqtarët, prokurorët, rregjistruerit e makinave dhe pronës, tatimorët, nënpunësit e bashkisë dhe mësuesit.

Në vitin 2015, Instituti për Alternativat Zhvillimit dhe Kërkimit (IDRA) ka kryer një studim rreth pandërkueshmërisë. Sipas këtij studimi, korrupsioni, mos-zbatimi i ligjeve dhe keqfunksionimi i sistemit gjyqësor janë konsideruar si faktorët kryesorë të pandërkueshmërisë. Shqiptarët mendojnë se mungesa e shembujve faktikë të dënimit të zyrtarëve të lartë ka stimuluar korrupsionin.

Dy indekset më të njohur në mbarë botë, që llogariten nëpërmjet anketimeve dhe sondazheve janë: Indeksi Vjetor i Përceptimit të Korrupsionit të Transparency International (CPI) dhe Indeksi i Korrupsionit (CI) i Bankës Botërore.

Organizata Ndërkombëtare “International Transparency” është krijuar

në vitin 1993 dhe vetëm dy vjet pas krijimit të saj (1995) ka llogaritur dhe publikuar për herë të parë indekset e perceptimit të korrupsionit, duke përfshirë në anketim 41 vende nga e gjithë bota. Me kalimin e viteve, numri i vendeve të përfshira në studim është rritur. Në vitin 2002, në këto anketime u përfshi edhe Shqipëria, indeksi i së cilës vazhdon të llogaritet dhe publikohet edhe në ditët e sotme. Vendeve të përfshira në studim u llogariten pikët si mesatare të pikëve të disa sondazheve të kryera në vendet përkatëse. Deri në vitin 2011, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit merrte vlerat nga zero për vende shumë të korrupuara në 10 për vende të pakorrupuara, ndërsa pas vitit 2011 pikët minimale dhe maksimale të këtij indeksi ishin përkatësisht 0 dhe 100, siç tregohet në tabelën nr. 1 dhe tabelën nr. 2. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i rendit vendet sipas perceptimit se sa i korrupuar mendohet të jetë sektori publik. Renditja e vendit tregon pozicionin e atij vendi në krahasim me vendet e tjera e përfshira në studim. Sa më e lartë renditja, aq më i korrupuar perceptohet ai vend.

Tabela 1 Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit në Shqipëri⁵

Viti	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Pikët (0-10)	2,5	2,5	2,5	2,4	2,6	2,4	3,4	3,2	3,3	3,1
Renditja	81	92	92	126	111	126	85	95	87	95
Nr. total	102	133	133	159	163	159	180	180	178	183

Tabela 2 Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit në Shqipëri⁶

Viti	2012	2013	2014	2015
Pikët (0-100)	33	31	33	36
Renditja	113	116	110	88
Nr. total	176	177	175	168


Në tabelat nr. 1 dhe nr.2, renditja tregon vendin në të cilin renditet Shqipëria për sa i përket Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit, ndërsa

5 Transparency International database

6 Transparency International database

rreshti i fundit përmban numrin e vendeve që janë përfshirë në studim çdo vit. Nëse do të nxjerrim ndonjë konkluzion mbi ecurinë e nivelit të korrupsionit dhe pozicionin e Shqipërisë në lidhje me vendet e tjera, nuk mund të bazohemi vetëm në numrin rendor, por duhet të parrim parasysh edhe numrin total të vendeve që përfshihen në studim. Rënditja relative (duke marrë në konsideratë edhe numrin e vendeve të marra në studim) paraqitet në Figurën 1.

Figura 1 Rënditja relative e Shqipërisë sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit



Burimi: Llogaritje të autorit

Figura nr.1 tregon qartë pozicionin relativ të Shqipërisë lidhur me nivelin e korrupsionit. Sa më afër zeros të jetë renditja, aq më mirë është pozicionuar vendi në krahasim me vendet e tjera. Sa më afër “njëshit” të pozicionohet, aq më keq i pozicionuar është vendi krahasuar me vendet e tjera. Duket qartë që pas vitit 2007, renditja e Shqipërisë lidhur me korrupsionin është përmirësuar. Gjithsesi Shqipëria vazhdon të përfshihet në vendet me korrupsion më të lartë. Rënditja më e mirë e Shqipërisë përket vitit 2011, të cilës i është afruar shumë edhe ajo e vitit 2015.

Referuar të dhënave të publikuara nga Organizata “International Transparency” dhe Banka Botërore, Shqipëria dhe Kosova kanë indeksin më të lartë të korrupsionit midis vendeve në rajonin e Ballkanit perëndimor.

Tabela 3 Treguesit e korrupsionit për vendet e Ballkanit perëndimor⁷

Vendi	Renditja sipas Indeksit të IT (2015)	Renditja sipas Indeksit të BB (2014)
Shqipëria	88	31.73
Bosnia dhe Hercegovina	76	49.04
Kosova	103	39.42
Maqedonia	66	59.13
Mali i zi	61	57.21
Serbia	71	51.92

Tabela 3 tregon renditjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor sipas dy treguesve: Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të publikuar nga organizata “International Transparency” dhe Indeksit të Kontrollit të Korrupsionit publikuar nga Banka Botërore.

Indeksi i Kontrollit të Korrupsionit i llogaritur nga Banka Botërore reflekton perceptimet sipas të cilave pushteti publik përdoret për përfitim privat, duke përfshirë si korrupsionin “e vogël” edhe atë “të madh”, si dhe “kapjen” e shtetit nga interesa private apo të elitës së shoqërisë. Indeksi i Korrupsionit i llogaritur nga Banka Botërore paraqet renditjen në përqindje. Edhe në këtë rast sa më e lartë renditja, aq më pak i korruptuar perceptohet vendi përkatës.

3. Efektet e korrupsionit

Korrupsioni ndikon mbi të gjitha vendet: si vendet e zhvilluara ashtu edhe ato në zhvillim. Ai ndikon në të gjithë sektorët ekonomikë dhe të gjitha nivelet e qeverisjes. Shpesh konsiderohet si një taksë e fshehtë. Prandaj e gjithë popullata e një vendi preket direkt ose indirekt nga procedurat dhe veprimet korruptive. Zakonisht në literaturë efektet e korrupsionit studiohen në tre fusha: në ekonomi, në politikë dhe në jetën shoqërore.

Efkti ekonomik

Efkti ekonomik është edhe efekti më i prekshëm i korrupsionit,

7 Transparency International database dhe World Bank database

sepse ai ndikon direkt si në ekonominë e vendit edhe në jetën e individit. Korrupsioni ka një efekt negativ në zhvillimin e ekonomisë së tregut. Sipas literaturës, korrupsioni tenton të ulë rritjen ekonomike të një vendi. Ai shtrembëron procesin e vendim-marrjes dhe funksionimin e tregjeve të lira. Korrupsioni ekonomik nxit formimin e një grupi të privilegjuar njerëzish për shkak të pozicioneve monopol që ata kanë apo krijojnë në sipërmarrje private apo publike, duke minuar kështu themelet e ekonomisë së tregut të lirë. Praktikrat korruptuese ekonomike si rryshfetet për të filluar një biznes, vonesat e pajustificuara, procedurat e stërzgjatura burokratike dhe privilegjet e padrejta ndikojnë negativisht në konkurrencën e lirë dhe të ndershme midis operatorëve ekonomikë në treg. Si rezultat i një konkurrence më të ulët, në treg do ketë më pak mallra dhe do ofrohen më pak shërbime që do të sjellë rritjen e çmimeve. Të hyrat publike do të ulen, do të zhvillohet ekonomia informale, niveli i besimit të publikut do të ulet dhe si rezultat investimet e huaja do të ulen. Të gjitha këto do të frenojnë zhvillimin ekonomik të vendit dhe madje mund të sjellin dhe ngadalësin apo ulje të rritjes ekonomike. Më hollësisht për efektin ekonomik të korrupsionit do të shkruhet në seksionin pasardhës.

Efkti politik

Qytetarët e konsiderojnë korrupsionin si një dukuri normale sepse praktikrat korruptive shfaqen në çdo aspekt të veprimtarisë së shtetit. Qytetarët e përdorin atë si një mënyrë për të zgjidhur shpejt problemet e tyre, pa e kuptuar se edhe vetë ata përfshihen në veprime korruptuese. Në këtë mënyrë veprimet e tyre sjellin dhe nxisin korrupsionin. Nëse kjo dukuri shoqërohet me procedura burokratike, paaftësi profesionale dhe neglizhencë shtetërore, korrupsioni do të jetë shkak kryesor që qytetarët të humbin besimin tek autoritetet shtetërore. Për më tepër, qytetarët inënvlerësojnë zyrtarët publikë duke u shprehur negativisht për ta dhe duke mosrespektuar politikanët e tyre. Sipas perceptimeve të qytetarëve shqiptarë, politikanët konsiderohen si njerëzit më të korruptuar në Shqipëri. Sistemi i drejtësisë konsiderohet sektori më i korruptuar. Humbja e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë e dëmton shumë demokracinë e re të vendosur në Shqipëri, sepse shkel të drejtat kryesore dhe lirinë e individit, si edhe shtetin e të drejtës.

Efekti social

Korrupsioni ndikon edhe në mirëqënien e anëtarëve të shoqërisë së një vendi. Lidhur me aspektin social të korrupsionit, perceptimi i qytetarëve rreth korrupsionit përbën një çështje të rëndësishme sepse lidhet ngushtë me gjendjen ekonomike të tyre. Korrupsioni ul standardin e jetesës së pjesës më të madhe të popullsisë së një vendi sepse numri i personave që përfitojnë nga korrupsioni është shumë më i vogël se pjesa tjetër e popullatës. Ulja e të ardhurave çon në reduktimin e standartit të jetesës së qytetarëve. Prandaj korrupsioni ndikon negativisht në pabarazinë shoqërore. Përderisa veprimet korruptive përbëjnë një akt kriminal, korrupsioni ndikon edhe në rritjen e aktivitetit kriminal të një vendi. Ai e shfaq veten nëpërmjet krimit dhe dhunës. Aktet e vazhdueshme të korrupsionit krijojnë një kulturë institucionale të korrupsionit dhe ulin besimin e popullatës tek institucionet publike.

4. Pasojat e korrupsionit në ekonomi

Studiues të vendeve të ndryshme kanë studiuar korrupsionin, si një nga faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të një vendi. Më poshtë renditen disa nga përfundimet kryesore lidhur me efektete korrupsionit nëekonomi. Pjesa më e madhe e literaturës konkludon se korrupsioni ka efekt negativ afatgjatë në rritjen ekonomike.

- Korrupsioni mund tëndikojë në formimin e kapitalit njerëzor, i cili është inputi më i rëndësishëm në procesin e prodhimit dhe transformimit që quhet zhvillim ekonomik.

Së pari korrupsioni dobëson administratën tatimore dhe mund tëçojë në evazion tatimor dhe përjashtime tatimore të dëmshme. Prandaj, në një sistem tatimor, sa më ilartë të jetë korrupsioni, aq më të ulta janë të hyrat dhe më të ulta janë burimet financiare për të siguruar shërbimet publike , përfshirë arsimimin e popullatës.

Së dyti korrupsioni rrit koston operative të qeverisë dhe në këtë mënyrë redukton burimet në dispozicion për përdorime të tjera, duke përfshirë financimin e programeve të shpenzimeve shoqërore qëështë i rëndësishëm për formimin e kapitalit njerëzor. Sipas analizës sasiore

të kryer nga Mauro Paolo (1998)⁸ shpenzimet publike në fushën e arsimit lidhen negativisht me nivelin e korrupsionit. Korrupsioni gjithashtu tenton të reduktojë efektivitetin e fondeve të dhëna nëpërmjet ndihmave dhe subvencioneve, që mund të sjellë efekte negative në zhvillim.

- Korrupsioni shpesh citohet si shkak kryesor i një mjedisi jo të mirë të të bërit biznes dhe uljes së investimeve. Korrupsioni krijon shumë pasiguri për kompanitë dhe investitorët. Ai vendos një taksë shtesë mbi çmimin, shpesh e vështirë për tu paralogaritur dhe shtrembëron preçeset normale të tregut kundrejt një kostoje që e paguajnë sipërmarrësit e ndershëm. Kompanitë që dëshirojnë të investojnë në një vend janë më të sigurt për vlefshmërinë e kontratave dhe vlerës së investimeve të tyre kur ka rregulla dhe rregullore të qarta dhe zbatimi i tyre është sistematik dhe transparent. Zbatimi i ligjit është thelbësor për një klimë të shëndetshme investimi, në mënyrë që korrupsioni të mos çënojë funksionimin e saj.

- Korrupsioni ka efekt disproporcional, që do të thotë që efektet e tij nuk ndihen në të njëjtën masë nga të gjitha subjektet ekonomike. Pasojat e tij ndihen më shumë nga familjet më të varfëra dhe nga firmat më të vogla. Individët e pasur paguajnë një pjesë (raport) më të vogël të të ardhurave të tyre në formën e taksave, ndërsa pjesa e popullsisë me më pak të ardhura ka më pak mundësi të përfitojë nga shërbimet dhe të mirat publike. Korporatat e mëdha ngrejnë barriera për hyrjen e firmave në treg, ndërsa ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë më pak mundësi për financim.

- Në vendet me korrupsion më të lartë shpenzimet dhe të ardhurat nga tatimet në raport me PBB janë më të ulta. Korrupsioni shoqërohet me manaxhim të dobët të financave publike dhe ofrim jo të përshtatshëm të të mirave publike. Korrupsioni nxit shmangien tatimore, duke rezultuar në një bazë më të vogël tatimore për mbledhjen e të hyrave qeveritare. Në vitin 2014 të ardhurat nga tatimet përbënin rreth 18,3 përqind të prodhimit të brendshëm bruto⁹. Korrupsioni devijon shpenzimet publike: mundëson kryerjen e tyre jo në interesin publik. Si rezultat do të ketë mungesë në sigurimin e shërbimeve dhe të mirave publike si infrastruktura për

8 Mauro, P. (1998), "Corruption: Causes, Consequences, and Agenda for Further Research," International Monetary Fund, Finance and Development.

9 INSTAT database

bizneset, arsimit dhe shëndetësia për individët.

- Korrupsioni ndikon edhe në efektivitetin e qeverisjes dhe administratës publike. Si rezultat i korrupsionit, marrja në punë e njerëzve kryhet në bazë të nepotizmit dhe rryshfetit dhe jo në bazë të meritës. Një gjë e tillë ul cilësinë e punës së institucioneve publike dhe krijohet njëadministratë e fryrë, e panevojshme, e cila rrit mundësinë e rryshfetit.

- Korrupsioni shoqërohet me investime më të ulta, çmime më të larta dhe barriera hyrjeje për firmat e biznesit. Korrupsioni kërcënon të drejtat mbi pronësinë dhe investimet, veçanërisht investimet e huaja direkte.

- Korrupsioni shoqërohet me nivel më të ulët të standartit të jetesës, nivel më të ulët arsimimi dhe me një pabarazi më të madhe shoqërore. Studimet tregojnëse pabarazia çon në një korrupsion më të madh për shkak të uljes së besimit. Uslaner (2011)¹⁰ sugjeron një rreth vicioz që e bën të vështirë korrupsionin të ndalohet: pabarazia sjell uljen e besimit, i cili sjell korrupsion, dhe për shkak të të cilit krijohet një pabarazi edhe më e madhe. Në këtë rast, nivelet e larta të pabarazisë dhe korrupsionit do të përforcojnë njëri tjetrin dhe nëse ato bëhen pjesë e kulturës së shoqërisë është e vështirë të ndalohen. Korrupsioni rrit pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave nëpërmjet rritjes më të ulët ekonomike, sistemit tatimor të padrejtë që favorizon pjesën me të ardhura të larta të popullsisë, programeve sociale të keqmanaxhuara dhe keqorientuara, shpenzime më të vogla shoqërore dhe mundësi të pabarabarta në arsim. Të gjitha këto pasoja kanë efekte afatgjata në ekonominë e një vendi.

5. Përfundime

Korrupsioni mbetet një problem shqetësues në Shqipëri, pavarësisht masave të marra nga qeveritë ndër vite. Korrupsioni ka efekt mbi financat publike, klimën investuese të një vendi si edhe në standardin e jetesës së popullatës. Sipas të dhënave të publikuara nga institucionet ndërkombëtare, Shqipëria renditet nëvendet që konsiderohen me korrupsion të lartë. Korrupsioni ndikon mbi kapacitetin afatgjatë të një vendi për të arritur potencialin e tij prodhues si rezultat i:

(1) uljes së efektivitetit të qeverisjes për shkak të uljes së bazës tatimore dhe shpenzimeve qeveritare joeficiente,

10 Uslaner M. Eric “*Corruption and Inequality*”, CESifo DICE Report 2/2011.

- (ii) uljes së investimeve, veçanërisht të investimeve të huaja direkte, meqë korrupsioni rrit koston dhe riskune të bërit biznes,
- (iii) keqmanaxhimit të financave publike,
- (iv) reduktimit dhe përkeqësimit të kapitalit njerëzor të një vendi, veçanërisht të pjesës më të varfër të popullsisë, të cilët nuk kanë mundësi të kurohen dhe të arsimohen
- (v) uljes së standartit të jetesës, për shkak të pabarazisë në ndarjen e të ardhurave dhe programeve sociale të keqmanaxhuara dhe keqorientuara.

Literatura

Ade, O. Babatunde H., and M. Awoniyi. *“Corruption, Foreign Direct Investment and Economic Growth in Nigeria: An Empirical Investigation.”* Journal of research in international business management 1.9 (2011).

Armstrong, David et al. *“Does lower corruption boost foreign inward investment for developing countries”*. PWC (2013).

World Bank, *“Governance in Albania: A way forward for compositeness, growth and European integration”*, June 2011.

World Bank, 2014 Report, Washington DC: World Bank.

World Bank, 2006, Governance and Anti-Corruption - Ways to Enhance the World Bank’s Impact, Evaluation brief.

IDRA, *“Korrupsioni në Shqipëri, perceptime dhe përvoja”*, 2004-2015

IDRA, *“Impunity – Perception and experience of Albanian citizens (2014-2015)”*.

Law No. 8635 (2000), *“On ratification of civil convention on corruption”*.

Law No. 9492, dated 13.3.2006, *“On ratification of the United Nations Convention Against Corruption”*.

Mankiw, N., D. Romer, and D.N. Weil (1992), *“A Contribution to the Empirics of Economic Growth,” Quarterly Journal of Economics*, Vol. 107.

Mauro, P. (1995), *“Corruption and Growth,” Quarterly Journal of Economics*, Vol. 110, No. 3.

Mauro, P. (1998), *“Corruption: Causes, Consequences, and Agenda for Further Research,”* International Monetary Fund, *Finance and Developmen.*

Moses Montesh, *“Conceptualizing Corruption: Forms, Causes, Types and consequences”*, Working paper No. 118, March 2009.

Olken A., *“Corruption in developing countries”*, MIT Rohini Pande, Harvard University August 201.

PACA, *“Education against corruption”*, Manual for teachers, Tirana, 2012.

Transparency International, Reports, 2015

U. Myint, *“Corruption: causes, consequences and cures”*, Asia-pacific development Journal, Vol 7, No. 2, 2000.

United Nations Office on drugs and crime, UN Anti-corruption Toolkit, 3rd Edition, Vienna, September 2004.

Uslaner M. Eric *“Corruption and Inequality”*, CESifo DICE Report 2/2011.

www.instat.gov.al

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA KEQTRAJTIMI NË PARASHIKIMET E KODIT PENAL SHQIPTAR

Marilda MENKSHI

(Doktorante në shkencat penale)

A- Keqtrajtimi i fëmijëve si koncept në raport me shfrytëzimin apo abuzimin e tyre.

Sipas Konventës mbi të Drejtat Fëmijës¹ neni 1 parashikon: *“Në këtë konvetë me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.”*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon një mbrojtje të veçantë nga shteti për fëmijët². Mbrojtja e fëmijëve ndër të tjera përfshin edhe mbrojtjen e tyre nga keqtrajtimi. Nëse i referohemi kuptimit që fjalori i gjuhës shqipe i jep këtij koncepti kemi këtë përcaktim KEQTRAJTOJ - *Sillem keq me dikë, e mendoj shumë, e trajtoj keq, keqpërdorj.*³ Sigurisht që ka një diferencë ndërmjet shfrytëzimit, abuzimit të fëmijëve dhe keqtrajtimit të tyre. Keqtrajtimi në raport me këto koncepte në vetvete përmban elementë të veçantë në raport me sjelljen kundrejt këtij target

1 Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Konventën më datë 26 Janar 1990 dhe e ka ratifikuar më datë 27.02.1992. Konventa ka hyrë në fuqi me 27.02.1992. Ligji ratifikues nuk gjendet i botuar në ndonjë Fletore Zyrtare të kohës. Botimi zyrtarisht i tekstit në gjuhën shqipe nuk gjendet në ndonjë akt zyrtar të kohës së ratifikimit. Në këtë Artikull do t'i referohemi tekstit të përkthyer autentikisht nga UNICEF, që aktualisht referohet edhe nga institucionet qendrore si tekst zyrtar i Konventës. Marrë nga Përmbledhje e Legjislacionit për fëmijët në RSH, 1992-2012, Tiranë 2012, botim i Qendrës së Informimit Publik, ÇIP, mbështetur nga UNICEF faqe 29.

2 Neni 54.

3 <http://www.fjalori.shkenca.org/>

grupi, por që në thelb të tri konceptet lidhen me sjellje të dëmshme për shëndetin fizik apo mendor të fëmijëve dhe mirërritjen e tyre.

Nëse flasim për shfrytëzim të të miturve kemi parasysh disa kategori shfrytëzimi. Këtu përfshihen shfrytëzimi ekonomik dhe kryerja e çdo lloj pune që paraqet rrezik ose cënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror. Në këtë këndvështrim edhe Konventa mbi të drejtat e fëmijës ka parashikim specifik për këtë lloj situatë shfrytëzimi⁴. Një kategori tjetër e shfrytëzimit të fëmijëve është edhe shfrytëzimi seksual dhe për këtë po garanci paraqiten edhe në Konvetë⁵ Pikërisht po në këtë nen të këtij akti del edhe një koncept tjetër, që është edhe keqtraktimi seksual i fëmijëve. Në këtë këndvështrim duhet të bëhet një diferencë ndërmjet veprimeve të shfrytëzimit dhe keqtrajtimit. Nëse i referohemi fjalorit të gjuhës shqipe **SHFRYTËZOJ** kal.

1. *Nxjerr fitime duke përvetësuar frytet e punës së të tjerëve. Borgjezia shfrytëzon klasën punëtore (proletariatit, gratë, fëmijët). Shfrytëzojnë punën e të miturve. Shfrytëzojnë pa mëshirë (egërsisht, gjer në palcë).*

2. *Nënshtroj ekonomikisht e politikisht një vend tjetër për të nxjerrë prej tij përfitime sa më të mëdha. Shfrytëzojnë kolonitë (vendet e vogla).*

3. *Shtie në punë diçka, e përdor për një qëllim të caktuar; përdor të mira të ndryshme materiale për plotësimin e disa synimeve ekonomike; nuk e lë të shkojë kot, e përdor mirë e plotësisht. Shfrytëzojnë makinat (makineritë, pajisjet). Shfrytëzuan mbeturinat (rezervat e brendshme). Shfrytëzojnë hekurudhat (mjetet e transportit). Shfrytëzojnë burimet ekonomike (energjinë e lumenjve, energjinë diellore, energjinë atomike). Shfrytëzojnë ujin e lumenjve për ujitje. Shfrytëzoj librat (dokumentet, arkivat, literaturën, kartotekën). Shfrytëzon plotësisht kohën e punës. Shfrytëzon çdo minutë.*

4. *Përdor diçka në dobinë time, përfitoj, nxjerr përfitime nga dikush a nga diçka; e përdor për punën time. Shfrytëzoj një të drejtë. Shfrytëzoj rastin (situatën). Shfrytëzon dobësitë (mirëbesimin, papjekurinë) e dikujt. Shfrytëzoj kohën e mirë (ditët me diell). Shfrytëzuan errësirën e natës.*

4 Neni 32 i Konventës

5 Neni 43 i Konvetës.

*5. min. Nxjerr nga toka minerale të ndryshme, naftë etj. Shfrytëzojnë minierat. Shfrytëzojnë pasuritë e nëntokës. Shfrytëzojnë pusët e naftës.*⁶

Shfrytëzimi i fëmijëve duke e lidhur me shpjegimet gjuhësore lidhet me përdorimin e fëmijës nga subjektet madhorë të së drejtës, për qëllime të caktuara që nuk lidhen në asnjë rast me interesin më të lartë të fëmijëve.

Ndërsa keqtrajtimi nuk është domosdoshmërisht i lidhur me ndonjë qëllim të posaçëm përfitimi por mjafton cilado sjellje e keqe karshi fëmijës, apo veprime keqdashëse kundrejt tij, shkaktimi i mundimeve, dhimbjeve fizike apo psikologjike apo të përdoret aftësitë e tij në dëm të interesit të fëmijës dhe mirërrijtes së tij, pa qenë nevoja e nxjerrjes së ndonjë përfitimi nga të tretë.

Ndërsa shfrytëzimi mund të mos ketë domosdoshmërisht pasoja të drejtpërdrejta në shëndetin e fëmijës, por mund të marrë edhe sfumatura të tjera si shfrytëzim i fëmijëve të talentuar apo me prirje, apo shfrytëzimi i tyre në media, apo si rezultat i kërkimeve ose eksperimenteve në mjekësi apo shkencë⁷. Ndërsa nëse i referohemi konceptit keqtrajtimit kemi parasysh gjithnjë vetëm sjellje që pasjellin dëmtime në shëndetin fizik apo psikologjik të fëmijës.

Koncepti abuzim në përcaktimet gjuhësore shfaqet si nocion hera herës sinonim me shpërdorimin, por ka edhe një konotacion të tejkalimit të masës apo të të drejtës që i përket. Në këtë këndvështrim edhe në kontekstin e abuzimit me fëmijët parashihet edhe në nenet e Konventës dhe në interpretimet e manualeve apo studimeve krahasimore si ekuivalent shpeshherë me abuzimet fizike, seksuale dhe jo vetëm të fëmijëve dhe jo vetëm thjesht si keqtrajtimit⁸.

6 <http://www.fjalori.shkenca.org/>© 2012 Shkenca.org . Fjalor i gjuhës së sotme Shqipe me rreth 40000 fjalë,

7 Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të drejtave të fëmijës, Studim Krahasues botim i QLSHPI në mbështetje të projektit të përbashkët Fuqizimi Institucional i Nën-Seksionit Për të Drejtat e Fëmijëve, midis Avokatit të Popullit dhe Save the Children me përkrahjen dhe mbështetjen e SIDA. fq. 349-355.

8 Legjislacioni shqiptar dhe Konventa e të drejtave të fëmijës, Studim Krahasues botim i QLSHPI në mbështetje të projektit të përbashkët Fuqizimi

B- Kodi Penal si garanci për mbrojtjen e fëmijëve nga Keqtrajtimi.

Duke qenë se format e sjelljeve të njerëzve të rritur në tejkalim të interesit më të lartë të fëmijëve ndryshojnë, ashtu si evaluon edhe shoqëria, atëhere edhe legjislacioni penal duhet të përshtatet me të tilla ndryshime. Gjendjet e faktit dhe veprimet që çenojnë integritetin fizik, psikologjik e moral të fëmijëve duhet të parandalohen apo edhe të ndëshkohen në mënyrë që të sigurohet ky grup vulnerabel. Kodi Penal shqiptar ka parashikuar një seri veprash penale për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi apo abuzimi. Këtu mund të përmendim seksionin e veçantë IX ku parashihen *Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes*. Pikërisht këtu përfshihen ato veprime apo mosveprime të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme që çenojnë të drejtat e fëmijëve të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së SHqipërisë dhe ligjet në fuqi, të kryera me faj dhe që parashikohen nga legjislacioni penal.⁹ Po kështu edhe në parashikime specifike (dispozita) të po këtij Kodi shfaqet një mbrojtje e posaçme edhe për seksualitetin e të miturit ende të pa formuar plotësisht në kuptimin e tij nga shfrytëzimi si në marrëdhëniet seksuale apo ato homoseksuale¹⁰. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe mbrojtjes nga trafikimi, shfrytëzimi për prostitucion, rrëmbimi apo mbajtja peng, pornografia apo përdorimi i drogave¹¹.

Megjithatë legjislatori, nëpërmjet inisiativës së deputeteve jo pa të drejtë ka avancuar duke përfshirë në seksionin IX, në nenin 124/b edhe veprën penale të Keqtrajtimit të të miturve¹².

Sipas këtij neni “*Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.*”

Institucional i Nën-Seksionit Për të Drejtat e Fëmijëve, midis Avokatit të Popullit dhe Save the Children me përkrahjen dhe mbështetjen e SIDA. fq. 321.

9 Elezi I, E Drejta Penale pjesa e posaçme ,fq 164.

10 Nenet 100, 101, 106, 108, të Kodit Penal

11 Nenet 109, 114/a, 117, 128/b, 129, 286 të Kodit Penal.

12 Shtuar me ligjin nr. 9859, dt. 21.01.2008.

Detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime, që dëmtojnë zhvillimin e tij dënohet me burgim deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion lekë.

Kur nga vepra është shkaktuar dëmtim i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri njëzet vjet”.

Por me ligjin nr.144/2013 kjo dispozitë(paragrafi i dytë) ka ndryshuar si vijon “*Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”.*

Në këto parashikime objekti i veprës penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar të miturit nën 18 vjeç, nga keqtrajtimet fizike apo psikologjike. Gjithashtu për të garantuar jetën, shëndetin, moralin dhe zhvillimin e mirërritjen e tyre nga veprimet kriminale. Në fakt ky nen emërtohet keqtrajtim, kur në brendi të tij përfshin forma të veçanta të shfrytëzimit të fëmijëve, siç janë ato të shfrytëzimit të punës së tyre. Në këtë këndvështrim shteti shqiptar ka marrë një masë shtesë në legjisllacionin e tij, në respektim dhe reflektim edhe të nenit 32 të Konventës për Të Drejtat e Fëmijës, ku detyrohen shtetet palë për të mbrojtur fëmijët nga çdo lloj shfrytëzimi ekonomik, nga kryerja e çdo lloj pune që paraqet rreziqe ose që çënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor shpirtëror, moral e shoqëror. Emërtimi i këtij neni në Konventë është *Fëmijët në situatë shfrytëzimi*. Parë në këtë këndvështrim legjisllatori ndoshta duhet ta ndante këtë nen në dy parashikime specifike, në njërin të bëhej fjalë vetëm për Keqtrajtimin e fëmijëve, ndërsa paragrafin e dytë mund të emërtohej si neni 124/c *Shfrytëzime në forma të tjera të miturit*.

Nga ana objektive vepra e parashikuar në Kodin Penal si Keqtrajtim i të miturit (neni 124/b) kryhet me veprime konkrete aktive apo mosveprime të atilla që shkaktojnë dëmtime fizike apo psikologjike ndaj fëmijës . Në këto raste kjo vepër mund të konkurojë me veprën penale të dhunës në familje (neni 130/a) në ato raste kur ushtrohet nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja. Megjithatë në rastin kur veprimet konkretizohen si akte që lidhen me keqtrajtim fizik apo psikologjik duhet të cilësohen si të tilla, pra sipas nenit 124/b dhe jo sipas nenit 130/a. Nëse i referohemi

praktikës në organet proceduese apo gjyqësore më tepër haset rasti i procedimeve për dhunë në familje edhe kur të keqtrajtuar janë fëmijët, pra mos përdorimi i nenit 124/b. Psh në një rast në qytetin e Korçës ku nëna ka keqtrajtuar fëmijën, me ankim të rastit tek njësia Për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Bashkisë Korçë, kjo e fundit me vënien në dijeni të rastit ka referuar këtë rast në Prokurorinë Korce si dhunë në familje dhe jo si keqtrajtim të fëmijës. Nëna në mënyrë të vazhdueshme godiste me mjete të forta fëmijën e saj të mitur duke i shkaktuar ekimoza dhe hematoma në pjesë të ndryshme të trupit të kostatuara edhe nga punonjëset e bashkisë dhe të reklamuar edhe nga fëmija në rrefimin e tij në prezencë edhe të psikologes. Gjithashtu shkaku i kësaj dhune sipas rrëfimeve të fëmijës në prani të psikologes ka qenë mos realizimi i të ardhurave prej fëmijës nga lypja¹³. Në të tilla kushte mendojmë se organi procedues pavarësisht kallëzimit, pas një hetimi të plotë e të gjithanshëm duhet të kualifikojë si duhet veprimet kriminale të nënës ndaj fëmijës. Në këto kushte kur kemi të bëjmë me një parashikim ligjor të ri, që ka pësuar edhe ndryshime jo me ligjin nr 23/2012, por edhe me ligjin nr.144/2013 si amendim i ligjit nr.9859, datë 21.1.2008, në neni 2 është specifikuar rrethi i subjekteve që mbajnë përgjegjësi dhe që janë subjekt i posaçëm. Megjithatë ky parashikim ka nevojë për një njohje më të thelluar dhe diskutime edhe në nivel të praktikienëve të së drejtës për një unifikim të praktikës dhe zbatim korrekt të ligjit, për të pasjellë pasojat më të mira të mundshme parandaluese ndaj keqtrajtimit të fëmijëve. Nga ana subjektive, sigurisht që kemi të bëjmë me veprime të kryera me dashje të drejtperdrejtë, ndërsa sa i perket pasojave ato mund të kenë ardhur edhe me dashje indirekte apo edhe nga pakujdesia.

Nëse diskutojmë për paragrafin e dytë të nenit 124/b të Kodit tonë Penal ku parashikohet detyrimi për të punuar i fëmijës, për të siguruar të ardhura, etj kemi një parashikim që konvergon edhe me instrumentat ndërkombëtarë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (neni 4); ku ndalohet puna e detyruar¹⁴, Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile

13 Kallëzim i depozituar nga Njësia për mbrojtjen e fëmijëve pranë Bashkisë Korçë, në muajin maj 2016 pranë Prokurorisë Korçë.

14 KEDNJ 4/11/1950, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr 8137, dt 31.07.1996, fletore zyrtare nr 20, gusht 1996,

dhe politike (neni 24); ku parashikohet e drejta e fëmijëve pa diskriminim race, ngjyre, seks, gjuhë, feje, origjine etnike ose sociale, pasurie për të patur të drejtën të përfitojnë nga ana e familjes së tyre, shoqërisë dhe shtetit, masa mbrojtëse që kërkon moshë e tyre minore¹⁵. Po kështu edhe në përputhje me Paktin ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore ku përfshihet e drejta e arsimimit, të punës (nenet 6, 7, 13) si dhe detyrimin e shteteve palë për marrjen e masave mbrojtëse speciale për fëmijët dhe adoleshentët janë parashikimet e Kodit Penal aktual. Ky Pakt parashikon se ligjet kombëtare duhet të ndalojnë punët që vënë në rrezik moralin, shëndetin apo jetën e fëmijëve si dhe duhet të përcaktojnë limitet e moshës ku puna e fëmijëve është e daluar (neni 10).¹⁶Gjithashtu legjilacioni penal në parashikimin e tij në nenin 124/b, paragrafi i dytë ka parasysh edhe “Kartën Sociale Evropiane” të Këshillit të Evropës 18 dhjetor 1961, neni 7, lidhur me detyrimet e shteteve palë në raport me moshën e punës, kohëzgjatjen dhe ndalesat për fëmijët¹⁷. Mbahen parasysh në aplikimet e legjislacionit penal kombëtar dhe parashikimet e standarteve të Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Konventa dhe rekomandimet, përkatësisht konventa nr. 182 “Për Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve” 1999¹⁸, Deklarata për “Parimet Themelore dhe të Drejtat në punë” ku parasheh zhdukjen e cdo lloj pune të fëmijëve, Konventa nr. 138 për moshën minimale të punësimit¹⁹. Megjithatë neni 124/b i Kodit Penal parasheh edhe përdorimin e fëmijëve në veprimtari të tjera për të siguruar të ardhura, ku mund të përfshihet edhe keqpërdorimi i talenteve të tyre, për të siguruar të ardhura që nuk shkojnë në favor të mirërritjes së tyre. Një formë tjetër parashikon dhe lypjen që është tepër e përhapur edhe në vendin tonë.

15 Adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 16.12.1966, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr 7510, dt. 08.08.1991, fletore zyrtare nr 6, gusht 1991.

16 Adaptuar nga OKB më 16.12.1966, ratifikuar me ligjin nr 7511 dt 08.08.1991 fletore zyrtare nr 6, gusht 1991

17 Ratifikuar nga Shqipëria me ligjin 8960 dt 24.10.2002 fletore zyrtare 75, dt dhjetor 2002.

18 Ratifikuar me ligjin 8774, dt 23.04.2001, fletore zyrtare 64, dhjetor 2001

19 Ligji 8086, dt 13.03.1996 fletore zyrtare 6, prill 1996

Megjithatë praktika gjyqësore dhe ajo e organit të prokurorisë lënë shumë për të dëshiruar në aplikueshmërië e këtij neni (124/b i Kodit Penal), sepse parashikimet ligjore penale ekzistojnë të plota dhe të sakta, por nuk ka dënueshmëri apo më sakte procedim të personave përgjegjës, qofshin këta edhe të afërm (prindër, motra vëllezër apo kujdestarë ligjorë) të fëmijëve. Në identifikimin e viktimave të këtyre krimeve ekziston një vështirësi, pasi të dhënat për këto vepra dhe për çfarëdolloj vepra ku janë viktimë fëmijët nuk ka zyrtarisht statistika të veçanta, pasi ato paraqiten të pandara në numrin e përgjithshëm të krimeve.²⁰ Në më të shumtët e rasteve keqtrajtimit kualifikohen si dhunë në familje dhe nga statistikat e studimeve kundër dhunës në familje në Shqipëri, të kryera nga UNICEF për vitet 2004-2005 rezulton se dhuna me tepër ushtrohet nga nëna, por më me ashpërsi nga babai.²¹ Sigurisht që edhe nga pikpamja sociale kjo lloj veprë e keqtrajtimit të fëmijëve apo e përdorimit të tyre për punë dhe jo vetëm, lidhet me mendësinë që ekziston akoma në familjet shqiptare për fëmijët si “pronë”, me krizat për shkak të divorceve apo kushteve tepër të vështira ekonomike, por kjo në asnjë rast këto situatë nuk duhet të justifikojnë cënimin e të drejtës së tyre për mirëritje, edukim dhe zhvillim normal si gjithë bashkëmoshatarët e tyre në vendet e tjera evropiane. Në këto kushte mund të themi se po bëhen hapa pozitive edhe në fushën e përmirësimit të legjislacionit vendas, për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë të fëmijëve. Por duhet më shumë vëmendje në organizmat ligjzbatuese, për të realizuar drejtësinë, sepse ajo është e pamjaftueshme vetëm kur shkruhet.

C- Konkluzione

Mbrojtja e fëmijëve nga keqtrajtimi dhe jo vetëm vijon të jetë sfida e shoqërisë shqiptare, kjo edhe për shkak të gjendjes së saj tranzitore në këto 25 vite, ku mentaliteti i prapambetur i familjeve shqiptare ende mbizotëron dhe e bën të vështirë pranimin e të drejtave të fëmijëve. Jo vetëm për këtë arsye, por familjet shqiptare kanë edhe vështirësi të theksura ekonomike, që pengojnë realizimin fakti të të drejtave të fëmijëve.

20 Prof. Dr. Hysi V. Kriminologjia, botim 2010. fq 251.

21 Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri UNICEF, Tiranë fq 7-9.

Veç këtyre shkaqeve edhe divorcet janë shtuar dhe të gjithë këto shkaqe sigurisht influencojnë edhe në sjelljet prindërore dhe të të afërmëve të tjerë apo të personave që janë ngarkuar ligjërisht me përkujdesen ndaj fëmijëve.

Në këto kushte nuk është e nevojshme dhe e mjaftueshme vetëm ndërhyrja legislative, por duhen ndërmarrë edhe më tepër fushata ndërgjegjësuere për familjet shqiptare, në veçanti për prindërit për të kuptuar më thellë marrëdhëniet prind fëmijë si dhe të drejtat e këtyre të fundit ,por edhe për të sqaruar edhe penalitetet ligjore në rast të cënimit të integritetit fizik apo psikologjik si dhe mirërritjen e fëmijës.

Ndonëse është bërë një punë mjaft e mirë me krijimin e strukturave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pranë organeve të Qeverisjes Vendore, megjithatë duhet të vijojnë trajnimet me stafin e tyre për njohjen e legjislacionit penal dhe jo vetëm, në këndvështrimin e dhunës në familje apo keqtrajtimit të fëmijëve. Pranë këtyre strukturave mund të atashohen edhe jurist, me qëllim realizimin e të drejtave ligjore dhe mbrojtjen sa më efikase të fëmijëve.

Nga pikpamja e legjislacionit penal lidhur me veprën penale të keqtrajtimit të fëmijëve mendojmë se Legjislacioni penal, përkatësisht parashikimet e nenit 124/b duket të marrin një emërtim më të zgjeruar, duke mos u cilësuar vetëm Keqtrajtim i të miturit, por mund të shtohet edhe *forma të tjera të shfrytëzimit të të miturve*. Ose një mundësi tjetër mund të jetë edhe diferencimi I paragrafit të parë dhë të dytë,në dy nene më vete, me emërtime të ndryshme. Sigurisht në të dy rastet duhet të ruhet paragrafi i rrethanave të cilësuar që lidhen me pasojat e rënda.

REFERENCA

Elezi. I *E drejta Penale Pjesa e posaçme*, Tiranë 2010,

Hysi. V *Kriminologjia* ,Tiranë 2010.

Legjislacioni shqiptar dhe Konveta e të drejtave të fëmijës, Studim Krahasues botim i QLSHPI në mbështetje të projektit të përbashkët Fuqizimi Institucional i Nën-Seksionit Për të Drejtat e Fëmijëve, midis Avokatit të Popullit dhe Save the Children me përkrahjen dhe mbështetjen e SIDA.

Përmbledhje e Legjislacionit për Fëmijë në Republikën e Shqipërisë 1992-2011, botim i Qendrës për Çështjet e Informimit Publik, mbështetur nga UNICEF Tiranë 2012.

Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri UNICEF, Tiranë 2005

Pradel, J; Corstens, G; Vermeulen, G.: *E Drejta Penale Evropiane*, Papirus, 2010.

Frank E.Hagan.: *Introduction to Criminology, Theories, Methods, and Criminal Behavior*. Second Edition, Nelson-Hall Chicago 1993

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut 4 /11/1950, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr 8137, dt 31.07.1996, fletore zyrtare nr 20 , gusht 1996,

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, 20 Nëntor 1989

Kushtetuta e RSH.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

Kodi Penal i RSH

Konventa nr 182 “Për Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve” viti 1999. Ratifikuar me ligjin 8774 dt 23.04.2001, fletore zyrtare 64, dhjetor 2001

Karta Sociale Evropiane e Këshillit të Evropës 18 dhjetor 1961.

Deklarata për Parimet Themelore dhe të Drejtat në punë.

Paktin ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, Aprovuar nga OKB më 16.12.1966, ratifikuar me ligjin nr 7511 dt 08.08.1991 fletore zyrtare nr 6, gusht 1991

Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike, Aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 16.12.1966, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr 7510 dt. 08.08.1991, fletore zyrtare nr 6, gusht 1991.

Konventa nr. 138 “Për moshën minimale të punësimit” ratifikuar me Ligji 8086 dt 13.03.1996 fletore zyrtare 6, prill 1996

<http://www.fjalori.shkenca.org/>© 2012 Shkenca.org . Fjalor i gjuhës së sotme Shqipe me rreth 40000 fjalë,

PËRDORIMI I GJUHËS SHQIPE NË TEKNIKËN LEGJISLATIVE

Oljana PAPA¹

Hyrje

Që me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar është bërë një perpjekje e vazhdueshme për përdorimin e gjuhës shqipe në hartimin e teksteve ligjore, shkresave apo akteve zyrtare. Por përdorimi i saj ka paraqitur vështirësi, pasi në fillimet e ekzistencës së shtetit shqiptar, specialistët dhe kuadrot e së drejtës kanë qenë specializuar kryesisht vetëm në përdorimin e gjuhës osmane. Është e kuptueshme që ka pasur vështirësi në kalimin në një gjuhë tjetër, pavarësisht se ajo ishte gjuha amtare.

Kjo problematikë që është shfaqur lidhet edhe me faktin që standardizimi i gjuhës shqipe filloi me vonesë. Kështu vetëm në vitin 1908 në Kongresin e Manastirit u pranua një alfabet i unifikuar për gjuhën shqipe. Këto zhvillime në gjuhën shqipe vetiu kanë sjellë edhe vonesa në zhvillimin e një terminologjie në fushën e drejtësisë.

Pavarësisht këtyre vështirësive rezulton që në hartimin e akteve të para, hartuesit ligjorë shqiptarë janë përpjekur që të hartojnë akte ligjore duke përdorur terma në gjuhën shqipe. Një shembull i tillë është “Kanuni i Jurisë”, miratuar nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës me 10 maj 1913.² Ky akt ligjor përmbante, për aq sa ishte e mundur, një terminologji në gjuhën shqipe duke synuar zëvendësimin e termave të huaj. Kjo vihet sidomos në përdorimin e termave *vajtori* dhe *nëngjyqësi* që përdoreshin respektivisht për të akuzuarin ose të pandehurin.³

1 Doktorante, Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës.

2 “Kanoni Zhurisë”, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Korrik 2009.

3 Anastasi, Aurela, “Historia e së Drejtës Kushtetuese në Shqipëri, 1912-1939”, Shtëpia Botuese “Pegi”, Tiranë 2007, fq.35.

Gjatë pushtimit austro-hungraz të vendit tonë në Luftën e Parë Botërore, austriakët i detyruan organet e drejtësisë që të gjitha veprimet t'i kryenin në gjuhën shqipe me qëllim që të përdorej në të gjitha veprimet zyrtare dhe për këtë arsye u dhanë një afat prej 6 muaj gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve që të mësonin të lexonin dhe të shkruanin në gjuhën shqipe.⁴ Por një detyrë e tillë rezultoi e vështirë dhe gjyqtarët përgjithësisht ndihmoheshin nga sekretarët që nën orientimin dhe diktimin e gjyqtarëve kryenin veprimet procedurale dhe arsyetonin vendimet në gjuhën shqipe.⁵

Me fillimin e hartimit të një legjislacioni modern shqiptar, gjatë fundit të viteve '20 dhe gjatë viteve '30 të shek. XX, kemi edhe përpjekjet për hartimin e një legjislacioni të mirëfilltë në gjuhën shqipe. Për t'u shkëputur nga e kaluara osmane, hartimi i akteve i'u besua kryesisht ekspertëve të huaj perëndimore (kryesisht italianë) si edhe juristëve shqiptarë që kishin përfunduar studimet për drejtësi jashtë vendit, në vendet perëndimore, përsëri kryesisht në Itali. Përdorimi i këtij grupimi juristësh, megjithëse filloi të sillte një shkëputje nga tradita osmane krijoi që tjetër problematikë në përdorimin e gjuhës shqipe në terminologjinë juridike. Shpesh herë në këto raste për juristët e rinj, si dhe për ligjvënësin shqiptar, duket se kishte një rëndësi të madhe përdorimi edhe i termave të huaj. Në përgjithësi kjo teknikë e hartimit të akteve të reja ligjore konsistonte në përdorimin e termave shqip në tekstin juridik, e shoqëruar në kllapa me termin e huaj. Me pas mund të ndodhte që përmendej vetëm termi i huaj i pa shoqëruar me termin ekuivalent në gjuhën shqipe.

Për ta ilustruar si rast po i referohemi si shembull aktit juridik "Dispozitat për interpretimin dhe aplikimin e ligjave përgjithësisht" që shoqëronte Kodin Civil të vitit 1929. Kështu në nenin 2, paragrafi i parë thuhet: "*N'aplikim, ligjave nuk munt t'u epet tjetër sens veç atij që del qartazi nga kuptimi vet i fjalëve tue u marrë parasysh lidhja (connexion) e tyne, si dhe nga qëllimi i ligjëvuesit*". Në këtë rast duket qartazi zgjedhja

4 Noçka, Irakli, "Gjyqtarët e Shqipërisë gjatë gjysëm shekulli", botuar në Revistën "Drejtësia Popullore" nr.5 e vitit 1962, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, fq.35.

5 Noçka, Irakli, "Gjyqtarët e Shqipërisë gjatë gjysëm shekulli", botuar në Revistën "Drejtësia Popullore" nr.5 e vitit 1962, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, fq.36.

e bërë, duke vendosur fjalën në shqip e shoqëruar me termin e njejtë në gjuhë të huaj në kllapa. E njëjta situatë përsëritet edhe në nenin 5 sipas së cilit “*Gjendja (état) dhe zotësia (capacité) e personave dhe marrëdhënjet (raports) familiare rregullohen sipas ligjës së shtetit t’atyne personave.*” Një tjetër shembull është përdorimi në pjesën e trashëgimisë që rregullonte Kodin Civil i termit “*de cuius*” për trashëgimtarin, etj.

Përdorimi i këtyre termave në atë kohë ndoshta lidhet edhe me dëshirën e hartuesve për të treguar kulturën e tyre perëndimore por nga njëra anë tregon edhe vështirësinë e krijimit dhe të konsolidimit të termave juridikë në gjuhën shqipe.

Mbas çlirimit të vendit pati përpjekje serioze për zhvillimin e shkencës së gjuhës shqipe e cila synonte pasurimin e saj dhe pastrimin nga termat e huaj. Në këtë drejtim u punua edhe në fushën e terminologjisë juridike në gjuhën shqipe. Por, në mënyrë të kuptueshme ndaj këtyre përpjekjeve pati edhe një lloj rezistence pasi terminologjia profesionale e një fushe është e vështirë që të ndryshohet dhe të përshtatet.

Përveç gjuhëtarëve, përpjekje për pasurimin e gjuhës shqipe pati edhe nga rradhët e akademikëve të fushës juridike të cilat kanë botuar edhe disa artikuj shkencorë. Këtu po përmendim autorin Andrea Nathanaili, i cili në artikullin e tij “*Çështje terminologjie juridike*”, është përpjekur që disa terma të huaj juridikë të huaj, t’i përshtasë në gjuhën shqipe. Me konkretisht sipas këtij autori fjalët *zotërim* dhe *zotruës* duhet të zëvendësoheshin nga fjalët *pronë*, *pronësi* dhe *pronar*. Po kështu në vend të termave *ent* dhe *dikaster* duhej të përdorej termat *institucion* dhe *ministri*. Një tjetër sugjerim i autorit ishte edhe zëvendësimi i termit *administrata* me termat e tjerë, *institute*, *ndërmarrje*, *organizata*, *Këshilli i Ministrave*, *Ministrija*, *Komiteti Ekzekutiv*, *Instituti i Shkencave* etj, terma këto që do të përdoreheshin sipas rasti dhe llojit të institucionit që i drejtoheshin. Së fundmi autori sugjeron që në vend të fjalës *instrukcione* të përdorej fjala *udhëzim*.⁶

Një tjetër studiuës që ka trajtuar problemet e terminologjisë juridike është edhe autori Vangjel Meksi ku në artikullin e tij “*Për një*

6 Nathanaili, Andrea, “Çështje terminologjie juridike”, botuar në Revistën “Drejtësia Popullore” nr.4 e vitit 1951, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, fq.44-58.

terminologji më të saktë juridike shqipe”, ka sugjeruar zëvendësimin e disa termave juridike me prejardhje të huaj në gjuhën shqipe. Më konkretisht ai sugjeron zëvendësimin e termave në këtë mënyrë: *abstenim* dhe *abstenoj* me termat *shmangie, shmangem*; *Abrogim* dhe *abrogoj* me termat *rënë nga fuqia, lënie pa fuqi, shfuqizuar*; *Afat* me termin *kohë*; *Akcedim* dhe *aksesor* me termin *i shtuar*; *Akt* me termat *veprim, shkresë*; *Alibi* me termin *ngetai*,⁷ *gjetiu, gjetkë*; *Aprovim* dhe *aprovoj* me termat *pëlqim, pëlqej* dhe *miratoj*; *Abdikim* dhe *abdikoj* me termin *dorëheqje*, por autori pranon veçantinë e këtij termi në rastin e heqjes dorë të një mbreti nga drejtimi i mbretërisë; *Definitiv* me termat *përfundimtar, i prerë*; *Dekadencë* me termin *bjerrë*. *Depozitë* me termin *ndorëje*,⁸ *Derogim, derogoj* me termat *largim, largohem*; *Debitor, kreditor* me termat *Detores*⁹ ose *detuar*¹⁰ dhe *besonjës*; *Dikaster* me termin *institucion*; *Interpretim* me termin *shpjegim*; *Juridik* me termin *ligjor, i se drejtës*; *Kapitull* me termin *Kre*,¹¹ *Kompensim* me termin *bashkëpeshim* ose *bashkënjësim*; *Parashkrim* me termin *kalimkohe*; *Posedim* me termin *nëndorësi*.

Një pjesë e këtyre termave të rinjë zunë vend në terminologjinë juridike shqiptare kurse një pjesë tjetër jo. Madje pati edhe kundërshtime në lidhje me përdorimin e këtyre termave të rinjë.¹²

Puna e vazhdueshme në këtë drejtim solli pasurimin e terminologjisë juridike profesionale në gjuhën shqipe. Por nga ana tjetër, mbas ndryshimeve demokratike të viteve '90 të shek. XX, filloi edhe një tjetër proces, ai i hartimit të një legjislacioni të ri dhe modern, që të rregullonte marrdhënie të reja shoqërore, bazuar në shtetin e së drejtës dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

7 Autori në këtë rast i referohet veprës së Frang Bardhit “*Dictionarium Latino-epiroticum*”, Romë 1635.

8 Autori në këtë rast i referohet veprës së Konstandin Kristoforidhit “Fjalori i Gjuhës Shqipe”, Athinë 1904.

9 Sipas fjalorit të Frang Bardhit.

10 Sipas fjalorit të Konstandin Kristoforidhit

11 Edhe sipas fjalorit të Konstandin Kristoforidhit

12 Gjilani, Fetih, “Parashkrimi i padisë”, Ribotim 2007.

Rregullat për hartimin e akteve ligjore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 14, pika 1 të saj, përcakton se *Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja*. Bazuar në këtë parashikim kushtetues është nevojshme që i gjithë procesi i hartimit të akteve ligjore, nënligjore, urdhërave të brendshëm, shkresave zyrtare etj., duhet që të hartohen në gjuhën shqipe. Vetë gjuha shqipe, përbëhet nga disa dialekte që ndryshon në varësi të krahinave të ndryshme si edhe nga gjuha shqipe standarde apo letrare, rregullat e shkrimit të së cilës janë vendosur dhe përcaktuar në Kongresin e Gjuhës Shqipe të vitit 1972.¹³ Rregullat e vendosura në këtë kongres, deri më sot nuk kanë ndryshuar dhe është e kuptueshme që këto rregulla duhet të përdoren edhe në hartimin e akteve ligjore në vendin tonë.

Nga pikëpamja juridike rezulton se Kushtetuta, Ligji nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, Rregullorja e Kuvendit,¹⁴ si edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, janë të vetmet akte të cilat rregullojnë procesin e propozimit, shqyrtimit dhe miratimit të akteve normative. Por në këto akte nuk ka asnjë rregullim të mirëfilltë për mënyrën dhe rregullat e hartimit drejtëshkrimor të këtyre akteve.

Përsa i përket doktrinës që trajton shkencërisht rregullat e hartimit të akteve normative, rezulton që të jetë e pakët. Por edhe në ato pak studime që janë botuar rezulton se në krerët që trajtojnë mënyrën e të shkruarit të akteve normative parashikohet si rregulla për hartimin e akteve *shmangia e përdorimit të termave të huaj, përveç rastit kur kanë hyrë në përdorim të përditshëm të gjuhës shqipe dhe nuk kanë fjalë të tjera korresponduese në shqip. Aty ku është e nevojshme, edhe për termat jepni përkufizimn përkatës*.¹⁵ Një tjetër autor shprehet se *qëllimi kryesor i hartuesit duhet*

13 “*Drejtëshkrimi i gjuhës shqipe*”, botim i Akademisë së Shkencave – Instituti i Gjuhësisë dhe Leteërsisë, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë 1973, fq.16.

14 Miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004 të Kuvendit, i ndryshuar,

15 Berberi, Sokol, “*Rregulla dhe rekomandime për hartimin e akteve normative*”, Botim i Qendrës së Studimeve Parlamentare, Tiranë 2004, fq.49.

të jetë që të mundësojë lexuesin të kuptojë, sa më shpejt dhe sa më saktë se çfarë i është kërkuar të bëjë ose të mos bëjë nga legjislacioni. Zgjedhja e gjuhës dhe stili i të shkruarit duhet të mbizotërohet nga parimi i kapshmërisë. Teksti duhet të jetë sa më i drejtëpërdrejtë dhe me një gjuhë të pastër që, sa më shumë që të jetë e mundur, të përputhet me përdorimin standard të gjuhës.¹⁶

Si materiale të rëndësishme punimi për hartuesit e akteve ligjore dhe nënligjore janë edhe dy manualët e teknikës legjislativë, e hartuar në vitete 2006¹⁷ dhe 2010.¹⁸ Duke iu referuar manualit të parë, atij të vitit 2006, i cili që në titullin e tij përdor në mënyrë të gabuar termin “guidë” (dhe që në manualin e dytë të vitit 2010 është zëvendësuar me termin shqip “udhërrëfyes”), në lidhje me përdorimin e termave të huaj sqarohet se *lidhur me fjalët që do të përdoren, duhen zgjedhur fjalë bashkëkohore, dhe ato duhen përdorur në kuptimin e tyre të zakonshëm dhe kryesor. Duhet të shmangët përdorimi i fjalëve arkaike të cilat nuk përdoren shpesh apo nuk kuptohen, apo i neologjizmave të cilat nuk janë bërë ende pjesë e përdorimit të përditshëm të gjuhës shqipe. Kur ka një shkak të veçantë për moszbatimin e këtyre rregullave, atëherë fjalët duhet të përkufizohen.*¹⁹ Nga ana tjetër manuali i vitit 2010 është më i plotë dhe më sqarues kur i referohet mënyrës së përdorimit të termave të huaj. Më konkretisht sipas këtij manuali *fjalët dhe shprehjet me origjinë të huaj*

16 Gumi, Viktor, “*Shkrimi legjislativ*”, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë 2006, fq.29-30.

17 “*Manual i hartimit të ligjeve në Shqipëri – Një guidë për procesin legjislativ në Shqipëri*”, botuar nga Misioni Evropian i Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë (EURALIUS), Këshilli i Evropës dhe Ministria e Drejtësisë, Tiranë 2006.

18 “*Manual i hartimit të ligjeve – një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri*”, botuar nga Misioni Evropian i Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë (EURALIUS), Bashkimi Evropian dhe Ministria e Drejtësisë, Tiranë 2010.

19 “*Manual i hartimit të ligjeve në Shqipëri – Një guidë për procesin legjislativ në Shqipëri*”, botuar nga Misioni Evropian i Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë (EURALIUS), Këshilli i Evropës dhe Ministria e Drejtësisë, Tiranë 2006, fq.59.

duhet të shmangen nëse në gjuhën shqipe ka një shprehje të përshtatshme të njohur përgjithësisht. Fjalët dhe shprehjet e huaja duhet të përdoren vetëm nëse ato janë pranuar në përdorimin e përditshëm të gjuhës shqipe dhe për to nuk ka fjalë tjetër në gjuhën shqipe. Për arsye gjuhësore, mund të përdoren fjalë të huaja kur fjalët dhe shprehjet janë të njohura dhe përgjithësisht të përdorura nga personat të cilëve u drejtohet ligji edhe pse jo nga publiku i gjerë. I tillë mund të jetë rasti kur përdoren terma teknikë (shih pikën 3.4.4). Fjalët dhe shprehjet e huaja mund të përdoren edhe kur ato përbëjnë një mjet të njohur dhe të përshtatshëm për shprehjen e një koncepti në mënyrë të qartë dhe të shkurtër (për shembull emrat shkencorë në latinisht). Në të gjitha rastet, kur përdoren fjalë ose shprehje të huaja, ato duhet të shkruhen me shkronja korsive. Gjithashtu, mund të përdoren fjalë apo shprehje të huaja (ndoshta të kombinuara me ekuivalenten në shqip) për të siguruar përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare apo me *acquis communautaire*.²⁰

Duke iu referuar doktrinës dhe manualeve të hartimit të akteve, është e kuptueshme që përdorimi i gjuhës shqipe në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore duhet që domosdoshmërisht të respektojë përdorimin e termave në gjuhën shqipe. Përdorimi i këtyre termave krijon mundësinë e pasjes të një teksti ligjor më të qartë dhe më të kuptueshëm nga personat të cilave u drejtohet akti i miratuar. Përdorimi i termave të huaj duhet të jetë i kufizuar. Në këtë drejtim vlen të theksohet se manualët shprehen kundër përdorimit të termave të huaj në ato raste kur ekziston një term në gjuhën shqipe. Për më tepër theksohet se edhe në ato raste kur duhet që të përdoren terma të huaj, ato duhet që të jenë shoqëruese të termit shqip, si edhe të vendosen në kllapa dhe me shkronja korsive.

Për të ruajtur sa më mire terminologjinë në gjuhën shqipe si edhe rregullat e drejtëshkrimit të saj, normalisht librat bazë për këtë punë janë: *Rregullat e drejtëshkrimit të shqipes*; *Fjalori drejtëshkrimor i gjuhës shqipe*; *Fjalori i gjuhës shqipe*, si edhe vitet e fundit, një program i shkarkueshëm në kompjuter, i përgatitur nga Instituti Albanologjik i

20 “Manual i hartimit të ligjeve – një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri”, botuar nga Misioni Evropian i Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë (EURALIUS), Bashkimi Evropian dhe Ministria e Drejtësisë, Tiranë 2010, fq.107.

Prishtinës, në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të QSA-së.²¹

Por referimi në këto materiale është gjithmonë e më i pakët nga specialistët dhe ekspertët që hartojnë aktet ligjore dhe nënligjore. Për këtë arsye, shpesh herë hasim në mosnjohje të këtyre rregullave dhe materialeve dhe përgjithësisht, synohet të “ndotet” gjuha e përdorur duke përfshirë terma të huaj.

Shembuj të përdorimit të termave të huaj në aktet legjislative

Nga pikëpamja historike rezulton që termat e huaj janë përdorur gjerësisht në legjislacionin tonë. Për ta ilustruar me shembujt po përmendim rastin e kushtetutave të vendit tonë. Kështu shpesh në kushtetutat e përpara Luftës së Dytë Botërore, gjejmë të përdorur përkrah termave në gjuhën shqipe edhe termat në gjuhën të huaj të vendosur në kllapa. Kështu në Statutin e Lushnjës²² rezulton se përkrah termit “pëlqejë”, përdoret termi “aprovojë”.²³

Në Statutin e Zgjeruar të Lushnjës²⁴ gjejmë përdorimin e termit “t’unjishëm” shoqëruar me termin “universal”,²⁵ përdorimin e termi të huaj “en bloc”, e pa shoqëruar me termin në shqip,²⁶ termin “kalamitet publik” shoqërohet me termin “afati semavije”, përdorimin e termit të huaj “ex officio”, e pa shoqëruar me termin në shqip.²⁷

21 Shkurtaç, Gjovalin, *“Urgjenca gjuhësore – huazime të zëvendësueshme me fjalë shqipe”*, Shtëpia Botuese “ADA”, Tiranë 2015, fq.30.

22 Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë, 1920, marrë nga Luarasi, Aleks, *“Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri”*, botimi i dytë, Shtëpia Botuese “Ombra GVG”, Tiranë 2014, fq.389-390.

23 Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë, neni 1.

24 Statuti i Zgjeruar i Lushnjës, 1922, marrë nga Luarasi, Aleks, *“Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri”*, botimi i dytë, Shtëpia Botuese “Ombra GVG”, Tiranë 2014, fq.394-412.

25 Statuti i Zgjeruar i Lushnjës, neni 5.

26 Po aty, neni 28.

27 Po aty, neni 83.

Në Statutin Themeltar të Republikës²⁸ gjejmë të përdorur termin “toksisht” e shoqëruar me termin “en bloc”,²⁹ termin “falje” me termin “grace”,³⁰ termat “parashikues” dhe “ndeshkuese”, respektivisht me termat “prevendiv” dhe “represiv”,³¹ termi “të paguem në dorë” shoqërohet me termin “peshin”,³² termi “pronë e thjeshtë” shoqërohet me termin “mylq”.³³

Në Statutin Themeltar të Mbretërisë³⁴ së vitit 1928 përdorimi i termave të huaj përkrah termave shqiptarë ishte më i theksuar. Me konkretisht termi “Mbretëri”, shoqërohet me termin “Royame”,³⁵ termi “i miratuar”, shoqërohet me termin “sanctionner”,³⁶ termi “për miratim” shoqërohet me termin “sanction”, termi “të shfuqizohen” shoqërohet me termin “abroger”, termi “të ndryshohen”, shoqërohet me termin “modifier”, termi “të pezullohen” shoqërohet me termin “suspender”,³⁷ termi “bashkarisht” shoqërohet me termin “en bloc”³⁸, termi “dorëheqje”, shoqërohet me termin “abdication”,³⁹ termi “nxjerrje ligje” shoqërohet me termin “promulguer”, termi “falje” shoqërohet me termin “grace”, termi “lehtëson” shoqërohet me termin “reduire”, termi “ndryshojë”

28 Statuti Themeltar i Republikës, 1925, marrë nga Luarasi, Aleks, *“Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri”*, botimi i dytë, Shtëpia Botuese “Ombra GVG”, Tiranë 2014, fq.421-443.

29 Statuti Themeltar i Republikës, neni 32.

30 Po aty, neni 78

31 Po aty, neni 95.

32 Po aty, neni 129.

33 Po aty, neni 130.

34 Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, 1928, marrë nga Luarasi, Aleks, *“Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri”*, botimi i dytë, Shtëpia Botuese “Ombra GVG”, Tiranë 2014, fq.447-480.

35 “Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare”, Neni 1.

36 Po aty, neni 11.

37 Po aty, neni 12.

38 Po aty, neni 42.

39 Po aty, neni 57.

shoqërohej me termin “commuer”,⁴⁰ termi “Lartmadhëria e Tij”, shoqërohej me termin “Sa Majestë”, termi “Lartësia e tij” shoqërohej me termin “Son Altesse”,⁴¹ termi “i varur” shoqërohej me termin “soumis”,⁴² termi “shpallen”, shoqërohej me termin “prononcer”,⁴³ termi “shpërblim”, shoqërohej me termin “gratification”,⁴⁴ termi “dekretohen”, shoqërohej me termin “edicter”,⁴⁵ etj.

Përdorimi i këtyre termave kaq masivisht dhe për më tepër në aktin themelor të vendit, krijon premisën që terma të huaj të përdoren edhe në ligje të tjera. Në atë kohë me e theksuar ka qenë përdorimi në gjuhën frenge në Kodin Civil të kohës, shembuj për të cilin përmendem më sipër në këtë punim.

Mbas Luftës së Dytë Botërore, rregulli i mësipërm u eliminua në legjislacionin tonë, por për shkak tradite disa terma të huaj me përshtatje në shqip u ruajtën. Kështu sipas Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë,⁴⁶ gjejnë përdorim termat “inviolabiliteti”, “kondita”, “konstitucional”, “nacionale”, “inisiativën”, “deliktin”, konfirmimetin”, “promuglon”, “instrukcione”, “lokalitetet”, “permanentë”.⁴⁷

Por me zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, rezulton se kushtetutat e tjera të vendit tonë, të hartuara edhe miratimit të rregullave të drejtëshkrimit të gjuhës shqipe në Kongresin përkatës të vitit 1972, kanë përdorur në mënyrë më korrekte termat në gjuhën shqipe.

Nga analiza e termave të mësipërm rezulton se përdorimi i tyre, fillimisht në mënyrë të dyfishtë, kishte si synim sqarimin e nocioneve

40 Po aty, neni 79.

41 Po aty, neni 98.

42 Po aty, neni 99

43 Po aty, neni 124.

44 Po aty, neni 145.

45 Po aty, neni 175.

46 “Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë”, 1946, marrë nga Luarasi, Aleks, “Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri”, botimi i dytë, Shtëpia Botuese “Ombra GVG”, Tiranë 2014, fq.487-514.

47 Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, nenet 12, 19, 23, 34, 35, 49, 54, 58, 64, 71, 72, 79, 89.

juridike që përdoren në gjuhën shqipe si edhe për të treguar një lloj niveli kulture perëndimore në përdorimin e termave juridikë. Kjo praktikë u ndryshua mbas Luftës së Dytë Botërore, ku u tentua që të ruhej një terminologji më e paster në gjuhën shqipe. Por është e kuptueshme që pavarësisht përpjekjeve shumë terma përdoren në gjuhë të huaj por të shqipëruara.

Kushtetuta aktuale në fuqi ruan në përgjithësi përdorimin e saktë të termave në gjuhën shqipe, por në drejtëshkrimin e saj shfaqen disa gabime. Kështu në nenin 17 të saj përdoret termi “Europiane”⁴⁸ kur në fakt duhej të përdorej termi “Evropiane”, sic e kërkon edhe Fjalori i Gjuhës Shqipe.⁴⁹

Me ndryshimet e fundit të ligjit themelor⁵⁰ rezulton se në disa raste përsëri, me gjithë kujdesin e treguar, janë përdorur terma të huaj të cilët kanë një term në gjuhën shqipe. Kështu në nenin 179/b, pika 4, përdoret termi “ex officio”, ndërkohë në gjuhën shqipe në këto raste mund të përdorej termi “për shkak të detyrës”. Po kështu në nenin “C”, pika 8 përdoret termi “ad hoc” ndërkohë që termi në gjuhën shqipe do të duhej të ishte i “posaçëm”. Pavarësisht se termi “ad hoc” përmban disa karakteristika si përkohshmëria e tij dhe natyra e veçantë, jam e mendimit se termi i “posaçëm” e përfshin këto nocione brenda vetës. Për më tepër që për ta bërë më të qartë në gjuhën shqipe dhe arsyen e përdorimit të këtij termi, atëherë do të ishte më mirë që të përkufizohej në tekstin legjislativ se sa të përdorej një term i huaj.

Edhe në legjislationin që shoqëron zbatimin e Kushtetutës, megjithë kujdesin që tregohet ka përsëri terma të huaj. Kështu në ligjin nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, neni 3, pika 4 përdoret termi

48 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 17, pika 2: *Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.*

49 “Fjalori i Gjuhës Shqipe”, Akademia e Shkencave – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006, fq.254.

50 Realizuar me ligjin nr.76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

“Informacion sensitive”, ndërkohë që mund të përdorej termi më i saktë në gjuhën shqipe “Informacion i ndjeshëm”.

Edhe ndryshimet e reja të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht ligji nr.99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin he funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 35 të tij, që sjell ndryshime në nenin 38 të ligjit ekzistues, në pikën 3 parashikon *se Njoftimi i kërkuarit, subjektit të interesuar ose përfaqësuesit të tyre ose, sipas rastit, i dëshmitarit, ekspertit apo personave të tjerë, pjesëmarrja e të cilëve është e nevojshme për zhvillimin efektiv të gjykimit kushtetues, bëhet me shkresë zyrtare, me fletëthirrje postare, me telegram, si dhe përmes e-mail-it nëse palët kanë rënë dakord për këtë mënyrë njoftimi në momentin e depozitimit të kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese.* Përdorimi i termit “e-mail” është absolutisht i panevojshëm, duke qenë se në vend të tij mund të përdoret termi “posta elektronike”, i cili jep të njëjtin kuptim dhe mundëson përdorimin e saktë të gjuhës shqipe.

Po kështu edhe në legjislacionin tjetër me natyrë të përgjithshme gjejmë përdorimin e termave të huaj. Më konkretisht në ligjin nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, gjejmë se përdoret termi “onlinë”,⁵¹ ndërkohë që mund të përdorej shumë më mirë termi “mjete elektronike”, term ky i cili përdoret edhe nga Kodi i Procedurave Administrative.⁵² Megjithëse termi “mjet elektronik” duket sikur është më i gjerë se ai “online”, pasi përfshin edhe komunikimet si me internet ashtu edhe me intranet, përsëri përdorimi i këtij termi nuk më duket bindës, kur, referuar edhe manualeve përkatës, ai mund të përdorej si term shoqërues i vendosur në kllapa dhe i shënuar me gërma korsive, nëse përdorimi i tij ishte i nevojshëm, ose termi “mjet elektronik” të përkufizohej me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të saktë brenda kornizës rregulluese të ligjit.

Një tjetër akt që shfaq problem në përdorimin e termave të huaj është Kodi Detar.⁵³ Kështu në këtë akt përdoren terma të tillë si “Bareboat”,

51 Ligj nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, neni 3, pika 13.

52 Ligj nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 10, 42, 45 etj.

53 Ligj nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

kontrata “çarter për një udhëtim”, kontratën “carter me kohe”, të cilat nuk kanë një përdorim të tyre në gjuhën shqipe. Në këtë rast me sa duket ndodhemi përpara termave teknikë, të cilët kanë marrë edhe një njohje ndërkombëtare. Pavarasisht kësaj jam i mendimit se duhen bërë përpjekje për gjetjen e termave të përafërt në gjuhën shqipe, dhe nëse ato mungojnë atëherë duhen krijuar fjalë të reja në gjuhën amtare që t’i përshtaten këtyre termave të huaj.

Por ajo që është më shqetësuese është kur vetë legjislacioni i arsimit parauniversitar dhe atij të lartë, përdor terma në gjuhë të huaj kur në fakt ekzistonte terminologjia në gjuhën shqipe e cila ishte dhe mjaft e konsoliduar. Kështu mund të përmendim përdorimin e termit “kurrikula”, në vend të termit “program”.⁵⁴ Mendojmë se përdorimi i këtij termi është absolutisht i papërshtatshëm. Termi i mëparshëm “program” ishte një term shumë i saktë në gjuhën shqipe dhe jepte kuptimin e plotë të qëllimit për të cilin përdorej ky term. Zëvendësimi i tij me një term të huaj, nuk paraqet asnjë arsye nga pikëpamja leksikore.

Një tjetër problematikë lidhet me përdorimin e shkurtimeve. Kështu në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se për një institucion, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, përdoret në kllapa shkurtimi “ASP”,⁵⁵ i cili përdoret më tej në vetë tekstin e ligjit si edhe në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave i cili shoqëron këtë ligj.⁵⁶ Shkurtimi “ASP” në këtë rast duket se i referohet termit të këtij institucioni në gjuhën angleze, “Albanian School of Public Administration”. Por pavarësisht sa bukur që mund të tingëllojë ky shkurtim, përsëri ai nuk është në gjuhën shqipe, si edhe nuk rezulton që të ketë një arsye të fortë për këtë lloj përdorimi. Kjo pasi, termi i këtij institucioni ekziston në gjuhën shqipe, ai nuk është një term teknik

54 Ligj nr.69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2, pika 8 e në vijim. Ligj nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 4.

55 Ligj nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 8, pika 1 e në vijim.

56 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.138, datë 12.3.2014 “Për rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimit e nëpunësve civilë”.

dhe nuk shërben për përafrimin e legjislacionit me ndonjë akt të huaj ndërkombëtar apo të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye jam e mendimit që termi shkurtuar, nëse realisht ishte i nevojshëm duhej që të ishte në gjuhën shqipe, sic vetë ky ligj e ka përdorur për një tjetër institucion, atë të Departamentit të Administratës Publike, “DAP”. Duke përdorur dy shkurtime për institucione që përmenden në të njëjtin ligj, ky njëri shkurtime është në gjuhën shqipe dhe tjetri në gjuhën angleze, vetë teksti ligjor tregon një paqendrueshmëri në përmbajtjen e tij.

Një situatë e ngjashme përsëritet nga ligji nr.13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, i cili për institucionin, Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara, përdor shkurtime “ADISA”.⁵⁷ Edhe në këtë rast termi “ADISA” është shkurtime i emrit të institucionit në gjuhën angleze.

Konkluzione

Një analizë tërësore e legjislacionit shqiptar për të parë përdorimin e termave në gjuhën shqipe apo në gjuhë të huaj, është i pamundur që të shterohet në këtë punim. Për këtë arsye shembujt e përmendur më sipër janë për të treguar problematikat e përdorimit të termave në gjuhë të huaj, kur për të cilat ekziston një terminologji e saktë për to në gjuhën shqipe.

Sic mund të konstatohet nga ky punim, përdorimi i një terminologjie të saktë juridike në gjuhën shqipe ka qenë një përpjekje e vazhdueshme që në fillimet e ekzistencës së Shtetit Shqiptar. Por kjo përpjekje ka qenë e luhatshme dhe asnjëherë e qendrueshme. Kjo ka sjellë përdorimin e shumë termave të huaj në legjislacionin shqiptar pa pasur nevojë në fakt për një përdorim të tillë kaq masiv.

Shembujt e treguar më lart në këtë punim tregojnë qartë që tendenca për të përdorur terma të huaj ka qenë e dukshme në të gjitha fazat e zhvillimit të vendit tonë. Por, ndonëse mund të justifikohet përdorimi i termave të huaj në vitet e para, tendenca e re “moderne” që po shfaqet për

57 Ligj nr.13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, neni 4, pika 1, si edhe në vijim në të gjithë tekstin e ligjit.

përdorimin e termave të huaj edhe sot, është e pakuptimtë.

Mesa duket përdorimi i termave të huaj lidhet me dy fenomene. Së pari arsimimi në gjuhën shqipe është pjesë e programeve mësimore vetëm në sistemin arsimor 9 – vjeçar. Më tej, në sistemin e arsimit të mesëm apo të lartë (përfshirë bën, arsimimi në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë) nuk zhvillohet më asnjë lëndë e cila do të përcojë më tej njohuritë në fushën e gjuhësisë.

Së dyti, rezultojnë se modelet për hartimin e legjislacionit shqiptar janë të huaja, pra merren nga vende të tjera. Për më tepër në kuadër të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, një pjesë e mirë e legjislacionit tonë është rezultat i marrjes si model i rregulloreve, direktivave dhe akteve të tjera të kësaj organizate. Pavarësisht se ligjshkruesit bëjnë një përpjekje për përshtatjen e tyre, duke qenë se hasen me terma në gjuhë të huaj dhe duke qenë se arsimimi i tyre në gjuhën shqipe ka përfunduar vite më parë, kanë tendencë që t'i pranojnë këto terma dhe të mos përpiqen në individualizimin e termave të gjuhës shqipe të cilat kanë të njëjtin kuptim.

Në këtë pikë edhe vetë programi i arsimimit të lartë në fakultetet në të cilat studiohet për drejtësi nuk duket se ndihmon. Kështu nëse i referohemi programit të mësimor në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, rezultojnë se vetëm në vitin e parë si lëndë me zgjedhje në vitin e parë të studimeve jepet lëndë “Teknika legjislativë”. Por kjo lëndë nisur nga numri i kreditëve (vetëm 3) dhe faktin që është lëndë me zgjedhje, nuk mund të plotësojë boshllëkun e madh që është krijuar tek studentet, të cilët prezumohet se në të ardhmen do të jenë edhe hartues të akteve ligjore dhe nënligjore. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për lëndën “Kulturë gjuhësore”, e cila zë një numër të kufizuar orësh në programin e përgjithshëm të formimit juridik.⁵⁸

Kjo dobësi duket edhe në mos përdorimin e materialeve në gjuhën shqipe, gjatë hartimit legjislativ të akteve. Një tjetër aspekt që tregon dobësi është edhe shpallja dhe rishpallja disa herë e testimit për ligjshkruesit nga ana e Departamentit të Administratës Publike, gjatë dy viteve të fundit.⁵⁹ Rishpallja disa herë, pavarësisht numrit të lartë të kandidatëve tregon

58 Informacion i marrë nga faqja e internetit www.fdut.edu.al

59 Informacion i marrë nga faqja e internetit www.dap.gov.al

dobësitë që arsimimi juridik në vendin tonë ka në drejtim të aspekteve të teknikës legjislativë dhe të përdorimit të gjuhës shqipe në hartimin ligjor.

Për këtë arsye është e këshillueshme rritja e peshës së lëndës “Teknikë legjislativë”, si edhe plotësimin e saj me njohuri gjuhësore, me qëllim forcimin e kësaj disipline dhe rritjen e njohurive teorike dhe praktike për studentët e drejtësisë.

Bibliografia

- Nathanaili, Andrea, “Çështje terminologjie juridike”, botuar në Revistën “Drejtësia Popullore” nr.4 e vitit 1951, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
- Noçka, Irakli, “Gjyqtarët e Shqipërisë gjatë gjysëm shekulli”, botuar në Revistën “Drejtësia Popullore” nr.5 e vitit 1962, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
- “Drejtëshkrimi i gjuhës shqipe”, botim i Akademisë së Shkencave – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë 1973.
- Berberi, Sokol, “Rregulla dhe rekomandime për hartimin e akteve normative”, Botim i Qendrës së Studimeve Parlamentare, Tiranë 2004.
- Gumi, Viktor, “Shkrimi legjislativ”, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë 2006.
- “Manual i hartimit të ligjeve në Shqipëri – Një guidë për procesin legjislativ në Shqipëri”, botuar nga Misioni Evropian i Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë (EURALIUS), Këshilli i Evropës dhe Ministria e Drejtësisë, Tiranë 2006.
- “Fjalor i Gjuhës Shqipe”, Akademia e Shkencave – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006.
- Anastasi, Aurela, “Historia e së Drejtës Kushtetuese në Shqipëri, 1912-1939”, Shtëpia Botuese “Pegi”, Tiranë 2007.
- Gjilani, Fetih, “Parashkrimi i padisë”, Shtëpia Botuese “ILAR”, ribotim viti 2007.
- “Manual i hartimit të ligjeve – një udhërrëfyes për procesin

legjislativ në Shqipëri”, botuar nga Misioni Evropian i Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë (EURALIUS), Bashkimi Evropian dhe Ministria e Drejtësisë, Tiranë 2010.

- Luarasi, Aleks, “Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri”, botimi i dytë, Shtëpia Botuese “Ombra GVG”, Tiranë 2014.
- Shkurtaç, Gjovalin, “Urgjenca gjuhësore – huazime të zvëndësueshme me fjalë shqipe”, Shtëpia Botuese “ADA”, Tiranë 2015.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kanoni Zhurisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Korrik 2009.
- Ligj nr.76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.
- Ligj nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj nr.69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Ligj nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 10, 42, 45 etj.
- Ligj nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligj nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.
- Ligj nr.13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.
- Vendimi i Kuvendit nr.166, datë 16.12.2004 “Rregullorja e Kuvendit”, i ndryshuar.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.138, datë 12.3.2014 “Për rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë”, i ndryshuar.
- www.fdut.edu.al
- www.dap.gov.al

MEKANIZMAT E BRENDSHËM NË PARANDALIMIN E TORTURËS DHE TRAJTIMIT Ç’NJERËZOR DHE DEGRADUES NË SHQIPËRI

Etilda GJONAJ (SALIU)

Hyrje

Mekanizmi i brendshëm në parandalimin e torturës dhe të çdo lloj forme ndëshkimi, trajtimi çnjerëzor dhe degradues në Shqipëri (*Mekanizmi- këtej e tutje*) është ngritur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, me ratifikimin e Protokollit Opsional për parandalimin e torturës (OPCAT)¹. Në një kohë që Mekanizmi kombëtar ka rreth 9 vjet që është ngritur dhe funksionon, roli parandalues i tij në format klasike të torturës dhe trajtimit çnjerëzor ka ndikuar pozitivisht në parandalimin e torturës, por, sfidë mbetet gjetjet e metodave më efektive për parandalimin e torturës.

Në këtë shkrim analizohet funksionimi i Mekanizmit kombëtar në vendin tonë në përputhje me parashikimet e OPCAT dhe në krahasim me vendet e tjera të Evropës duke marrë në konsideratë rolin e tij parandalues, por edhe mbrojtës nëpërmjet rekomandimeve që referohen në organin e akuzës.

Bazuar në analizën e rasteve që Mekanizmi ka ndjekur ndër vite lidhur me rastet e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, dhe duke vlerësuar rëndësinë e tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut mes mjeteve të brendshme efektive, në këtë shkrim arrij në disa përfundime dhe rekomandime për përmirësimin e punës së Mekanizmit kombëtar lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me liri të kufizuar.

1 Ratifikuar me ligjin Nr. 9094 datë 03.07.2003 “Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese”.

1.0 Pak histori

Pothuajse të gjitha aktet ndërkombëtare që lidhen me torturën dhe trajtimin çnjerëzor dhe degradues rekomandojnë që shtetet e vendeve anëtare të ndërmarrin një sërë masash parandaluese me qëllim uljen e rrezikut të torturës dhe keqtrajtimit të njerëzve.

Shqipëria, pasi ratifikoi² Konventën kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese³, ratifikoi edhe “Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”⁴, i cili krijon një sistem për parandalimin e torturës të bazuar në vizitat nga një institucion ndërkombëtar siç është Nënkomiteti, në institucionet e ekzekutimit të dënimeve me burgim. Nga Protokollin Opsional rrjedh edhe detyrimi për të krijuar një strukturë kombëtare për parandalimin e torturës ose për të bashkëngjitur një aktivitet të tillë në një institucion me profil të ngjashëm pune.

Që nga momenti, kur OPCAT hyri në fuqi, më 22 qershor 2006, në nivel global, një numri të lartë të Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut ju dhanë kompetencat nga shtetet respektive si Mekanizma për parandalimin e torturës dhe trajtimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese⁵. Vendi ynë, me hyrjen në fuqi të Protokollit Opsional, ndërmori angazhimin në mënyrë ligjore dhe institucionale për ngritjen e një strukture të posaçme për parandalimin e çdo lloji torture dhe trajtimi ç’njerëzor dhe degradues.

2 Ratifikuar me ligjin Nr. 7727/1993

3 Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984, hyri në fuqi në 1987

4 Ratifikuar me ligjin Nr. 9094 datë 03.07.2003 “Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese”.

5 Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut (të njohura ndryshe NHRI), janë ato institucione të ngritura në bazë të legjislacionit të brendshëm, në Shqipëri konsiderohet Institucioni i Avokatit të Popullit si një i tillë

Protokolli Opsional nuk përcakton një formë ose model të përcaktuar të Mekanizmit Kombëtar dhe shtetet janë të lirë që të ndërtojnë një ose disa institucione ose këto kompetenca tia ngarkojnë një institucion ekzistues në cilësinë e Mekanizmave kombëtarë. Pavarësisht kësaj, Mekanizmat kombëtarë duhet të plotësojnë disa kërkesa minimale, një ndër të cilat, se ato duhet të jenë të pavarura, si në aspektin funksional, personal dhe institucional.⁶

Vendet që ratifikuan Protokollin Opsional ndoqën disa modele për ngritjen e Mekanizmit Kombëtar. në nivel global, deri më sot numërohen rreth 64 vende dhe në Evropë rreth 25 vende, që kanë ngritur Mekanizmat Kombëtarë duke ndjekur kryesisht 4 modelet më klasike. Një nga modelet kryesore është ai ku institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, janë të dizenuar dhe luajnë rolin e Mekanizmit Kombëtar⁷ në mënyrë individuale ose kolegjiale.

Modelet që vendet e ndryshme Evropiane, por jo vetëm, kanë zgjedhur janë përshtatur nga shtetet anëtare sipas kushteve, ndërtimi dhe funksionimi i Institucioneve shtetërore vendimmarrëse dhe qeverisëse dhe faktorë të tjerë të një shteti. Ndjekja e modeleve të përzgjedhura nga shtetet përmbajnë në zbatim arritje dhe sfida të cilat janë të ndryshme për secilin.

Në Evropë, modelet më të përdorura për Mekanizmin Kombëtar, është modeli “Ombudsman” duke ja lënë këtë kompetencë Institucionit të Ombudsmanit (*Avokati i Popullit në Shqipëri*). Disa Institucione kombëtare të të drejtave të njeriut, janë të dizenuar si MKPT së bashku me përfaqësues të shoqërisë civile duke e specifikuar si Modeli “Ombudsman Plus”.⁸

6 Gjonaj (Saliu), E. “Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut si Mekanizma kombëtarë për parandalimin e torturës, arritjet dhe sfidat Modelet në disa vende të Evropës”, Book Proceedings, fourth International Conference on: “Interdisciplinary Studies” botim i International Institute for private, commercial and competition law (IIPPCL), Qershor 2016, fq. 565.

7 Po aty, fq.565

8 Po aty, fq. 565

Një model tjetër, por i përdorur më rrallë edhe në Evropë, është rasti i Austrisë, në të cilën disa institucione kombëtarë të të drejtave të njeriut të shkriira së bashku ushtrojnë funksionet dhe kompetencat e MKPT-së, për shkak se kemi të bëjmë me Bordin Austriak të Ombudsmanëve, një organ kolegjal⁹.

Duke mbajtur në konsideratë modelet, që në Evropë u krijuan pas miratimit të Protokollit Opsional, Shqipëria përqaqi modelin e “Ombudsmanit” për Mekanizmin Kombëtar për parandalimin e Torturës (MKPT). Avokati i Popullit, si një institucion i pavarur me fokus të veçantë tek të drejtat e njeriut dhe i ngritur si një Institucion kombëtar për të drejtat e njeriut në respekt të zbatimeve të “Parimeve të Parisit”, u vlerësua nga ligjvënësi të ishte autoriteti i duhur në garantimin e funksionimit profesional dhe të pavarur të MKPT-së. Modelin “Ombudsman”, si një nga modelet kryesore të MKPT-së, e kanë zgjedhur edhe një sërë vendesh të tjera në Evropë, si Estonia, Gjeorgjia, Spanja, etj.¹⁰

Këto modele janë mbështetur kryesisht në modelin e vendeve skandinave të cilat janë kryesisht të fokusuara në adresimin e çështjeve që kanë lidhje me keqadministrimin dhe qeverisjen nëpërmjet trajtimit të ankesave dhe adresimit të rekomandimeve si “ligje të buta”, me efekt jo detyrues. Mandati dhe misioni i Institucioneve të Ombudsmanëve ndryshon në vende të ndryshme lidhur me qëllimin dhe natyrën e veprimtarisë, kjo për pasojë edhe në mënyrën e funksionimit dhe realizimit të veprimtarisë të MKPT-së.¹¹

Njohja ligjore e MKPT-së, si një strukturë e veçantë pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri, u bë efektive me miratimin e ligjit nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur”, i ndryshuar.¹²

9 Po aty, fq. 566

10 Gjonaj (Saliu), E. *“Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut si Mekanizma kombëtarë për parandalimin e torturës, arrijtjet dhe sfidat Modelet në disa vende të Evropës”*, botim i cituar, fq. 568.

11 Poaty, fq 565.

12 Po aty, fq 564

2.0 Kuadri ligjor vendas në këndvështrim krahasues me atë ndërkombëtar lidhur me rolin dhe funksionin e MKPT-së

Protokollit Opsional është një instrument ndërkombëtar me qëllim për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit duke ngritur një sistem nëpërmjet të cilit kryhen vizita të rregullta në të gjitha institucionet e ku mbahen persona të privuar nga liria¹³, brenda juridiksionit dhe kontrollit të shteteve respektive.

Bazuar në nenin 19 të Protokollit Opsional¹⁴, Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës i jepen kompetenca në tre drejtime: a) monitorimin në mënyrë të rregullt për trajtimin e personave të privuar nga liria në vendet e burgimit (*sipas parashikimeve të nenit 4 të Protokollit Opsional*), dhe nëse është e nevojshme mbrojtjen e tyre nga çdo formë torturë, trajtim ose dënimi të egër çnjerëzor ose poshtëruës; b) adresimin e rekomandimeve drejtuar organeve përkatëse, me qëllim për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të personave, që u është hequr liria dhe parandalimin e torturës dhe trajtimin ose dënimi i egër çnjerëzor dhe poshtëruës, duke marrë parasysh normat përkatëse të Kombeve të Bashkuara; dhe c) propozime dhe vërejtje në lidhje me legjislacionin ekzistues dhe atij në proces hartimi.

Sipas nenit 20 të Protokollit Opsional, shtetet anëtare respektive kanë detyrim t'u garantojnë MKPT-ve akses për të gjithë informacionin lidhur me numrin e personave të privuar nga liria në vendet me liri të privuar dhe informacion lidhur me trajtimin e tyre, (*sipas detajimeve të nenit 4*

13 Sipas OPCAT, Institucionet e mbyllura nuk janë konsideruar vetëm në ato të cilat mbahen personat e paraburgosur ose të dënuar, por edhe në institucionet e tjera të mbyllura, si spitalet psikiatrike, qëndrat e azilkërkuesve, etj. Sipas nenit 4 të Protokollit Opsional parashikohet se vendet ku privohet liria, konsiderohen të gjitha ato vende ku qëndrojnë persona që janë ose mund të jenë të privuar nga liria, me një vendim të autoriteteve publike, ose me iniciativën, me pëlqimin ose pranimin e tij.

14 Optional Protocol to the Convention against Torture and other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment, Adopted on 18 December 2002 at the fifty-seventh session of the General Assembly of the United Nations by resolution A/RES/57/199, entered into force on 22 June 2006, <http://ëëë.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/OPCAT.aspx>

të OPCAT), kushtet në të cilat ndodhen personat e privuar nga liria si dhe akses të plotë në të gjitha vëndet e mbyllura.

Mekanizmat në bazë të parashikimeve të këtij neni kanë të drejtë të kryejnë intervista në mënyrë private me personat të privuar nga liria, ose persona si përkthyes ose çdo individ tjetër që mendohet se mund të japë informacion të nevojshëm; kanë lirinë të zgjedhin vetë, vendet që planifikojnë të vizitojnë dhe personat që kërkojnë të intervistojnë ashtu si dhe kanë të drejtën të kenë kontakte me anëtarë të Nënkomitetit për Parandalimin e torturës të Kombeve të Bashkuara (SPT), duke i dërguar informacion ose zhvillimin e takimeve me ta..

Institucionit të Avokatit të Popullit, në ndryshimet dhe shtesat që u bënë në vitin 2008 në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”,¹⁵ ju njoh një rol mjaft aktiv në respektim të të drejtave të personave të privuar nga liria dhe se ndryshimet e bëra nga ligjvënësi, ishin nën frymën e Protokollit Opsional duke përdorur pothuajse të njëjtën terminologji.

Neni 74/1 i ligjit të sipërcituar, parashikon se MKPT vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e Avokatit të Popullit, e cila mbikqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve.

MKPT në bazë të këtij ligji ushtron disa kompetenca si vëzhgimin rregullisht të trajtimit të individëve që ju është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim forcimin, dhe kur është e nevojshme mbrojtjen e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës.

Gjithashtu, po në bazë të kësaj dispozite, MKPT paraqet rekomandime për organet përkatëse me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit, ka kompetenca për të vëzhguar trajtimin e kategorisë së personave të privuar nga liria, në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, mbrojtjen e shtetasve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës.

15 Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”,. Ky ligj gjendet i botuar në Fletoren zyrtare nr.44

Ashtu si dhe neni 20 i Protokollit Opsional, dhe nenet 74/2 dhe 74/3 i ligjit Nr. 8328, datë 02.04.1998, i garantojnë të njëjtat të drejta dhe akses të plotë punonjësve të Mekanizmit Kombëtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij në institucionet ku privohet liria.

Me ndryshimin e ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”¹⁶, i ndryshuar, në nenin 19 pika 1, parashikohet se anëtarët e MKPT-së, si persona të autorizuar nga Avokati i Popullit, kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Nga analiza e ligjit del e qartë se është parashikuar një diskrecion shumë të gjërë lidhur me insitucionet dhe fushën e veprimit.

Hyrja në këto mjedise, sipas po të njëjtit nen, mund të bëhet jo vetëm në kuadër të hetimit të një ankese drejtuar Avokatit të Popullit, por edhe për qëllime inspektimi apo studimi.

Zgjerimi i kompetencave të Avokatit të Popullit lidhur me personat që privohen nga liria, solli dhe ndryshimet e nevojshme në ligjin për shëndetin mendor. Sipas neni 31 të ligjit Nr. 44/2012 “Për Shëndetin mendor”, parashikohet se Avokati i Popullit nëpërmjet MKPT-së, i jepet e drejta të vëzhgojë rregullisht respektimin e të drejtave dhe të standarteve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor me shtretër si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor.

Nëpërmjet këtij ligji, sigurohet edhe akses i pakufizuar i MKPT-së në të gjitha vendet dhe mjediset e Institucioneve të shërbimeve të shëndetit mendor duke garantuar edhe marrjen e çdo informacioni të nevojshëm.

16 Ndryshuar me ligjin nr. 8600, 10.04.2000, ndryshuar me ligjin Nr. 9398, datë 12.05.2005, ndryshuar me ligjin Nr. 155/2014 datë 27.11.2014; <http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/ligji-p%C3%ABr-avokatin-e-popullit-0>

Në nëntor të vitit 2014, me miratimin e ndryshimeve të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, niveli i përfaqësimit të MKPT, është ngritur nga Mekanizmi në nivel drejtorie në nivel në seksion nën drejtimin e një Komisioneri të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë.

Duke mbajtur në konsideratë modelet e disa vendeve të Evropës, të cilat kanë përqafuar modelin e Ombudsmanit, Mekanizmi drejtohet nga një zëvendës Ombudsman, i barabartë në nivelin e Komisionerit sipas legjislacionit tonë.

Ajo që evidentohet në mënyrë të qartë, është se legjislacioni vendas me ndryshimet përkatëse të bëra ndër vite është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe kërkesat e akteve të ratifikuara tashmë nga vendi ynë. Aktet ligjore dhe nënligjore garantojnë më së miri aksesin e MKPT-së sipas kërkesave të Protokollit opsional për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit.

2.1 Funkzioni i Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së

Është fakt se, Institucionet kombëtare të të Drejtave të njeriut ofrojnë më shumë garanci për të luajtur rolin e MKPT-ve, pasi ofrojnë qëndrueshmëri, ekspertizë, metodologji dhe infrastrukturë të zhvilluar e cila ndihmon në funksionin sa më mirë të MKPT-ve¹⁷. Sikurse është theksuar edhe më lart, Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës (MKPT) i përfshirë në strukturën e Avokatit të Popullit, sipas modelit “*të Ombudsmanit*”, përbën një garanci të mirë për mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të privuar nga liria.

Përqaşja e modelit “Ombudsman” për Mekanizmin nga vendi ynë, ka patur edhe një vlerë tjetër të shtuar, pasi Avokati i Popullit si një institucion kombëtar gëzon reputacion të fortë dhe besueshmëri tek publik¹⁸, nga

17 Gjonaj (Saliu), E. “Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut si Mekanizma kombëtarë për parandalimin e torturës, arritjet dhe sfidat Modelet në disa vende të Evropës”, Book Proceedings, Konferenca e katërt Ndërkombëtare në Shkenca multidisiplinare, botim i International Institute for private, commercial and competition law (IIPPCL), Qershor 2016,

18 Vlerësuar me niveli A sipas Parimeve të Parisit, nga Komiteti Ndërkombëtar i Monitorimit i Institucioneve Kombëtare të të drejtave të njeriut. Ky është vlerësim i përputhshmërisë të Institucionit të Avokatit të Popullit me Parimet e Parisit

të cilat Mekanizmi, përfiton për të zhvilluar një dialog konstruktiv me autoritetet lidhur me masat që do të ndërmarrin në mbrojtje të personave të privuar nga liria dhe parandalimin e rasteve të torturës dhe trajtimit çnjerëzor.

Një aspekt tjetër pozitiv për MKPT-në të ngritur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, është se ashtu si dhe një pjesë e mirë e Institucioneve Kombëtare, ky institucion ka ekspertizë të gjërë në vlerësimin e situatës të të drejtave të njeriut, duke e evidentuar shpesh në raportet vjetore, raporte të veçanta, studime të ndryshme, etj. Avokati i Popullit duke patur në fokus mbrojtjen e një game të gjërë të të drejtave të njeriut dhe mjete ligjore të ndryshme në funksion të tij, kombinon rolet e tij parandaluese, nxitëse dhe mbrojtëse, duke e bërë më interaktive Mekanizmin. Për të përmbushuar misionin e tij, Avokati i Popullit bashkëpunon me aktorë të shoqërisë civile, aktorë ndërkombëtare dhe sistemin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, gjë që për Mekanizmin janë të rëndësishme, në kuadër edhe të pritshmërive të OPCAT.¹⁹

MKPT në bashkëpunim me Komitetin për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës ashtu si dhe me Nënkomitetin për Parandalimin e torturës të Kombeve të Bashkuara, me të cilat kryen inspektime të përbashkëta, dërgon informacion dhe raporton për monitorimet e kryera, merr pjesë në aktivitete të përbashkëta, shkëmbim eksperiencë me MKPT të tjera të rajonit dhe të vendeve të Evropës, etj. Kjo shërben në forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit si dhe në shkëmbimin e ideve të reja për parandalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor.

1.2 Roli i MKPT-së në parandalimin e torturës

Protokolli opsional i njeh Mekanizmit rol parandalues, identifikues të rasteve të trajtimit si dhe kërkon që ai të luajë edhe rol mbrojtës të rasteve të torturës ose keqtrajtimit të tjera nëse është e nevojshme.

Përzgjedhja e mënyrës së veprimit të Mekanizmit është qasje institucionale, por rekomandohet dhe në udhëzimet²⁰ e Nënkomitetit për

19 Po aty.

20 "Guidelines on national preventive mechanisms", Gjenevë, 15 -19 dhjetor 2010, për më shumë http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Doenload.aspx?symbolno=CAT/OP/12/5&Lang=en

Parandalimin e torturës (SPT)²¹ që roli i MKPT-së të jetë me një qasje sa më gjithëpërfshirëse.²² Roli mbrojtës realizohet nëpërmjet verifikimeve të ankesave ose rasteve me iniciativë, hetimit administrativ dhe në raste të evidentimit të rasteve të torturës, adresimit të rekomandimit për kallzim penal pranë organit të akuzës.

Vizitat parandaluese e bëjnë të mundur që MKPT të identifikojë faktorët e rrezikut, të analizojë përgjegjësitë sistemike ose rastet e dështimeve, dhe të propozojë rekomandime duke adresuar origjinën për shkakun e rasteve të torturës dhe keqtrajtimeve të tjera²³.

Mekanizmi Kombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandime organeve përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues me qëllim promovimin e respektimit të vazhdueshëm të të drejtave, si edhe përmirësimit të standardeve të trajtimit të tyre.²⁴

Mekanizmi Kombëtar në Shqipëri nën frymën e OPCAT, ka disa kompetenca²⁵, si: vëzhgimin rregullisht të trajtimit të personave, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e tyre nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër çnjerëzor ose poshtërues; adresimi i rekomandimeve tek organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e personave, që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi

21 Nënkomiteti për parandalimin e Torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe degraduese ose ndëshkuese, Kombet e Bashkuara

22 “Guidelines on national preventive mechanisms”, Gjenevë, 15 -19 dhjetor 2010, për më shumë http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CAT/OP/12/5&Lang=en

23 Optional Protocol to the UN Convention against Torture Implementation Manual, 2010, Association for the Prevention of Torture (APT) and InterAmerican Institute for Human Rights (IHR).

24 Gjonaj (Saliu), E. “Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut si Mekanizma kombëtarë për parandalimin e torturës, arritjet dhe sfidat Modelet në disa vende të Evropës”, vepër e cituar, fq.566.

25 Neni 4 i Protokollit Opsional, (OPCAT). Për më shumë shih <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/OPCAT.aspx>

i egër çnjerëzor dhe poshtëruës, duke marrë parasysh normat përkatëse të Kombeve të Bashkuara; bërjen e propozimeve për përmirësime në legjisllacionin ekzistues dhe/ose nevojën për hartimin e rregullave të reja.

Analiza e raporteve të veprimtarisë dhe rasteve të trajtuara nga MKPT-së gjatë periudhës 2012 – 2016, dëshmon se veprimtaria parandaluese për rastet e torturës dhe keqtrajtimit ka qenë konstante, ndërsa funksioni mbrojtës është zbehur. Fillimisht struktura e Mekanizmit kishte nevojë të rritej dhe të forcohej në ngritjen e kapaciteteve dhe në krijimin e një stafi shumëdisiplinar, të cilat u realizuan në vitin 2013. Por pavarësisht kësaj, roli mbrojtës i personave të privuar nga liria të cilët pretendonin për torturë ose keqtrajtim pësoi një zbehje ndër vite, jo vetëm në aspektin sasior por edhe atë të identifikimit dhe të adresimit të rekomandimeve specifike për vendosjen përpara përgjegjësisë të stafit të institucioneve që kryenin shkelje. Analiza sasiore e rasteve të trajtuara nga MKPT tregon se ky mekanizëm ka kryer ndër vite një numër të përafërt të inspektimeve, riinspektimeve dhe vizitave në të gjitha vendet e privimit të lirisë. Më të pakta kanë qenë ato kontrole me tematikë të veçantë, e cila shpeshherë evidenton në mënyrë më të thelluar dhe ezauruese problematikën e evidentuar.

Në referim të Udhëzimeve të Nënkomitetit për parandalimin e torturës²⁶, Mekanizmat kombëtar, anëtarët dhe stafi i tij, duhet të mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt të rishohin metodat e tyre të punës dhe të ndërmbarrë trajnime dhe ngritje kapacitetesh për stafin me qëllim rritjen e kapaciteteve për ushtrimin e përgjegjësive sipas Protokollit Opsional.

Udhëzimet e Nënkomitetit kundër Torturës (SPT), të Kombeve të Bashkuara, nuk përcakton numër inspektimesh, vizitash ose kontrole me tematikë të veçantë duhet të kryejë një mekanizëm, por pavarësisht kësaj përcaktohet detyrimi i Mekanizmit në mënyrë të qartë, për përgatitjen e një plani

26 Shih pikën 31 të “Guidelines on national preventive mechanisms”, Gjenevë, 15 -19 dhjetor 2010, për më shumë http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CAT/OP/12/5&Lang=en

pune për monitorimin e institucioneve dhe vëndeve ku privohet liria, ashtu siç parashikohet edhe në nenin 4 dhe 29 të Protokollit Opsional. Gjithashtu Mekanizmi kombëtar, duhet të planifikojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij dhe ti përdorë ato në mënyrë efikase me qëllim që të sigurohet vizitat dhe monitorimi në të gjitha vendet ku privohet liria dhe me një frekuencë të mjaftueshme me qëllim që të bëhet efektive parandalimi i torturës dhe i keqtrajtimit²⁷. Ajo që evidentohet, në fakt nga studimi i një sërë raporteve të Mekanizmit Kombëtar të vendit tonë, rezulton se Mekanizmi Kombëtar i kryen inspektime dhe vizita të shumta, por të cilat vitet e fundit kanë ardhur në rënie.²⁸

MKPT-ja në praktikën e punës së tij, adreson rekomandimet përkatëse drejtuar Institucioneve penitenciare, komisarateve të policisë, spitaleve psikiatrike, prokurorive dhe të tjera. Rekomandimet dhe ndërhyrjet e MKPT-së ndër vite kryesisht janë fokusuar në masat që duhen marrë për respektimin dhe përmirësimin e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve, në plotësimin e nevojave të tyre jetësore, shëndetësore dhe arsimore. Gjithashtu, një sërë rekomandimesh janë adresuar me synimin për kryerjen e investimeve të brendshme infrastrukturore, plotësimin e organikës me punonjës dhe në disa raste edhe për mbylljen e institucioneve të cilat nuk plotësojnë kushtet minimale të jetësës për personat e privuar nga liria.²⁹

Bazuar në Udhëzimet e Nënkomitetit kundër torturës (SPT),

27 Shih pikat 32, 33, 34, 35 të Guidelines on national preventive mechanisms”, Gjenevë, 15 -19 dhjetor 2010, për më shumë http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Doenload.aspx?symbolno=CAT/OP/12/5&Lang=en

28 Gjatë vitit 2012, MKPT ka kryer 125 inspektime, riinspektime, kontrolle me tematikë të veçantë dhe vizita në të gjitha vendet e privimit të lirisë. Në vitin 2013 ka kryer 108, në vitin 2014 rreth 115 inspektime, në 2015 rreth 130 inspektime, dhe në 2016 vihet re një rënie, në total rreth 90 inspektime.

29 Shih Avokati i Popullit, “Raport vjetor i Mekanizmit Kombëtar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, të viteve 2012 – 2015”. Për më shumë shihni <http://ëëë.avokatipopullit.gov.al/sq/raporte-0>

Mekanizmat Kombëtar duhet të përgatisin raporte pas çdo vizite ose monitorimi të kryer në institucionet ku privohet liria, ashtu si dhe detyrimi për të përgatitur raportin vjetor si dhe çdo formë tjetër raporti kur shihet se është e nevojshme. Në ato raste kur shihet e nevojshme, Raportet duhet të përmbajnë rekomandime konkrete që i adresohen Institucioneve përgjegjëse. Rekomandimet e Mekanizmit Kombëtar duhet të mbajnë në konsideratë standartet e Kombeve të Bashkuara si dhe komentet dhe rekomandimet e Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës në fushën e parandalimit të torturës dhe çdo trajtimi tjetër mizor, çnjerëzor dhe degradues.

Vihet re se numri i rekomandimeve të Mekanizmit Kombëtar në 5 vitet e fundit është pothuajse në të njëjtat tregues. Në vitin 2012, Mekanizmi ka adresuar gjithsej 54 rekomandime, 2013 rreth 55 rekomandime, në vitin 2014 janë adresuar 81 rekomandime, 2015 rreth 76 dhe në vitin 2016 vihet re një rënie e numrit të rekomandimeve me 46. Pavarësisht se në Udhëzimet e SPT-së ose mekanizmave të tjerë ndërkombëtare nuk parashikohet një numër i rekomandimeve që duhet të adresojnë Mekanizmat kombëtare ose raste specifike, rezulton se numri është i vogël krahasimisht me disa vende të tjera të ngjashme me specifikat e Institucioneve tona penitenciare. Vlen të theksojmë se disa nga faktorët që kanë ndikuar në rënien e numrit të rekomandimeve vitin e fundit, mund të jenë disa, si psh përmirësimi i gjëndjes së respektimit të të drejtave të njeriut si dhe përmirësimi i legjislacionit përkatës. Kjo kërkon tregues të qartë me qëllim që të evidentohen që gjëndja e respektimit të të drejtave të njeriut është përmirësuar.

Një mjet mjaft i mirë kontrollit që duhet të përdoret në mënyrë sistemike nga Mekanizmi, është monitorimi i zbatimit në mënyrë të vazhdueshme të Rekomandimeve të mëparshme të adresuara. Nëse rezulton se një pjesë e mirë e tyre janë zbatuar, atëherë kemi të bëjmë me një përmirësim të situatës të të drejtave të dënuarve dhe të paraburgosurve në institucionet e mbyllura.

Grupi i dytë i faktorëve që ndikojnë në numrin e rekomandimeve, janë ato që lidhen me vetë funksionimin e brendshëm të Mekanizmit, si psh rritja e kapaciteteve të stafit në mënyrë të vazhdueshme, rishikimi i metodologjisë së punës së Mekanizmit bazuar kjo edhe në kërkesat

e Udhëzimeve të SPT-së, objektivat dhe çështjet të cilat do të jenë më shumë në vëmendjen e Mekanizmit, si dhe buxheti që ka në dispozicion Mekanizmi. Nëse në grupin e parë monitorimi ishte më i vështirë për shkak të mungesës së treguesve të qartë, në grupin e dytë të faktorëve, arrihet më kollaj të identifikohen treguesit.

Mekanizmi Kombëtar në mënyrë të vazhdueshme ka paraqitur nëpërmjet raporteve të tij, ngirtjen e kapaciteteve të stafit në trajnime brenda dhe jashtë vendit, mbajtjen në mënyrë të rregullt të kontakteve me SPT dhe Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës (CPT), mbajtjen në mënyrë të rregullt të kontakteve midis Mekanizmave të vendeve të tjera, pjesëmarrjen në vizita studimore dhe shkëmbime përvojë.

Një faktor i rëndësishëm që ndikon në rekomandimet që adresohen dhe jo gjithmonë e matur në aspektin sasior por edhe atë cilësor, është përditësimi dhe rishikimi në mënyrë të vazhdueshme i metodologjisë së punës së Mekanizmit, përzgjedhja e çështjeve tematike të cilave mund t'u kushtohet vëmendje e veçantë. Këto mund të jenë disa nga faktorët që kanë ndikuar në uljen e numrit të rekomandimeve të Mekanizmit kombëtar.

Ajo që vihet re nga pothuajse të gjitha raportet, pavarësisht specifikime të nenit 4 të Protokollit Opsional, lidhur me objektin e veprimtarisë së Mekanizmave, Mekanizmi Kombëtar në Institucionin e Avokatit të Popullit e ka kryer veprimtarinë e tij në format më klasike të veprimit të një Mekanizmi. Disa Mekanizma të tjera në vendet e Evropës dhe në botë, kanë kryer një sërë veprimtarish monitoruese dhe në spitale, kryesisht në departamentet e senatoriumit ose atij paliativ brenda sistemit spitalor, duke e konsideruar si vënde ku personat privohen nga liria ashtu si shumica e pacientëve nuk japin pëlqimin për t'u shtruar ose trajtuar në këto institucione. Ky është rasti I MKPT-së Ukrainase, I cili në modelin “*Ombudsman Plus*”, ka qënë inovator dhe në target grupet e përzgjedhura.³⁰

30 Association for prevention of torture, “Putting prevention into practice 10 years on: the Optional Protocol to the UN Convention against Torture”, 2016; http://www.apt.ch/content/files_res/putting-prevention-into-practice-opcat10.pdf

Vizitat dhe inspektimet në spitalet psikiatrike, janë veprimtari dhe funksionë që kryhen edhe nga Mekanizmi kombëtar pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri, por ajo që për të cilën po kërkojnë vendet e tjera, si Franca³¹ në monitorimet që kryejnë janë rastet e abuzimit ndaj këtyre kategorive. Nga raportet e Mekanizmit evidentohet se rekomandimet e adresuara konsistojnë më shumë për përmirësimin e infrastrukturës, shtimin e burimeve njerëzore, specialistëve, etj.

Të rralla kanë qënë rastet kur MKPT ka kërkuar fillimin e hetimeve organit të akuzës për përdorimin e mjeteve të forcës në kundërshtim me ligjin, për trajtim çnjerëzor e degradues në kuptim të nenit 3 të KEDNJ-së dhe të Konventës së Kombeve të bashkuara për torturën, etj. Për këtë arsye, Mekanizmi pranë Avokatit të Popullit duhet të mbajë në konsideratë praktikat më të mira të vendeve të tjera që po ndiqen nga Mekanizmat në vendet e tjera të Evropës.

Sipas Udhëzimeve të SPT-së, Mekanizmi Kombëtar duhet të tregojë dhe të sigurojë që ka kapacitete, për t'u angazhuar në një proces kuptimplotë dialogu me institucionet shtetërore lidhur me zbatimin e rekomandimeve të tij. Gjithashtu kërkon që të ndiqen në mënyrë aktive dhe një përditësim i rekomandimeve të adresuara nga SPT për vendin tonë në mënyrë të vazhdueshme.³²

“Të bësh të padukshmen të dukshme”, kjo duhet të jetë një udhërrëfyes për të gjithë Mekanizmat.³³ Duke mbajtur në konsideratë, zhvillimet e fundit me refugjatët, azilkërkuesit, etj, në fokusin e punës të Mekanizmave u përfshinë dhe grupet vulnerabël siç janë refugjatët dhe

31 Po aty,.

32 Shih pikat 32, 33, 34, 35 të “*Guidelines on national preventive mechanisms*”, Gjenevë, 15 -19 dhjetor 2010, për më shumë http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CAT/OP/12/5&Lang=en

33 Association for prevention of torture, “*Putting prevention into practice 10 years on: the Optional Protocol to the UN Convention against Torture*”, 2016; http://www.apt.ch/content/files_res/putting-prevention-into-practice-opcat10.pdf

azilkërkuesit, duke sjellë kështu një perspektivë të re në veprimtarinë e Mekanizmave. Pikërisht, duke sjellë eksperiencën e Mekanizmit Kroat³⁴, ata gjatë kësaj periudhe, inspektuan dhe vizituan pikat e kalim kufirit, stacionet e trenit, stacionet e policisë, qendrat e regjistrimit dhe qëndrimit të refugjatëve, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë trajtimit të tyre.

Mekanzimi Kombëtar, duhet të ketë objekt të punës së tij jo vetëm parandalim të torturës, por edhe mbrojtje të viktimave të saj. Mbrojtja e individëve të cilët kanë pësuar torturë ose forma keqtrajtimi është një aspekt me rëndësi në fushën e mbrojtjes së të drejtave të viktimave

Protokolli Opsional parashikon si mbrojtjen e viktimës si kompetencë të Mekanizmit, pavarësisht me rezervën e përmendur se kur shihet e nevojshme. Praktika tregon se pandëshkueshmëria e rasteve të përdorimit të torturës bën që fenomene të tilla të shtohen. Besimi në ndalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit zhvlerësohet sa herë që punonjësit e policisë që ushtrojnë dhunë nuk vihen para përgjegjësitë për veprimet e tyre. Përveç zbatimit të ligjit dhe ndëshkueshmërisë së personave që kryejnë veprë penale, një mesazh i tillë e siguron publikun e gjerë se askush nuk qëndron mbi ligjin, madje as ata që janë përgjegjës për zbatimin e tij.

Raportet e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm të të drejtave të personave të privuar nga liria vënë në pah se këta të fundit përballen me një serë problemesh. Nga ana tjetër, personat e proviuar nga liria kanë kufizime të të drejtave të parashikuara nga ligji, por shpesh edhe në mënyrë subjektive nga personeli i institucioneve.

Është detyrë e shtetit të marrë masa për të rritur aksesin e personave të privuar te mekanizmat e mbrojtjes së tyre. Aksesin mund të ofrohen mes mjeteve të ndryshme; takimi me avokatin, më të afërm, persona të tjerë që ligji i njeh³⁵, e drejta e korrespondencës me organizata të të drejtave të njeriut³⁶. Një nga mjetet që mund të ndikojë në rritjen e aksesit e të dënuarve tek Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, është

34 Po aty.

35 Neni 8, 40, 41 i ligjit nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar

36 Hysi. V, Penologjia, Kristina KH, Tiranë, 2015, fq.230 -231.

vendosja në çdo institucion të mbyllur të kutive postare për mbledhjen e ankesave.

Ligji u njeh të drejtën personave të paraburgosur dhe të dënuar që të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme në formën që përcakton ligji dhe në mënyrë individuale. Kërkesat dhe ankesat mund t'ju drejtohen organit kompetent të institucioneve penitenciare por kur të paraburgosurit ose të dënuarit e çmojnë me vend mund t'i drejtohen cilitdo organ shtetëror ose organizatë joqeveritare brenda dhe jashtë vendit³⁷.

Shqetësuese, konsiderohet që vit pas viti, ka një rënie të ndjeshme të numrit të ankesave që adresohen dhe trajtohen nga Mekanizmi. Ankesat të cilat vijnë në adresë të Mekanizmit shërbejnë jo vetëm për të trajtuar problematikën që ato përcjellin por gjithashtu dhe për të gjeneralizuar problemet në institucionet e mbyllura, të cilat më pas shërbejnë në organizimin e inspektimeve tematike ose të planifikuara në institucionet përkatëse.

Një sërë faktorësh në uljen e numrit të ankesave mund të ndikojnë; si psh mungesa e besimit tek Institucioni i Avokatit të Popullit në zgjidhjen e ankesave; mungesa e komunikimit verbal me administratën e institucioneve penitenciare³⁸, për shkak të ekzistencës së komunikimit horizontal midis të dënuarve ku njihet "leadershipi" midis të dënuarve³⁹. Komunikimi me avokatin dhe me familjarët gjithashtu mund të ndikojë në adresimin e problematikave pa angazhimin e Mekanizmit kombëtar.

Ulja e numrit gjithashtu mund të nxjerrë në disa përfundime, të cilat lidhet me përmirësimin e situatës së keqtrajttimeve dhe torturës, por edhe me mungesën e përvojës profesionale të vetë stafit të Mekanizmit për të

37 Neni 8 i ligji nr.8328, datë 16.4.1998 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", i ndryshuar

38 Bregu, Z., "*Të dënuarit mes izolimit, informimit dhe nevojës për komunikim*", Dizertacion për gradën doktor shkencash viti 2013, Universiteti i Tiranës, Fakulteti I Historisë dhe Filologjisë. Për më shumë shih "<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/ëp-content/uploads/2013/08/Doktoratura-Zylyftar-Bregu-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Gazetarise.pdf>

39 Po aty, vepër e cituar

evidentuar rastet e keqtrajtimit ose rasteve të dhunës.

Po të marrim në studim numrin e ankesave të 5 viteve të fundit të Mekanizmit, rezulton se ka një rënie të ndjeshme të tyre. Gjatë vitit 2012⁴⁰ ka trajtuar rreth 181 ankesa të personave të privuar nga liria, kryesisht nga burgjet, paraburgimet dhe komisariatet, në vitin 2013⁴¹ dhe 2014⁴² pothuajse numri është i njëjtë. Ajo që vihet re është se në dy vitet e fundit 2015 dhe 2016 numri i ankesave ka një rënie të ndjeshme përkatësisht 42⁴³ dhe 76 ankesa⁴⁴.

Shkaqet mund të jenë sa për shkak të funksionimit të Mekanizmit aq edhe për shkak të funksionimit të mekanizmit të kërkesë ankesës. Por pavarësisht kësaj, rezultate të shkaqeve mund të na japin realizimi i pyetësorëve në institucionet penitenciare me personat e dënuar dhe të paraburgosur ashtu si dhe me stafin. Pavarësisht kësaj një fakt është i rëndësishëm për t'u përmëndur, që mekanizmat monitorues janë ngritur me qëllim që ata të bëjnë vizita dhe monitorime të rregullta, të palajmëruara dhe të kontribuimin e parandalimit të rasteve të abuzimit. Mundësia që këto vizita të bëhen në mënyrë të vazhdueshme, të palajmëruara rrit mundësinë që rastet abuzive të keqtrajtimit ose torturës të identifikohen.

Me qëllim parandalimin, misionin bazë që ka një Mekanizëm Kombëtar është që nëpërmjet vizitave në institucionet penitenciare, të identifikojnë faktorët e rrezikut të cilët mund të kthehen në raste torture ose keqtrajtimi, si dhe duhet të identifikojnë në mënyrë sistematike

40 Raporti i vitit 2012 për veprimtarinë e MKPT-së, <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/2014-Raporti%20i%20NPM%20shqip%20final.pdf>

41 Raporti i vitit 2013 për veprimtarinë e MKPT-së, http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/2014-05-19%20ALB%20-%20Raporti%20per%20publikim%20PDF%20i%20MKPT%202013_final.pdf

42 Raporti i Raporti i vitit 2014 për veprimtarinë e MKPT, <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/2014%20Raporti%20i%20Posa%23U00e7%23U00ebm%20i%20MKPT.pdf>

43 Raporti i vitit 2015 për veprimtarinë e MKPT, për më shumë shih http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/RAPORTET/RAPORTE_TJERA/2015%20Draft%20Raporti%20Vjetor%20i%20MKPT.pdf

44 Të dhënat për vitin 2016, të dhëna të pabotuara

parregullsitë e identifikuar. Të gjitha këto do të kontribuojnë në të ardhmen në parandalimin e rasteve të abuzimit⁴⁵. Kjo gjithashtu do të rrisë edhe besimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve tek Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës për tju drejtuar në të gjitha rastet e keqtrajtimeve dhe torturës.

Nëse i referohemi veprimtarisë së Mekanizmit të Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë 5 viteve të fundit, rezultojnë se për të gjitha rastet e pretenduara, që janë konsideruar si të drejta, janë adresuar rreth 36 rekomandime⁴⁶. Analiza e tipologjisë së keqtrajtimeve të evidentuara është se vendin e parë e zënë rastet e ushtrimit të dhunës fizike ose keqtrajtimi. Një numër i lartë rekomandimesh për fillimin e hetimeve ndaj punonjësve evidentohet në vitin 2012, duke ardhur në rënie në vitet pasuese. Kjo edhe për shkak se rastet e dhunës klasike në institucionet ku privohet liria po vijnë duke u pakësuar, por forma të tjera të torturës, më të vështira për t'u vërtetuar vazhdojnë të mbeten persistente.⁴⁷

Nga studimi i raporteve të Mekanizmit kombëtar, rezultojnë se në vitin 2012, Mekanizmi ka filluar hetimin administrative me iniciativë të rasteve të bëra publike në media për ushtrimin e dhunës fizike ndaj qytetarëve prej punonjësve të Policisë së Shtetit në mjediset e Policisë, ose jashtë tyre. Kjo risi sa i përket qëndrimit të mbajtur nga Avokati i Popullit, për zgjerimin e hetimit në lidhje me përgjegjësinë edhe të personave të tjerë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës nga drejtuesit

45 Platforma Reforma Penale, për më shumë shih <https://www.penalreform.org/priorities/torture-prevention/preventive-monitoring/>

46 Nga raportet vjetore të MKPT-së për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 të bëra publike në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit dhe të dhënat e vitit 2016 (të pabotuara), rezultojnë se në sa raste janë bërë rekomandime drejtuar organit të akuzës. Në vitin 2012 – 18 rekomandime, 2013 – 5 rekomandime, 2014 – 8 rekomandime; 2015 – 9 rekomandime; 2016 - 3 rekomandime

47 Për vitin 2012, rezultojnë se për veprën penale të Torturës (neni 86 I Kodit penal) janë adresuar 8 rekomandime, 9 rekomandime për kryerjen e Veprës penale të veprimeve arbitrare (Neni 250 KP), dhe 1 për shpërdorim detyre. vitin 2012, ku në total janë adresuar 18 rekomandime për fillimin e hetimeve për punonjësit e institucioneve ku është privuar liria në një kohë që për vitin 2016 rezultojnë vetëm 3 rekomandime për ushtrim dhune ose keqtrajtim.

e Policisë në dëm të qytetarëve. Duke pasur parasysh detyrimin ligjor të punonjësve të policisë, që nuk kanë marrë masa për të ndërprerë gjendjen e paligjshme, organit të Prokurorisë i është rekomanduar ndaj tyre fillimi i hetimit për veprën penale, “*Mos marrja të masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme*”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.⁴⁸ Nga raportet e studiuara, rezulton se vitet e fundit, rastet me iniciativë kanë një ulje nga ana e Mekanizmit, duke mos e shfrytëzuar mjaftueshëm mjetet ligjore në dispozicion. Ndjekja e rasteve me iniciativë, i jep mundësinë Mekanizmit që të mbrojë jo vetëm të drejtën e një individi por të bëjë edhe parandalimin si dhe mbrojtjen e një grupi më të gjërë individësh.

Rastet e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t’u provuar si edhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, sepse ato kryhen në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë, në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare, por edhe në rastet kur ka të tillë, është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë⁴⁹. Ekziston edhe frike hakmarrjeje tek qytetaret për ti denoncuar rastet e dhunës, si dhe pasiguri e mosbesim në ndjekjen e tyre nga organet e drejtësisë. Që të mundësohet vërtetimi i dhunës policore është e nevojshme që, ankesa të bëhet sa më shpejtë, kur pasojat e saj janë ende të dukshme dhe ndërkohë, duhet bërë hetimi administrativ në vend.⁵⁰

Nga pikëpamja krimnologjike dhe parandalimit të rasteve të keqtrajtimit ka interes njohja e subjekteve që ushtrojnë keqtrajtimit dhe profili i tyre. Nga të dhënat e publikuara në raportet e Institucionit të Avokatit të Popullit, rezulton se, punonjësit e Policisë së Shtetit të përfshirë rastet e torturës dhe keqtrajtimit, për nga hierarkia janë punonjës zbatues të nivelit të ulët dhe të mesëm, sikurse mund të përmendim punonjësit e patrullës së përgjithshme, specialistët e policisë së zonave dhe inspektorët e policisë kriminale (*oficerët e policisë gjyqësore*)⁵¹.

48 Raport për vitin 2012 i MKPT-së, <http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/raporte-0>

49 Këshilli i Evropës, “*Një udhëzues për implementimin e nenit 3 të KEDNJ-së – Ndalimi i Torturës*”

50 Po aty.

51 Po aty.

Në vetvete, rastet e torturës dhe keqtrajtimit, nuk janë thjesht disa standarte në të cilat mund ti referohet edhe Mekanizmi Kombëtar gjatë veprimtarisë së saj parandaluese dhe mbrojtëse. E gjithë kjo ka të bëjë me mënyrën se si stafi drejtues por edhe ai zbatues i MKPT-së duhet të kuptojë realisht se ndodh, në cilin drejtim dhe në cilat forma po realizohet keqtrajtimi dhe tortura, dhe praktikisht të identifikojë se çfarë mund të bëhet për t'i adresuar ato. Pikërisht ka të bëjë me rekomandimet që duhen adresuar e cila përbën një ndryshim shumë të madh nga rekomandime me sugjerime praktike që janë reale dhe të zbatueshme si shëmbull *që rastet e dhunës ose keqtrajtimet nuk duhet të ndodhin më*. Pikërisht kjo kërkon jo vetëm punë profesionale, por gjithashtu kërkon të menduar në mënyrë inovatore dhe krijuese, duke bërë dallimet nga një rast në tjetrin. Sot një formë e përhapur keqtrajtimi dhe torture është ajo psikologjike, e cila mbart vështirësi në faktimin e saj por njëkohësisht edhe për shkak të formave të ndryshme që realizohet.

Në disa rekomandime të Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së, është evidentuar se rekomandimi nuk ka patur një përmbajtje konkrete lidhur me shkëlqen e pretenduar për ushtrim dhune ose keqtrajtim, por i është adresuar Institucionit përgjegjës për verifikimin ose ndjekjen e rastit. Në rast se do të ishte kështu, dhe do të kishim një MKPT deleguese për kompetencë të rasteve, atëherë nuk është e drejtë të ketë kompetenca aq të gjëra dhe gjithëpërfshirëse në ligj, duke përfshirë në procedurë dhe hetimin administrativ.

MKPT-të në vende të ndryshme, përfshirë edhe në ato të Evropës, kanë filluar të përshtasin mandatin e tyre në bazë të problematikave që evidentohen dhe mënyrës së evoluimit të rasteve të torturës dhe formave të keqtrajtimit. Për shëmbull, Mekanizmi Kombëtar në Mbretërinë e Bashkuar nëpërmjet një protokollit të nënshkruar midis palëve, ka marrë përsipër që të trajtojë edhe të mbrojtë nga sanksionet çdo person që ndodhet në vendet me liri të privuar.⁵²

52 Putting prevention into practice 10 years on: the Optional Protocol to the UN Convention against Torture, Association for prevention of torture, 2016; http://www.ap.t.ch/content/files_res/putting-prevention-into-practice-op-cat10.pdf

Një nga mjetet e mbrojtjes së viktimave të keqtrajtimit dhe parandalimit të rastave të tilla ë rë ardhmen është fillimi i hetimeve nga organi i akuzës. Cilësia dhe kapacitetet e hetimit dhe procedimit penal luan një rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e torturës. Në rastet kur aftësia për hetimin e veprave të ndryshme penale mungon, atëherë organi i akuzës është më i prirur që çështjen ta zgjidhë duke marrë deklaramë nën ushtrimin e dhunës ose keqtrajtimit⁵³.

Nga studimi i rasteve të keqtrajtimit në Shqipëri, sipas raportit të vitit 2015 ka adresuar rekomandime organit të akuzës, si në rastet kur është rekomanduar fillimi i hetimit për veprën penale të torturës (neni 86 i Kodit Penal) ashtu edhe në rastin për “veprime arbitrare” sipas nenit 250 të kodit penal, nuk merren në studim dhe në analizim elementët e veprave penale.

Për këtë arsye, rekomandimet e mekanizmave kanë një rëndësi të veçantë. Ato duhen jo vetëm të paraqesin qartë argumentat dhe elementët të cilat e kanë referuar Mekanizmit të kërkoj në një rast fillimin e hetimit për veprën penale të torturës, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal dhe në rastin tjetër fillimin e hetimit për veprën penale të veprimeve arbitrare, të parashikuar nga neni 250 i Kodit penal.

Nga analiza e rekomandimeve të MKPT-së, vihet re se për elementë të njëjtë të evidentuar nga raportet e inspektimit, ose provave të evidentuara, rezultojnë se janë rekomanduar fillim hetimi të veprave penale të ndryshme. Mekanizmi në mënyrë të vazhdueshme duhet t’i referohet nenit 3 të KEDNJ-së si dhe jurisprudencës së GJEDNJ për elementët dhe veprimet që përbëjnë torturë ose formë keqtrajtimi.

Në mënyrë të shpeshtë, Mekanizmi e ka referuar gabim Prokurorisë, veprën penale për të cilën kërkon fillimin e hetimeve, duke e bërë kështu pothuajse të pamundur ndëshkueshmërinë e punonjësve të policisë ose institucioneve të tjera. Kjo edhe për faktin se edhe në rastet kur rekomandohet nga Institucioni i Avokatit të Popullit për fillimin e procedimit penal për veprën penale të torturës, Prokuroria vendos ose mosfillim të procedimit ose pushim, por ka patur raste që ka ndryshuar tërësisht kualifikimin e veprës penale, si nenin 250 të Kodit penal “*veprime arbitrare*”, duke mbajtur në konsideratë që dënimit për këtë

53 Platforma Ndërkombëtare e Reformës Penale, për më shumë shih <https://ëëë.penalreform.org/priorities/torture-prevention/preventive-monitoring/>

vepër penale është shumë i ulët në krahasim me nenin 86 të KP. Kjo kërkon rishikimin e mundësive procedurale ose materiale për ndjekjen e çështjes nga Avokati i Popullit më tej, me qëllim jo vetëm rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur por edhe hapjen e praktikës, në një kohë që vendimet gjyqësore për veprën penale të Torturës janë inekzistente duke e bërë kështu një ndër nenet më të papërdorura të Kodit penal.

Nga studimi i raporteve dhe informacioneve të tjera të MKPT-së, rezulton se Avokati i Popullit nuk e kundërshton në të gjitha rastet vendimin e prokurorisë për mosfillim, pushim ose ndryshim të kualifikimit të veprës penale në Prokurorinë e Përgjithshme, si autoriteti më i lartë hierarkik. Gjithashtu rezulton se Mekanizmi nuk e ka kundërshtuar në asnjë rast vendimin e prokurorisë në gjykatë.

Nëse Mekanizmi do të veprojë me profesionalizëm, të ushtrojë të gjitha kompetencat që i jep legjislacioni i brendshëm dhe akteve ndërkombëtare si dhe të shfrytëzojë të gjitha mundësitë ligjore për evidentimin dhe ndjekjen e rasteve të torturës dhe keqtrajtimit, kjo do të ndikojë në uljen e rasteve të torturës dhe llojet e keqtrajtimit si dhe në rritjen e rasteve të identifikuar dhe të ankimuara në organet e gjyqësorit.

Kur në Shqipëri, ende nuk është ndërtuar Institucion për sistemin dhe trajtimin e personave me probleme ose çrregullimeve të shëndetit mendor. Kjo përbën në vetvete një shqetësim të madh dhe ka pasoja për vetë personat e sëmurë, për pjesën tjetër të personave të privuar nga liria dhe personit, por edhe për vetë sigurinë në institucion. Qëndrimi dhe mbajtja e këtyre personave me vendim gjykate "*masë mjekësore në një Institucion psikiatrik*", përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Në interpretimin e zgjeruar të KEDNJ-së ashtu si dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së rezulton se kjo përbën një shkelje të nenit 3 të Konventës, duke e konsideruar si trajtim çnjërrëzor dhe degradues. Pavarësisht bërjes të rekomandimeve në drejtim të kushteve në të cilën ndodhen këta persona me masa mjekësore, qasja e MKPT-së duhet të ishte më reaktive në drejtim të konstatimit të shkeljes së nenit 3 të KEDNJ-së, duke marrë në konsideratë mënyrat e reagimit të Mekanizmave të tjerë si motra në Europë.⁵⁴

54 Gjonaj, E, "Book of proceedings 2-d ICIS Second International Conference on: "Interdisciplinary Studies"

Rekomandimet janë të nevojshme, por jo të mjaftueshme për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimeve.

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të mekanizmit nga Institucionet që i drejtohet rekomandimi është me rëndësi, kjo edhe në zbatim të Udhëzimeve të SPT për detyrat dhe përgjegjësitë e Mekanizmave Kombëtare. Sipas këtyre udhëzimeve, Mekanizmi në mënyrë të vazhdueshme duhet të bisedojnë me institucionet përkatëse për të konkluduar në ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të adresuara. Duke marrë shkas edhe nga raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë të vit pas viti, rezulton se ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të adresuara bëhet jo në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente.

3.0 Përfundime dhe sugjerime

Krijimi i mekanizmave të brendshëm kanë një rëndësi të veçantë për shkak të ndërtimit të sistemit të referimit të ankesave dhe të shkeljeve të të drejtave të personave të dënuar dhe të paraburgosurve. MKPT ka ndikuar pozitivisht në respektimin e të drejtave të njeriut, duke jo vetëm parandaluar rastet e keqtrajtimit dhe të torturës, por njëkohësisht duke adresuar pranë organit të akuzës rastet e provuara për keqtrajtim ose torturë.

Duke mbajtur në konsideratë, përhapjen e madhe dhe format komplekse që paraqet neni 3 i Konventës Evropiane, duhet që Mekanizmat e brendshëm dhe kryesisht Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës të jetë më efikas në parandalim dhe në mbrojtjen e rasteve të keqtrajtimit.

Duke qene se mënyrat e keqtrajtimit, dhunës dhe torturës bëhen më të vështira dhe sfiduese për t'u identifikuar kjo edhe për shkak të formave më të sofistikuara të kryerjes së tyre nga administrata e institucioneve. është e nevojshme që MKPT-së të përfshihen në trajnime bashkëkohore me qëllim marrjen e informacionit të rëndësishëm por edhe përfundimit të aftësive për hetimin administrative të rasteve të pretenduara për torturë. Trajnimi i stafit të MKPT është një kërkesë gjithashtu dhe në Udhëzimet për Mekanizmat për parandalimin e torturës, të SPT-së.

Në metodologjinë e punës së MKPT-së duhet të përfshihen të gjitha kriteret dhe rastet e konsideruara nga GJEDNJ nën nenin 3 të KEDNJ-

së, duke përmëndur këtu, kushtet dhe infrastrukturën në institucionet penitenciare, mbipopullimi, trajtimi, cilësia dhe përshtatshmëria e shërbimeve sidomos ato shëndetësore, kërjerja e procedurave sipas protokollove të ratifikuara nga administrata në rastet e pretenduara për keqtrajtimi ose dhunë të ushtruar, etj. Rishikimi i metodologjisë së punës së saj gjithashtu është kërkesë e Udhëzimeve për Mekanizmat për parandalimin e torturës, të SPT-së (*Nënkomiteti për parandalimin e torturës dhe trajtime dhe dënime të tjera çnjerëzore dhe degraduese, 2010, Zvicër*).

Për një mbrojtje më të mirë të të drejtave të njeriut, mekanizmi gjithshu duhet të shfrytëzojë edhe ato mjete ligjore të cilat nuk janë detyruese por orientojnë vendimmarrjen, siç janë opinionet e treta pranë GJEDNJ-së, amicus curiae në sistemin gjyqësor vendas si dhe në Gjykatën Kushtetuese, raportet hije pranë mekanizmave ndërkombëtare në të cilat shteti raportton, etj.

Inspektimet dhe riinspektimet tematike për trajtimin e problematikave të ndryshme janë një instrument efektiv për evdientimit dhe parandalimin e rasteve të keqtrajtimit

Evidentimi dhe bërja publike e tyre nuk do të mjaftonte nese mekanizmat nuk adresojnë rekomandime më të qarta, të matshme, të zbatueshme duke argumentuar qartë shkeljet, sidomos ato rekomandime që lidhen me rastet e torturës dhe keqtrajtimeve. institucioneve shtetërore, dhe të ndjekë zbatimit e tyre

Në përpjekje për të rritur rolin e MKPT-së parandalues dhe mbrojtës, duhet të rritet numri i trajtimit të ankesave për rastet e torturës dhe keqtrajtimit për personat e privuar nga liria, duke e zgjeruar gamën e subjekteve që i drejtohen MKPT-së.

Duke mbajtur parasysh vështirësitë e hetimit të rasteve të keqtrajtimit në institucionet e mbyllura rëndësi ka që rekomandimet e MKPT të identifikojnë qartë, elementët e veprës penale dhe të përmbajnë argumente ligjore dhe të provave me qëllim unifikimin e praktikës dhe brenda vetë Mekanizmit si dhe rritjen e profesionalizmit në adresimin e rasteve të torturës ose formave të tjera të keqtrajtimit.

Mungesa e praktikave të mira të mjaftueshme në nivel kombëtar dikton nevojën e ndjekjes së rasteve të referuara në organet e drejtësisë

në të gjitha nivelet me qëllim që të parandalohet rastet e pushimeve të arsyetuara dhe që riviktimizojnë viktimat.

Bashkëpunimi institucional mes mekanizimit dhe institucioneve ka rëndësi të veçantë sidomos në zbatimin e rekomandimeve nga MKPT. Pikërisht kjo është një ndër aspektet metodologjike që duhen të merren në konsideratë nga MKPT.

Referenca

Association for the Prevention of Torture (APT) and InterAmerican Institute for Human Rights (IHR), “Convention against Torture Implementation Manual”, botuar në vitin 2010.

Association for prevention of torture, “*Putting prevention into practice 10 years on: the Optional Protocol to the UN Convention against Torture*”, 2016, botuar në http://www.apr.ch/content/files_res/putting-prevention-into-practice-opcat10.pdf

Bregu, Z., “*Të dënuarit mes izolimit, informimit dhe nevojës për komunikim*”, Dizertacion për gradën doktor shkencash viti 2013, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, botuar në <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/08/Doktoratura-Zylyftar-Bregu-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Gazetarise.pdf>

CAT, “*Guidelines on national preventive mechanisms*”, Gjenevë, 15 -19 dhjetor 2010, botuar në http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CAT/OP/12/5&Lang=en

Gjonaj (Saliu), E. “*Institucionet kombëtare të drejtave të njeriut si Mekanizma kombëtarë për parandalimin e torturës, arritjet dhe sfidat Modelet në disa vende të Evropës*”, Book Proceedings, Konferenca e katërt Ndërkombëtare në Shkenca multidisiplinare, botim i International Institute for private, commercial and competition law (IIPCL), Qershor 2016

Hysi. V, Penologjia, Kristalina KH, Tiranë, 2015.

Këshilli i Evropës, “*Një udhëzues për implementimin e nenit 3 të KEDNJ-së – Ndalimi i Torturës*”, botuar në vitin 2007, shtëpia botuese cprstudio.com

Konventa kundër Torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984, ratifikuar me ligjin Nr. 7727/1993.

Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese (OPCAT), ratifikuar me ligjin Nr. 9094 datë 03.07.2003, botuar në <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/OPCAT.aspx>

Platforma Ndërkombëtare e Reformës Penale, botuar në <https://www.penalreform.org/priorities/torture-prevention/preventive-monitoring/>

Raporti i vitit 2012 për veprimtarinë e MKPT-së, botuar në <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/2014-Raporti%20i%20NPM%20shqip%20final.pdf>

Raporti i vitit 2013 për veprimtarinë e MKPT-së, botuar në http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/2014-05-19%20ALB%20-%20Raporti%20per%20publikim%20PDF%20i%20MKPT%202013_final.pdf

Raporti i Raporti i vitit 2014 për veprimtarinë e MKPT, botuar në <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/2014%20Raporti%20i%20Posa%23U00e7%23U00ebm%20i%20MKPT.pdf>

Raporti i vitit 2015 për veprimtarinë e MKPT, botuar në http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/RAPORTET/RAPORTE_TJERA/2015%20Draft%20Raporti%20Vjetor%20i%20MKPT.pdf

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar me ligjin nr 76/2016.

Ligji Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ndryshuar me ligjin Nr. 155/2014 datë 27.11.2014.

Ligji Nr. 44/2012 “Për Shëndetin mendor”.

Ligji Nr.8328 datë 2.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ndryshuar me ligji nr. 9888, datë 10.03.2008

Abstract

Prof.Asoc.Dr. Maks QOKU	DISA TRAJTIME JURIDIKE MBI DOKTRINËN E NDASHMËRISË DHE ATË TË KOMPETENCES MBI KOMPETENCËN NË ARBITRAZHIN NDERKOMBETAR182
Dr. Erind MERKURI & Doc. Klesta HYSI	AKTET NORMATIVE NËNLIGJORE MIDIS JURIDIKSIONIT KUSHTETUES DHE ATIJ GJYQËSOR ADMINISTRATIV 183
Dr. Armela KROMIÇI	LEGJSLACIONI SHQIPTAR MBI TRANSFERIMIN E ÇMIMEVE184
Msc. Ardit MUSTAJ	MBI FENOMENIN KRIMINAL TË PASTRIMIT TË PARAVE 185
Dr. Alkelina GAZIDEDE	EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NGA SHTETET ANËTARE186
Dr. Ermal NAZIFI & Dr. Petrina BROKA	KONTROLLI I PËRQENDRIMEVE: NJË NGA SHTYLLAT E SË DREJTËS SHQIPTARE TË KONKURENCËS..... 187
Msc. Sali SHEHU	KORRUPSIONI DHE EFEKTET NEGATIVE TË TIJ NË SHQIPËRI188
Msc. Marilda MENKSHI	MBROJTJA E FËMIJËVE NGA KEQTRAJTIMI NË PARASHIKIMET E KODIT PENAL SHQIPTAR189
Msc. Oljana PAPA	PËRDORIMI I GJUHËS SHQIPE NË TEKNIKËN LEGJSLATIVE190
Etilda GJONAJ (SALIU)	MEKANIZMAT E BRENDSHËM NË PARANDALIMIN E TORTURËS DHE TRAJTIMIT Ç'NJERËZOR DHE DEGRADUES NË SHQIPËRI 191

Prof.Asoc.Dr. Maks Qoku

Abstract

In a world that is developing so fast, where the international commercial arbitration is monopolizing the market of the ways of resolving the disputes of this kind, appears in the foreground the increase of the efficiency, speed and integrity of this process. The doctrine of separability, or in other words, the concept of separation of the main contract from the arbitration clause contained in it, gives the latter a special status, in relation with how to address this clause.

From this derives the competence of the arbitrator to judge on the contract, arbitration clause, arbitration agreement and its jurisdiction. These two doctrines materialized in the regulations of the main institutions of arbitration in the world, have enabled the arbitration process, to break away completely from the main general system of justice (if the general court would decide on the issues of the jurisdiction of the arbitral tribunal, the second will always remain subservient from the first). This makes the process, to be controlled totally by the arbitration court, respecting the will of the parties and that makes the distance from links to numerous litigation, which would compromise the time factor, which is one of the key elements in which the arbitration is based

Dr. Armela Kromiçi

Abstract

With the laws no. 42/2014 and 43/2014, the Albanian legislator has regulated the transfer pricing technique and the corresponding sanctions. Transfer pricing is a technique of price manipulation, which is commonly practiced by companies governed by different tax legislation, with the characteristic that these companies are part of the same group. This technique aims to avoid the taxation through the movement of taxable incomes from one company to another. In the 1960s, the OECD edited the first acts on how to determine the fair price for transactions conducted by companies within the intercompany group. The OECD emphasizes the need to compare the transfer pricing for intra-group transactions with the price that should be applied if the companies did not have a dependency relationship between them. The OECD declares that the principle of 'free competition' should be the assessment parameter for intra-group transactions. Regarding the cross-border transactions conducted by intra-group companies it is necessary to create an international efficient and coordinate control tax system. Through the implementation of the free competition principle, tax administrations of different countries should apply similar criteria in assessing the transfer pricing. For this reason, the methodology applied by tax administrations will assume a fundamental role in correctly estimating transfer pricing within the group. This paper aims to analyze the OECD principles on transfer pricing and their implementation in our legislation.

Keywords: transfer pricing, group of companies, free competition, tax system

Msc. Ardit Mustafaj

Abstrakt

Official data on money/illicit profits laundering indicate a low level of this crime in our country at first glance. Although our country in recent years has significantly improved legislation in the field of money/illicit profits laundering, international monitoring bodies have warned that the real fight against this criminal phenomenon in Albania was not at appropriate degree. This paper conduct some specific assessments to create a more complete picture of the extent of the phenomenon of money/illicit profits laundering. The evaluation is done by two different directions but in view of this goal: first by measuring an approximate size of this phenomenon in value and secondly by comparing the rate of the crimes which mostly bring illegal benefits to their perpetrators defining also the extent of their need and demand for disguising the illicit origin of these benefits. In this way the conclusions on the extent of the criminal phenomenon of money/illicit profits laundering can serve to better assess the effectiveness of criminal policy and other legislative and organizational measures for handling this criminal phenomenon.

Keywords: money laundering, illicit profits, criminal policy

Alkelina Gazidede

Abstract

The enforcement of European Court of Human Rights's judicial decisions by member states is one of the most important key issues in the legal framework of human rights in the European system. Articles 1 and 46 of European Convention of Human Rights provide that is the obligation of countries ratifying the ECHR to implement any obligation that stems from cases against it where a final judicial decision is conducted in which is concluded that the state has violated the provisions and principles of the Convention.

Stressing the importance of the enforcement process, especially after the Protocol. 14, the purpose of this article is to present a reflection on the process of implementation of judgments of the Court because of the importance that represents this process through its function to prevent future violations of the European Convention and respect for human rights.

Ermal Nazifi PhD.C. Petrina Broka PhD.

Abstract

The battle to win more markets and clients is the main goal of a business. It can be achieved quickly through the mergers and acquisitions (M&A) of independent undertakings. The year 2015, has been a record year with the highest volume of M&A in the history reaching a total of almost 5 trillion USD.

Some of the most important M&As in Albania has derived from foreign investments, privatization of state owned enterprises, consolidation of local undertakings etc. The legal framework for merger control in Albania has a history of almost 20 years since the approval of the first law on competition. However, the practice of merger control has flourished only after the approval of the new law on competition protection. Still, the Albanian economy has not been characterized from problematic mergers that would risk the stopping form the Albanian Competition Authority, the public entity in charge for merger control.

The approximation of the Albanian merger control legal framework with the EU acquis, would have a very positive effect in the improvement of the work of the Albanian Competition Authority, the cooperation with other regulatory entities and the National Business Centre is of utmost importance to make sure that all mergers are reviewed from the Albanian Competition Authority. Even in cases of non – notification from the merging entities. The development of education and research in the field of merger control would be very helpful for the development of the institutions and practice of merger control in Albania. That is why a special focus is needed.

Sali SHEHU

Abstract

Corruption is a worrying problem for all countries and political regimes, especially for democratic ones. Many studies have identified corruption as a “white crime” because of the difficulties it has to identify and condemn. It becomes an obstacle to democracy and law enforcement in the country. Albania is on its way to European integration. One of the problems that must be solved in this relatively long way is the fight against corruption. The purpose of this article is to conduct an analysis of the level of corruption in Albania over the years and comparing it with other West West countries and to identify its negative effects, especially the economic ones, which are even more vulnerable to the population of A Place. The data used in this paper are of secondary type, published by the official reports of international institutions.

Key words: corruption, economic growth, legislation

Marilda MENKSHI*(PhD process, Criminal Law)***Abstract**

Children are the future of every family, society, nation; They are the future of the entire world. By the importance that this target group has to the society, state dedicates special attention and protection to these group. Our criminal law guarantees the physical, moral and intellectual development of each child from the actions or inactions socially dangerous, and provided by law as criminal offenses.

In this paper will be discussed current Albanian criminal law, in the context of protecting children from mistreatment. This legislation will be analyzed in light of its applicability to law enforcement bodies in the country.

In consideration of this paper will be also international acts and reports of Albanian Ombudsman and opinions of non-profit organizations operating in Albania on children rights, in the framework of children protection from every form of children mistreatment, begging or any other form of income from children activities not allowed by law.

Keywords: *abused children, psychological abuse, physical mistreatment, use of minors work or use of children for begging, domestic violence etc.*

Oljana PAPA

Abstract

From the moment of creation of our country, the problem of creating an Albanian-language terminology in the field of law has arisen. This is of fundamental importance as it enables the legislature to design this terminology and be accessible to the wider population. But this situation has not been easy. The long occupation of our country by the Ottoman Empire, had created a gap in the field. However, already in the first acts, attempts were made to have such a terminology, where the first example is the Code of Jury, drafted by the Government of Vlora in 1913. During the period between the two world wars, when the Albanian state was consolidated, a new and modern legislation was drafted. In this case, was noted a phenomenon when the terms in Albanian language were associated with terms in a foreign language. These terms had the same meaning. This actually damaged the Albanian language in the field of law, because, based on their professional trend, jurists tried to speak with foreign terms in order to show a great language and culture. After the liberation of the country, great efforts were made to purge the Albanian language from foreign terms, where it also benefited the Albanian language in the field of law. In this regard, many terms were found in Albanian languages which replaced the foreign terms. But the situation is becoming more and more problematic lately, where the tendency to draft legal acts and bylaws for which foreign legal acts are used have as models, has caused that Albanian terminology is again being replaced with foreign language terms, when, practically such a thing in most cases is not necessary.

With the aim of creating and strengthening the competencies of the new generation of lawyers in the legislative writing, it is advisable to increase the weight of the subject “Legislative Techniques” in the programs of the faculties of law across the country, as well as to supplement it with linguistic knowledge, with the aim of strengthening this discipline and increasing theoretical and practical knowledge for law students in this field.

Key words: law, Albanian terminology, legal terms, foreign terms.

Etilda Gjonaj (Saliu)

Abstract

The national mechanism for prevention of torture and ill treatment in Albania (*NPM - hereafter*), after the ratification of the Optional Protocol to the Convention against torture and other cruel, inhuman and degrading treatment (OPCAT)¹ is established as part of the People's Advocate Institution. Although that NPM has more than 9 years that is established and is functioning, and its role on prevention the classic forms of the torture and ill treatment has influenced positively, a challenge for NPM remains the identification of the innovative methods in their methodology of working.

In this paper, is analyzed the function of the NPM in Albania in compliance with the legal provisions of OPCAT and in comparison with the other European NPM's, taking in consideration not only its preventive but even protective role through the recommendations addressed to the prosecutor office for criminal charge.

Based on the analyses of the cases of torture and ill treatment handled by NPM during these last years, and taking in consideration the importance of the role of NPM in protection of the rights of citizens deprived of liberty, through effective and legal national means, in this paper is tried to conclude in some findings and recommendations which can improve in the future the role and the activity of NPM in Albania.

Keywords People's Advocate, NPM, OPCAT, the rights of citizens deprived of liberty, convention against torture and other cruel inhuman and degrading treatment, national mechanisms.

¹ Ratified with the Law no. 9094 dated 03.07.2003 "Optional protocol to the Convention against torture, other cruel, inhuman and degrading treatment"

